

BIBLIOTEKA

834-31
XHUVANI

DHIMITËR XHUVANI



Jetë në arkivol

roman

DHIMITËR XHUVANI

JETË
NË
ARKIVOL

Roman



SHTËPIA BOTUESE «DITURIA»

Redaktore: Natasha Dulaku

Kopertina: Maksi Velo

Rrezet e para të mëngjesit hynë në dhomë e i ranë në sy ish-hetuesit Ridvan Geseri. Ai u zgjua dhe ndjeu peshën e trupit lakuriq të gruas. E shtyu po frymë nuk mori lirisht. U ngrit, iu afroa grilave të dritares dhe pa rrugën e qetë, trotuarin e gjerë, kangjellat e larta e të heshtura të ambasadës sovjetike dhe psherëtiu. Në trotuar asgjë e dyshimtë. Si gjithmonë një polic në krye të rrugës, një në fund. Dhe dy civilët e shërbimit. Njerëz që shkonin e vinin e që, me t'iu afroar ndërtesës së ambasadës, zbrisnin nga trotuari në rrugë, zakon ky që u vu pas hedhjes së bombës e që u vulos me sa e sa burgime e pushkatime. Hetuesi përdrohhi buzët i pakënaqur. Sikur të mos ishte pas grilave do të kishë të pështyrë në atë rrugë të mbushur gjithë njerëz po që, tek asnjëri s'mund të vinte gisht. Fill pas asaj ngjarjeje tronditësë ai u strehua në atë vilë përballë ambasadës me ulje detyre nga hetues në operativ zone dhe me një mision sa të lehtë aq edhe të vështirë: të ruante ambasadën e të kapte pa tjetër një njeri të dyshimtë. Ky i panjohur, që tash dy vjet s'po bëhej i gjallë, ia nxiu jetën. Karierës së tij po i vinte fundi. Dhe ai nuk ishte veç tridhjetë e ca vjeç, gjithë etje e pasion për t'u ngjitur lart, gjithë shëndet e devotshmëri.

Një si rrymë korenti i përshkoi trupin. Në fillim e ndjeu në shpatullat lakuriq pastaj i zbriti poshtë barkut. Atëherë doli nga dhoma, urinoi gjithë duke ndier atë rrymë korenti që po i dilte nga trupi dhe u kthye. E shoqja kishte lëvizur në shtrat. Ashtu përgjumësh, dhe krejt pa faj, kishte

marrë një pozë provokuese épshndjellëse. Ajo hapi sytë dhe nuk u çudit kur pa të shoqin në këmbë. Gjithë çapkënllék i shkeli syrin, i zgjati dorën dhe e tërroqi mbi vete.

— Ama edhe ti, për asgjë s'je i zotit, — u ankua ajo me një zë përkëdhelës.

— Kam një parandjenë që sot diçka do të ndodhë. Pashë në èndërr ministrin, — tha dhe desh u ngrit në këmbë si për të marrë drejtë gatitë.

E shoqja, Rita, një nga ato çupëzat me biografi të mirë, që nuk u bën syri tër, u habit me të shoqin i cili u sul përsëri në dritare, te grilat. Ajo u ngrit dhe iu ngjit të shoqit nga pas. Një e shtyrë e fortë e dorës nervoze të burrit e përplasi në dysheme.

— C'pate, o i marrë? — gërvitit ajo e fyer.

— Eja këtu, eja shpejt. Dhe shiko! A s'të duket i dyshimtë ai leshko?

Rita, si një kotele e zemëruar, iu afroa burrit, pështeti njérën dorë tek supi i tij dhe me tjetrën ngriti fare pak grilën e aty vuri syrin.

Ish-hetuesi mbajti fryshtë. Ai priti me ankth përgjigjen. A do ta gjente vallë ajo se për cilin e kishte fjalë ai? Kush ishte në atë turmë lëvizëse njeriu që ai e quajti leshko?

— Aty ka shumë njerëz. — u qa e shoqja.

— Plasi sytë!

— Mos e ke fjalën për atë djalin me torbë në dorë? Qenka goxha djalë, vec... .

Hetuesi u vesh me të shpejtë, e fshehu rovolen nën xhatetë civile dhe sakaq u ndodh në rrugë, midis kalimitarëve para ambasadës.

Vërtet. I shoqi kishte pasur të drejtë. Veprimet e djalloshit ishin të dyshimita. Ai, si doli deri në fund të ndërtëses, u kthye sërisht gjithë duke mbajtur në dorë atë torbë të lesh-të, si hejbe dhe ecte si i shushatur gjithë duke parë kangjellat e heshtura e të larta të oborrit. Ja dhe i shoqi. Ajo nuk e kishte parë kurrë burrin në krye të detyrës. E njihet të shoqin pothuajse vetëm në shtrat. I shkonin mirë apo keq punët e shtetit ajo e gjente nga mënyra se si sillej ai në

shtrat. Se ç'bënte gjithë ditën ajo as që donte t'ia dinte, sepse s'kish se si e dinte. Në qoftë se mësonte ndonjë gjë e mësonte në shtrat. Sot ishte dita e parë në jetën e tyre bashkëshortore që ajo po hynte në jetën e të shoqit, po shikonte se si punonte ai.

Djaloshi, me torbë në dorë, dukej sikur kishte ardhur nga larg dhe e cte poshtë e përpjetë pak i hutuar e i mëritur. Ai dukej sikur ia kishte sjellë atë torbë ndonjë miku, ndonjë doktori, apo nëpunësi pér të zgjidhur ndonjë hall dhe tani s'po ia gjente dot shtëpinë me gjithëse deri tani s'kish-te ndeshur asnjë njeri pér ta pyetur. Kishte pothuaj një trup me të shoqin. I gjatë, i plotë, me shpatulla të fuqishme, me qafë të gjatë, muskuloze, me një kokë me cepa si të kishte përdorur qysh kur kishte lindur jo jastëk po trung. Flokët i kishte gështenjë të çelura, pak të gjata, dhe si të pagethura kurrë te berberi. Dhe të ecurit se si e kishte, sikur s'dinte të e cte, kurse i shoqi? O zot! Vërtet ai ishte i shoqi? Ta kishte parë në teatër ose në film duke luajtur ndonjë rol do ta besonte, kurse tani, në rrugë ai s'ishte burri i sai. Pse, kjo qenka detyra e tij? — tha ajo me vete dhe kafshoi buzën. I shoqi i ngjante një macoku që gjuan minj. Dhe ai bënte niellloji si djaloshi me torbë. Ekte kuturu, sikur edhe ai kërkonte një adresë. Po ndërsa ai tjetri e justifikonte veten me torbën i shoqi dukej aqik që ndiqte atë, biles afër, fare afër dhe me një gatishmëri po prej macoku që t'i hidhej përsipër.

«Ç'po ndodh në rrugë? — tha gruaja e hutuar dhe harrroi fare që ishte lakuriq. Ngriti grilat, havi dritaren dhe shtangu. Atë cast u hap dera e brendshme e ambasadës. Po atë cast u hap dhera e jashtme prej hekuri dhe po atë cast djaloshi vërviti si hobe torbën me saktësinë më të madhe midis dy dyerive të hapura drejt e brenda. Po atë cast i shoqi iu hodh përsipër dialoshit dhe të dy u shembën përdhe duke u kacafytur. Polici dhe një nga rojet civile u sulën mbi të shoqin dhe djaloshin. Po atë cast nga dera e havur e ambasadës u dëgjua një ulërimë therëse e një gruaje të trembur.

«Ç'ndodhi, o zot!» — tha gruaja dhe ngriu aty në dritare. Me sy të përlotur ajo pa turbull se si në një «gazngjeshën atë djaloshin me qafë të gjatë dhe pas tij u fut dhe i shoqi me dy civilët që bënин roje.

2.

Gruaja, që ulériu e trembur, ra e alivanosur në dyshe-me, aty pranë asaj torbe të çuditshme të hedhur në çastin që u hapën njëherësh të dy dyert e ambasadës. Koka e saj, me ato flokë të verdha në të bardhë, fytyra pa gjak, sytë dhe goja të mbetur hapur dukej si pa jetë dhe sikur kishte rënë nga torba e cila nga fluturimi kishte mbetur e hapur. Nëpunësi i ambasadës, që kishte hapur derën e brendshme dhe shoferi i «Zimit», që kishte hapur derën e jashtme, u befasuan si të hutuar kur panë rrëmbimthi që diçka ogurzëzë, si një shpend i vrarë, kaloi para syve të tyre, u tronditën kur dëgjuan klithmën e zonjës, gruas së ambasadorit dhe mbetën të ngrirë. Për një çast besuan se koka pa jetë e Sonjës kishte rënë vërtet nga torba.

Hutimi i tyre qe i shkurtër. Mbase më pak se një sekondë apo dy. Ata u sulën dhe i ngritën kokën Sonjës, e cila puliti sytë dhe instinktivisht vuri të dyja duart në bark si për të besuar nëse vërtet në barkun e saj pak të fryrë nga barra diçka lëvizë.

Sapo ajo erdhi në vete, atasheu dhe shoferi panë me çudi torbën e leshtë, një torbë e punuar me ca motive sikur të kishte ardhur me magji nga malet e Gjeorgjisë, të Armenisë apo të Azerbaxhanit. Si u qetësuan se koka e Sonjës së bukur ishte në trupin e saj të bukur si një rusalkë e brishëtë ata guxuan dhe prekën me duar torbën, gjalmi i së cilës ishte përdredhur si një nepërkkë e hirtë.

— O zot, c'ndodhi me mua, — tha si e përgjumur Sonja pa hequr duart nga barku.

— Asgjë e dashur, qetësohu, — i foli me dhembshuri atasheu dhe, nga frika së mos shqetësohej Sonja, e ngriti duke ia zënë vështrimin që ajo të mos e shikonte torbën.

Nga korridori i brendshëm kapërceu prakun ambasadori kureshtar, por me të parë të shoqen aq të zbehtë në krahët e atasheut tregtar iu pre vështrimi si me thikë. Ai i zgjati duart dhe e mori në krah rusalkën e tij dhe urdhëroi që të vinte urgjent mjeku.

Torba rrinte përdhe. Siç dukej nuk i kishte ardhur rada të merreshin me të. Shoferi u ul ta ngrinte po atasheu i bëri shenjë që të mos ta prekte. Ai u vu pas ambasadorit.

Pas telefonatës së parë për mjekun, telefonata e dytë u bë në ministrinë e jashtme. Ajo u njoftua për incidentin që kishte ndodhur.

Torbës nuk iu desh të priste shumë. Pas disa minutash mbi të qëndruan ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, ministri i Punëve të Brendshme, një i deleguar i aparatit të KQ, ambasadori, atasheu dhe shoferi si dëshmitarë të ngjarjes.

Torba rrinte aty ku kishte rënë, me gojë të hapur dhe me gjalmin si gjarpër. Dukej acik që ajo torbë kishte diçka misterioze. Nga materniteti njoftuan se Sonja ishte në rrezik dështimi. Ambasadori uli receptorin e dezhurnit që ishte aty në holl dhe u mat t'i binte me shaelm torbës, po, duke kujtar se kohë më parë ishtë bërë bujë e madhe për «bombejn», u spraps. Brenda në torbë diçka nxinte e mbështjellë si lëmsh.

Atasheu tregtar, një plak në prag të pensionit, i cili mundohej të tregohei i ri, vërsëriti për të dytën herë se si kishte ndodhur, se pati përshtypjen aë është ambasadë, nga trouari, u fut një shpend i plagosur, tha gjithashtu se koka e Soniës iu duk sikur ra nga torba. Të gjitha i vërsëriti dhe shoferi. Të dy pohuan se torba është kjo dhe se deri në atë cast kurkush nuk e kishte prekur me dorë. Dukej se deri atë cast, torba e heshtur, me atë gojë të madhe të hapur, ishte hedhur vetëm për të shkaktuar dështimin e barrës së Soniës po këtë hamendie e hodhi poshtë ministri i Punëve të Brendshme. Sytë e tii kishin një shkëlaim e nië kënaçësi si vrei fëmije. Ai raportoi se personi aë e kishte hedhur atë ishte arrestuar dhe premtoi se së shpeiti gjithçka do të shpiegohet me hollësi. Atë cast ra zilia e derës. Si u had ajo hyri shefi i kriministikës, një diale i ri, tevër entuziast dhe pa iu dhimbur ieta e tii, u ul në gjunië pranë torbës. Pa zëriatur duart drejt gojës së habur ku nxinte nië topth i madh shkëmbët nië vështrim me ministrin e tii. Ministri pa nga i deleguari i KQ dhe ai shpiergoi në gjuhën ruse se e mira ishte që të pranishmit të largoheshin.

Ambasadori, një ish-kolonel i luftës së dytë botërore, i verbuar nga inati i fatkeqësisë së të shoqes dhe i rrezikut që të mos bëhej kurrë baba, nguli këmbë që gjithçka të shi-

kohej me sy nga tē gjithë, qoftë dhe sikur kjo torbë tē ishte një bombë e dytë.

Atasheu tregtar e njihte mirë inatin e ish-kolonelit. Ai ishte gati tē hidhte në erë një qytet tē tërë pa iu dridhur duart, Gjatë luftës ai kishte humbur gjithçka. Në fisin e tij tē Molehovëve s'kishte mbetur asnjë. Katër vjet pas luftës, ai vetëm kishte kërkuar një Molehov tē gjallë. Sikur tē mos qe njohur dhe dashuruar me Sonjën e bukur ai me siguri s'kishte pér tē ardhur në Shqipëri si ambasador, po do tē vazhdonte tē kërkonte nëpér stepat e Ruse, në fushat e Ukrainës e në mbeturinat e Stalingradit fisin e tij tē shfarosur. Atasheu tregtar, ai nëpunësi i përjetshëm i ministrisë së jash-tme sovjetike, mbylli sytë kur duart e ambasadorit u futën në turbë jo sikur aty do tē gjente një minë tē sofistikuar po sikur do tē përkëdhelte fytyrën e dhimbshme tē Sonjës, e cila atë çast përpëlitez në sallën e operacionit tē spitalit gjinekologjik të Tiranës. Të gjithë çaplyen sytë kur panë që ambasadori nxori nga torba një top madh tē butë prej lecke tē mbështjellë me një këmishë prej lini. E shpështolli atë sikur i ishte mbledhur kutullaç si në shpërgej një këlysh pa jetë. Çarçafi i bardhë kishte ca njolla tē murme që dikur duhej tē kishin qenë tē kuqe. Gishterinjtë e ish-kolonelit prekën njollat. Kushedi sa herë ai kishte shqyer këmishat e tij dhe me to kishte lidhur plagët e shokëve. «Gjak» — tha ai me vete duke ndier t'i dridhen gishterinjtë. Asnjë s'po kuptonte pse ambasadori i kushtoi kaq shumë kohë atij çarçafi më ato njolla. Ai sikur harroi atë lëmsh që i rëndonte në pëllëmbën e majtë. Sërisht shpështolli një shami tē zezë katër cepat e së cilës ishin lidhur pisk njëra me tjetrën. I zgjidi ngadalë tē katër cepat dhe i hapi. Shamia qe e nibushtur plot me sende tē çuditshme, tē pashpjegueshme e tē dyshimita.

— Ç'janë këto? — pyeti ai duke u ngritur në këmbë.

Balli i tij i madh e i lartë ishte mbushur me djersë.

— Ç'janë këto? — ulériu ai si një ari siberie.

Dy ministrat dhe përfaqësuesi i KQ ranë në gjunjë mbi shaminë e zezë dhe prekën me duart e tyre gjithato cikërrima. Megjithëse i njohën se c'ishin, ata s'patën guxim, tē flistejn.

«Të kishte qenë bombë do të kishte qenë më mirë», — tha me vete ministri i Punëve të Brendshme.

Ambasadori ia pa buzët që lëvizën po nga që nuk dëgjoi zë u nervozua dhe më shumë.

— S'mund të më thoni se ç'janë? — pyeti ai dhe e mbërtheu me sy gati sa nuk e pushkatoi me vështrimin e tij të egër e të zhgënjer.

— Po... s'i t'jua them, shoku Malehov?

— Ashtu siç janë. Të m'i thuash një e nga një. Në mos i dini rusisht m'i thoni në shqipen tuaj.

— Po... si t'jua them shoku Malehov... ja, ky p.sh. është bisht miu.

— Bisht miu?

— Po. Bisht miu. Duket ashiqare që është bisht miu.

Sytë e ambasadorit gati sa s'po dilnin nga zgavrat.

— Kurse ky... Ky duhet të jetë krah lakuriq nate.

— C'është ky lakuriq nate?

— Miu fluturues, — plotësoi në rusisht përfaqësuesi i

K Q

— Mi fluturues? Interesant! — tha ambasadori të cilit sepse i qeshi buza.

— Po ky? Mos është mut qeni? — tha duke iu dridhur buza që pak më parë sikur kishte qeshur.

— Po.

— A i njihni të gjitha këto sende? — pyeti kureshtar ambasadori.

— Të gjitha jo, — u përgjigj ministri.

— Po ju? — iu drejtua ministrit të Punëve të Jashtme.

— Kjo është e qartë që është kokë gjeli, ne i themi kastre, d.m.th. zog i rritur.

— Po këto si saçme? — ngriti zërin nervoz ambasadori i cili aty përpinqej të mbante veten si diplomat, aty i hipte gjaku në tru si një oficer që vërtet fitoi luftën po humbi gjithçka dhe në çdo çast është gati të shpërthejë çdo lloj lufte pa llogaritur asgjë: se humb se fiton.

— Këto duhet të janë kakardhi miu.

— Kakardhi miu, — përsëriti ambasadori. — po a mund të më thoni se ç'kuptim kanë këto të gjitha bashkë? Mos vallë ambasada sovjetike në Shqipëri është një kosh plehrash?

Çuditërisht të gjitha këto ambasadori i tha me një zë të tillë sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Ambasada sovjetike për ne, shoku ambasador, është gjithçka, — nisi të fliste përfaqësuesi i KQ, — është si t'jua them... .

— Mut qeni, kakardhi miu, — ia preu fjalën ambasadori, duke treguar me gisht lëmshin e plehrave te këmbët e tyre.

— A e dini zotérinj se një incident i tillë, një fyerje kaq e madhe nuk i ka ndodhur BS as në asnjë vend kapitalist? Një bombë në një ambasadë është një hiç gjë përpara kësaj ndyrësie. Një bombë në fund të fundit është një bombë, kurse kjo... kurse kjo... O zot!

Përfaqësuesi i KQ pastroi zërin.

— Flisni, zotéri, flisni. Gjenjemëni që dhe unë ta kem të lehtë të gënjej. Si t'ia raportoj Kremlinit këtë mut?

— Më lejoni t'ju qetësoj, shoku ambasador jo për të lehtësuar kriminelin apo armikun që hodhi këtë ndyrësirë këtu. qëllimi i të cilët është i qartë. Ju e dini qëndrimin e Partisë e të Qeverisë ndaj BS dhe masat dragoniane që u morën për grupin armiqësor të bombës. Në të dy rastet nuk duhet të arrijmë në përgjithësim. Populli shqiptar...

— O, jam lodhur dhe jam mërzitur me fjalime. Ju doni të thoni që këto nuk janë kakërdhi miu e ky mut qeni?

— Janë dhe s'janë. Mvaret se ç'kuntim marrin sendet. shoku ambasador, — tha gati përvajtshëm përfaqësuesi i KQ

Dy ministrat panë njëri-tjetrin në sv. Ata i habitit guximi i shokut të tyre. Që të kuptohej se çfarë situate u krijuat mjafton të shikoje fytyrën e atasheut tregtar.

Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike s'kishin qenë kurrë në një tension të tillë.

— Domethënë... sipas teje... — ulëriu ambasadori, — mureve të Kremlinit mund të hidhet çdo mbeturinë? Po a e di ti, more se...

— Më falni, ju lutem shumë të më falni, shoku ambasador, s'dua të keqkuptohem dhe të rëndoij situatën, po ka raste kur sendet e vecanta, që janë ashtu siç janë. kur bashkohen, krijojnë një simbol, një unitet që s'mund ta quash më...

— S'dua sofizma. Për tre ditë dua të di gjithçka rrëth kësaj torbe me mut.

— Mund ta shpjegojmë që tani, shoku ambasador në qoftë se më lejoni të sjell këtu një specialist nga Institut i Folklorit. Jam i bindur që kjo torbë me këto kombinime kaq të shumta e të ndryshme përfaqëson një simbol, një diçka që sendeve të veçanta ua humbet kuptimin real e banal. P.sh. ne kemi një mjekim popullor që përbëhet nga një përzierje gjérash të ndryshme për shërimin e sémundjes së verdhzës, botkinit e kam fjalën, dhe në atë përzierje, ky, më falni, muti i qenit, është baza e mjekimit.

Ambasadori shpërtheu me të qeshur që për atasheun tregtar, i cili e njihte mirë eprorin e tij, nuk ishte normale.

Në atë korridor si paradhomi. në korridordin e madh dhe deri lart në katën e dytë dëgjohej e qeshura e ambasadorit. Ai u lodh, u djersit dhe duke fshirë ballin me dorën e djath-të, me të mëngjérën tregoi telefonin.

— Thërritni specialistin tuaj, s'besoj se do të vonohet, — tha ambasadori.

Kurkush nuk arriti të kapte ndonjë nuancë në se kishte në ato fjalë ironi, kuriozitet apo dyshim rus.

Në kohën që përfaqësuesi i KQ thirri profesorin e Institutit të folklorit, ambasadori hyri në zyrën e tij e kërkoi të lidhej urgjentisht me spitalin gjinekologjik. Pas tij dolli dhe atasheu tregtar. Shoferi nuk i la vetëm tre përfaqësuesit e Shqipërisë. Ata nuk folën me njëri-tjetrin. Të tre ishin të zbehtë në fytyrë dhe u kishte rënë një çehre prej të vdekurish në morg.

Profesori, një burrë rrëth të 55 vjetëve, hyri duke fshirë ballin e ngushtë dhe qafën me një shami të bardhë e cila qe zhubrosur e tëra si një copë letër e keqe. Ai, sa hyri, pa vetëm ministrin e punëve të brendshme. Sytë iu errësuan. Nuk e priste kurrë që ta thërritnin në ambasadën sovjetike dhe të ndeshte ballë pér ballë me atë ministër aq autoritar në atë pamje aq të përvuajtur. Ndonëse qe munduar të merrte me mend përsënë e asaj thirrjeje aq urgjente dhe s'kishte mundur, atë çast e pushtoi një ankth. Përse mund t'i duhen mundur ambasadës sovjetike njohuritë e tij shkencore në fushën e folklorit?

— E, Dima. — i foli ambasadori shoferit sapo hyri kur

pa burrin me ballë aq të ngushtë që vazhdonte të fshinte djersët, — a ia thanë arsyen përse e munduan deri këtu profesorin?

— Jo, shef, — i foli në konfidencë shoferi. — profesori sapo erdhi, s'ka asnje sekondë. Mos duhet t'i nxjerr një gotë ujë?

— Më mirë një votkë, — tha ambasadori, — gjithashtu dhe shokëve, ë?

— Më thoni, zoti profesor, ç'është kjo që shikoni përdhe?

Profesori mezi e mblodhi veten. Ai deri në atë çast s'kishte parë përdhe. Uli sytë te këmbët dhe dalloi torbën, pastaj atë grumbull mbeturinash mbi shami, e shamia mbi çarçaf, dhe nuk arriti të kuptonte se c'qe ajo pyetje. Të paktën të kishin thënë në telefon se përse qe fjala, përse duhej të vinte. Dhe tani që erdhi e pa atë grumbull plehrash, nuk qëtësohej dot e nuk e merrte dot me mend pse duhej të ishin dy ministrat më të mëdhenj e të fuqishëm të Shqipërisë dhe ai përfaqësuesi aq në zë i KQ që ishte më i fuqishëm se disa ministra bashkë. Pastaj...

— Pijeni, zoti profesor, mbase ju bën mirë, — foli ambasadori dhe duke parë së dora e profesorit dridhej aq sa s'do të ishte në gjendje të merrte gotën nga ta'bakaja që mban te Dima shoferi i shërbuei.

— Faleminderit, — tha profesori dhe, i hutuar siç ishte, vazhdoi: — Nuk e pi, po do ta pi. Mysafiri është i detyruar të nderojë zotin e shtëpisë dhe të pijë çdo gjë që i serviret. Faleminderit, — tha sérish dhe sa lagu buzét e vuri gotën sérish mbi tabaka. — Ju lutem më falni pér hutimin, — kërkoi ndjesë dhe mori sérish gotën dhe e piu një gllënëkë të plotë. — Ju lutem më bëni pyetje dhe unë do t'ju përgjigjem, — shtoi dhe gati sa nuk mori qëndrim gatitu...

— Ju thashë një herë. C'është kjo që shikoni përdhe?

— Përdhe ka shumë gjëra, nuk e di pér cilin send e kenë fjalën, — tha akoma më i hutuar profesori.

— Të gjitha bashkë, — u mundua ta qetësonte profesorin përfaqësuesi i KQ.

— Më falni, shoku Besnik, pyetjet i bëj unë, — ia preu fjalën ambasadori.

Bësniku kërkoi ndjesë me një përkulje të lehtë të kohës dhe i hqiqi së paktën nga profesori si përti i thënë ambasadorit se ai s'kishte për ta perseritur gabimin.

— Ju lutem më pyetni konkretisht.

Ambasadori e humbi durimin.

Profesori e kuptoi se të dy palët ishin në mosmarrëveshje dhe se ai ishte thirrur aty për saktësi shkençore po se përçfarë lloj shkencë bëhej fjalë ai nuk ishte në gjendje të hamendësonte.

— Po ja, — ndërhyri ambasadori, kur u bind se profesori s'do të dilte kurrë nga ajo gjendje hutimi, — ky çarçaf q'është, dhe këto njolla q'janë?

— Ky çarçaf? — bëlbëzoi profesori dhe e ndjeu se po e tpron te me hutimin e tij. — Ky eshtë një copë çarçafi... nga materiali eshtë i mirë dhe tepër i vjetër. Eshtë kambrik. Më shumë përdoret për shtresë.

— Po njollat?

— Njollat, njollat... po... në se pranojmë që eshtë çarçaf, një copë çarçaf i prerë dhe i ruajtur, këto njolla duhet të jenë njolla gjaku. Ndér ne, qëmoti, ka pas qenë zakon që nuseve, natën e parë të martesës u shtrohej çarçafi më i mirë. Të nesërmen në mëngjes ky çarçaf kontrollohej nga vjehrra e cila ishte e sigurt që nusja, si pasojë e zhvirogjërimit, do ta kishte njollosur me gjak. Atëherë e ndehte në oborr, për t'ia treguar të gjithëve se si kishte dalë nusja. Dhe vetë nusja e ruante atë në sepet. si dëshmi e pastërtisë.

— Interesant, — tha ambasadori. — Qenka një zakon i çuditshëm. Me që paska kaq vlerë e rëndësi ky çarçaf si e shpjegoni ju që ka dalë nga sepeti dhe me të janë mbledhur këto sendet e tjera? A s'kam të drejtë ta bëj këtë pyetje?

— Plotësisht, zoti ambasador, — tha i kënaqur profesori. — Duhet të ketë qënë një arsy shumë e fortë që ka dalë nga sepetja. S'mund t'ju plotësoj kureshtjen tuaj pa ditur, pa zbuluar se q'janë gjithë këto sende, — tha profesori dhe u përkul mbi shaminë e zezë e u çudit me mutin e qenit, me bishtat e kakërdhitë e miut, me thonjtë e bufit, me fletët e lakuriqit të natës, me farët e linit e fijet e fshesave, me lesh-të zi e të bardhë, me fara stërkungulli e me një mori cikë-rrimash e thërrimesh shtëpiake..

— Ju lutem më thoni ku ishin e si ishin mbështjellë këto sende? — pyeti profesori.

— Të gjitha bashkë në shaminë e zezë. Shamia e zezë e mbledhur me çarçaf dhe të gjitha tok futur në këtë torbë, e cila fluturoi si një shpend nga trotuari drejt e këtu ku po e shikoni, — shpjegoi ambasadori.

Profesori qeshi. U mbush me fryshtë dhe pa se mbi këndin pranë telefonit ishte tabakaja me gotat bosh dhe një shishe votkë.

— A mund të pi dhe një gotë?

— Dima, mbushe! — urdhëroi ambasadori.

Profesori e piu me fund si nuset dhe si fshiu buzët tha në gjuhën ruse.

— Pa ruski, a?

— Si duket e gjetët se çështë kjo, — foli ambasadori të cilil nuk i pëlqeu ai entuziazëm i profesorit.

— Po, — tha me një krenari profesionale tepër të singertë profesori, — kjo e gjitha shoku ambasador nuk është gjë tjetër veçse një magji.

Tani shkëlqyen sytë e përfaqësuesit të KQ dhe ministri i punëve të jashtme sikur u qetësua. Ministri i punëve të brendshme nuk shfaqi asnjë shenjë, si të ishte i padepërtue-shëm.

— Magji?! — pyeti i hutuar ambasadori.

— Po. Magji.

Ambasadorit, që kishte bërë gjithë ato deklarata për rrezikun e madh të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike, sikur nuk i erdhi mirë. Sendet fye: muti i qenit, kakërdhia e miut e tërë të tjerat e humbën vlerën e tyre reale. Ato, në atë magji, ishin ashtu siç i shpjegoi përfaqësuesi i KQ, i cili mori një pamje si të ishte ai dhe vetëm ai shpëtimiari i asaj tragedie që do të ndodhë.

Ambasadori lëvizte buzët dhe sikur shijoi misterin e asaj fjalë që në shqip atij i tingëlloi shumë bukur. Pas pak ai e shqiptoi si për të bindur veshët apo veten.

— Magji! Po ai që bën magji si quhet?

— Magjistar, — u përgjigj me të shpejtë përfaqësuesi i KQ dhe, duke mos fshehur kënaqësinë që kjo çështje u zbut, i buzëqeshi ambasadorit i cili për çudinë e të gjithëve ç'ishin aty, u ngrys, u nxi dhe u kthyë nga profesori.

— A mund të më thoni, zoti profesor, pse dhë kur bëhen magjitet?

Profesori ishte qëlluar plotësisht nga kompleksi i inferioritetit dhe frikës që e pat pushtuar. Mbështetje e kishin ndihmuar dhe dy gotat e votkës ruse.

— Magjitet kanë karakter intim ose familjar dhe shprehin një botëkuptim mistik. Janë më shumë një përpjekje për të mposhtur një fatkeqësi ose për të bërë një ligësi me ndihmën e fuqisë së mirë ose të keqe. Me një fjalë, në pamundësi për të shpëtuar gjëmën ose për të bërë gjëmë, përdoren këto mjete të kombinuara sipas mendjes së magjistarit. Në fakt Instituti ynë nuk merret me studimin e magjive, sepse ato nuk kanë bazë shkencore.

— Nuk më duhet interpretimi ideologjik. Dua të di si veprohet me të.

— Rastet janë të shumta e të ndryshme. Janë si të thuhash pa fund, siç janë dhe vetë fatkeqësitë, mëritë, sëmundjet. E mira dhe e liga janë në luftë të përjetshme. Njeriu i pafuqishëm nga halli është gati të besojë dhe në një kotësi veç ajo t'i japë shpresë.

— Konkretisht, — ndërhyri prerë ambasadori, — më shpjegoni një rast.

— Një rast! — mori frymë profesori.

— Po, — e nxiti ambasadori.

— Një rast, një rast... po ja ta zëmë se një person, ose një familje e ka zënë një e keqe e madhe prej vitesh...

— Po, — e nxiti sërisht ambasadori.

— Atëherë kjo familje e bindur se i kanë bërë magji, pososit një mëgji për të prishur magjinë e parë.

— E qartë, e qartë. Ta zemë se këto ndyrësira s'kanë kuptimin e tyre të parë. Kështu bashkë përbëkan një simbol, një mith, një zakon, një magji. A mund të më thoni, ç'do kjo magji këtu në ambasadë, pse është hedhur këtu?

Profesorit i iku fare entuziazmi. Ai u zbe, mblodhi supet si guak e ashtu ngeli duke dhënë përshtypjen se po ngurtësohej, sikur të kishte bërë mëkat dhe tanë po e zinte magjia. Ai mundi të lëvizë vetëm kokërdhokët e syve duke çuar vështrimin te tre udhëheqësit e shtetit e të Partisë.

Profesori, me ngurimin e tij sikur e ndihmoi ambasadorin. Vështrimi i tij ra mbi fytyrën e përfaqësuesit të K Q.

— Kur hidhet një bombë ka një kuptim. Kur u hidhka një magji, sipas profesorit, paska shumë kuptime dhe arsyesh të cilat u grupokan në dy drejtime: e para për të shpëtuar

nga një e lligë e madhe dhe e dyta për të bërë një të keqë me të mëdhe se sa mund të bëjë një bombë, sigurisht sipas botë-kuptimit të atyre apo të atij që ka bërë magji. Ultimatumi im mbetet në fuqi. Për tri ditë dua shpjegime. E qartë? Po të doni mund ta pini dhe një gotë profesor, — tha ambasadori dhe doli nga ai sallon i vogël e i ngushtë. Në qilim rrinte e qetë torba me gojë të hapur.

3.

Që nga çasti i arrestimit të djaloshit i cili hodhi torbën në ambasadën sovjetike, kishte kaluar një orë e shtatë minuta dhe operativi i zonës, ish-hetuesi Ridvan Geseri, s'kishte bërë pothuajse asgjë, as dosjen nuk e kishte hapur, as nuk e kishte regjistruar të arrestuarin, as nuk e kishte dorëzuar si pas rregullave. E mbante të shtrënguara në hekura sikur të ishte një thesar. E shikonte dhe i vinte si çudi që më në fund erdhia jeto ditë, ai cast i ëndërruar për të rimarrë sërisht ish detyrën e hetuesit të cilën e kishte humbur për hiç gjë. Më të mbërritur në burgun e Tiranës, në prezencë të drojtorisë, i telefonoi ministrit vetë.

— Jam operativi i zonës, ish-hetuesi Ridvan Geseri. Dua të flas urgjentishët me ministrin. Tepër urgjente, — përsëriti Ridvani duke kujtuar copa-copa ëndrrën e mbrëmshme.

— Nuk ndodhet në zyrë! — që përgjigja përtëj telit të telefonit.

— Dua t'ju njoftoj se sot, në orën 7 e 33 minuta, unë...

— Ministri ndodhet në ambasadën sovjetike, — tha sekretari dhe u mat të mbyllte telefonin.

— Më falni, dikur kam bërë një lutje me shkrim për ministrin...

— E di. Ia kam dhënë para një javë, po s'kam marrë përgjigje, — tha sekretari dhe mbylli telefonin.

Dhe Ridvan Geseri, i fyter nga ajo mënyrë që të folurit të sekretarit të ministrit dhe e mbylljes së telefonit, pa gjithë inat djaloshin që hodhi torbën në ambasadën sovjetike dhe pa të keq e fare pa pritur ia veshi me grusht në ftyrë.

Mbi gjakun e mpiksur rrondhi gjak i frashët,

— Cfarë je se po më luan mendsh? Je trung, je mur, je gur... ë? Apo je memec?

Drejtorit të burgut, që ishte mik e moshatar me të atin e Ridvanit, i qeshi njëra anë e buzës.

— Memec nuk është. Të siguroj unë për këtë.

Ridvanit iu zmadhuan sytë. Në ballë i mbiu një rrudhë.

— Edhe memecët bërtasin e ulërijnë nga dhimbjet. Kemi pasur një memec i cili na habiti të gjithëve. Deponoi si qëcua çdo gjë. Ashtu me shenja, me klithma, me fjalë të pakuptimta dhe firmosi gjithçka. Ishte një fshatar nga veriu që strehonte diversantë.

— Po mirë, ky nuk ndjen dhimbje thua?

— S'ka njeri që t'u bëjë ballë torturave, — i tha drejtori djalit të mikut dhe mori qëndrim gatitu.

Ridvani u hutua. Kë po nderonte me atë respekt e madhështi drejtori i burgut? U kthyte dhe sa nuk shtangu. Në dhomën e torturave kishte hyrë vetë ministri, i pashoqëruar nga askush. Ridvanit iu duk sikur po rishikonte copa nga éndërra e mbrëmshme... «Ja dhe dora e ministrit, dora e djathëtë me atë unazën me rubin. Në gurin e rubinit ai kishte parë fytyrën e tij si në një pasqyrë magjike dhe pranë tij, ja kaq sa çishte tani, vetë ministri i veshur si Shën Mëhilli majë kalit të bardhë po që në vend të heshtës kishte një pushkë belge.

— Na, mbaje një çikë sa të lahem, — i pat thënë vetë ministri dhe pa pikë turpi, siç mund të ndodhët vetëm në éndërr, ai ishte zhveshur lakuriq.

Ridvanit iu drodhën duart duke mbajtur pushkën. Ai s'kishte parë kurrë në jetën e tij një personalitet, një minister apo një udhëheqës lakuriq.»

Dora e ministrit u bë nevrike ngaqë ndenji e shtrirë pak si tepër, jashtë çdo norme. Ai vuri re se vartësi i tij, të cilil ia kishte shtrirë dorën që hutuar aq shumë. Buzëqeshi dhe në castin që do tërhoqte dorën e ndjeu atë të pushtuar nga të dyja duart e Ridvanit i cili, prapë i hutuar, në vend që ta shikonte ministrin në sy pa dorën dhe nuk u besoi syve: në gishtin e dorës së ministrit nuk ishte ajo unaza me rubin e éndrrës.

Ridvani ndjeu dorën e ministrit që u tërhoq me zor nga dy duart e tij. Ai ngriti kryet dhe e pa në sy. Po tepër vonë. Sytë e ministrit kishin mbërthyer fytyrën e djaloshit, tipa-

ret e të cilit ishte vështirë t'i dalloje. Buzët për të cilat s'mund të thoshe në ishin të holla apo të trasha, hunda për të cilën gjithashitu s'mund të thoshe në ishte e drejtë apo e shtrembër, mollëzat gjithashitu s'mund t'i përcaktoje në të këqura apo të dala, vetullat, nofullat, balli ishte zor të thoshe se si mund të kishin qenë. Ato kishin marrë të gjitha bashkë një vulë, atë të dorës së gjakosur të Ridvanit.

— Si është puna? — u habit ministri.

— Një rast i rrallë, shoku ministër, — ndërhyri me shpejtësi drejtori i burgut, duke parë sa nga ministri sa nga Ridvani dhe, si një i njojur i vjetër e mik familjar i ministrit, tha gati me të qeshur, — s'do të flasë, është nga ata kokëgħenjtë ose vërtet e ka lënë zoti pa gojë e pa nerva.

— Nuk di unë si është, si e ka bérë zoti, nëna apo busht-ra. Dua dosje të saktë, të plotë dhe për dy-tre ditë.

— Si urdhéron, — mori qändrim gatitu Ridvani si për t'i thënë ministrit, drejtorit të burgut dhe atij kokëgdheut se kjo detyrë duhet t'i ngarkohej atij dhe asku jtnej tjetër.

Ministrit nuk i béri përshtypje gatishmëria e Ridvan Geserit. Ai vazhdonte të shikonte pak si me qudi fytyrën aq të dërmuar të djaloshit. Ishte vështirë të kuptoje se çfarë fshihej në sytë e ministrit; të cilit akoma i tingëllonin në vesh fjalët e ultimatumit të ambasadorit sovjetik.

— Nga është? — pyeti ministri.

Ridvani, që ishte përgjigjur pa k më parë me atë gatishmëri shembullore, u step.

— Nga është, qeni? — ngriti zérin ministri.

— Asgjë s'hotë, shoku ministër.

— Si asgjë?

— As emrin e tij.

— Eu! — u habit ministri, — si kështu?

— S'do. Duket ashiqare që s'do! Është i vendosur.

Ministri e mbértheu me sy djaloshin, i cili qëndronte pre hapa larg, i lidhur pas një karrigeje të palëvizshme. Kokën me cepa, si një copë shkëmb, e mbante lart një qafë e drejtë muskuloze. Qafa qëndronte si e ngulur midis dy shpatullave të drejta e të fuqishme. Krahët të përdredhura e të lidhura nga pas, dukeshin si dy kërcèle hardhish. Ministri u afrua për të dalluar tiparet e fytyrës. E gjithë ajo që quhet fytyrië s'qe gjë tjetër veçse një plagë e madhe, një zgürbo-

një lisi. Çuditërisht te ky njeri trung a shkëmb, që të imponohet me një krenari të paspjegueshme njërezo, ishin vetëm dy syltë të cilët hetuesi Ridvan Geseri nuk i kishte prekur e nuk i kishte mposhtur dot. Sytë ishin si dy zare apo rruaza ngjyrë qelli, nga ato që përdornin fëmijët në lojën me arra.

— Nga sytë dukesh që s'je shurdh e memec. Mos u bëj budalla. Përgjigju pyetjes, e thuaj ç'ke pér të thënë. Kush ka hyrë këtu, s'ka dalë pa thënë atë që duhet thënë.

Sytë e djaloshit dukej se kuptonin qđo fjalë të ministrit. Nga përvoja e tij ministri u bind se kishte të bënte me një djalosh të zgjuar, pak naiv, tepër të trembur po shumë të vendosur. Kjo vendosmëri i pëlqeu ministrit. «Do të thotë se ky djalosh di shumë gjëra interesante». Ministri zgjati dorën ta përkëdhelte në qafë po dora u tërhoq përnjëherësh sa iu afroa fytyrës sé përgjakur dhe ra mbi shpatull.

— Po të isha i ri, — nisi sërish të fliste ministri — do ta merrja me shumë qejf hetimin me një tip si ky që kërkon të na mbushë mendjen që s'ka gojë, se s'ka c'të thotë, me një fjalë do të na lërë të gjithëve me gisht në gojë, é?

— Shoku ministër, nuk është as vendi, as koha që t'ju kujtoj se ju kam shkruar një letër pér riemërimin tim si hetues. Unë...

— E di rastin tënd. Meqë edhe ky djalosh është një rast i vçantë vazhdoni hetimin. Pastaj shohim e bëjmë.

Ridvan Geseri e pa me adhurim ministrin dhe pér çudi pa me dashuri djaloshin si të ishte një peshqesh i rrallë, një gur i çmuar. Le të ishte shurdh, memec a sakat. Ai do të dinte ta bënte të fliste.

Pa mundur të fshihte dot gjëzimin Ridvani mori qëndrim gatitë para djaloshit si të ishte para flamurit dhe kërkoi leje.

— A mund të filloj, shoku ministër?

— Ju keni filluar, vazhdoni. Veç me kujdes. Sipas deklaratës së ambasadorit çështja është më e komplikuar se bomba, — tha ministri dhe doli siç pat hyrë. Pas tij doli dhe drejtori i burgut.

Ridvani mbeti vetëm pér vetëm me djaloshin. Dhe me që njeri s'kishte gojë mjeti me të cilin ata do merreshin vesh ishin vetëm sytë. Ridvani e pa drejt, thellë, sikur do të depërtonte në vështrimin e djaloshit dhe i sugjestionuar foli shumë shkoqur, duke i dalluar rrrokjet njëra nga tjetra.

— Më thuaj së pari, si quhesh, o qen bir qeni!

- ...
— Kë vendosur të mos flasësh, ë?
- ...
— Po ama për të dëgjuar dëgjon?
- ...
— Dukesh nga sytë që kuption gjithçka. Pse e torturon vete? Ose më saktë pse më detyron të të torturoj?
- ...
— Të thuash emrin nuk është ndonjë deponim. Të ka bërë nëna apo mushka, ë? Fol!
- ...
— Në se të ka bërë nëna ajo ta ka vënë një emër, apo jo?
- ...
— Mirë, — tha i lodhur Ridvani, — po e zemë se emrin s'ke qejf ta thuash po nga je do ma tregosh? Nga ç'fshat, ë?
- ...
— As fshatin s'do ta thuash?
- ...
— Që je fshatar këtë e shikon edhe bufi. Kokën e ke me cepa. Torba që hodhe në ambasadë është torbë fshati. Fanelia e leshtë në vend të kanatieres çoc thotë. Pantallonat prej shajaku. Këmisha, xhaketa dhe këpucët s'janë të tuat. Mbështetje i ke marrë hua? E? Ashtu?! — tha i kënaqur Ridvani kur pa në sytë e djaloshit një farë habie.
- Me gojën e shoh se je marrë vesh që të mos flasësh kurse me sytë, ë, hë? S'ia ke arritur qëllimit. E di pse? Se pse ti, mor çun, je a s'je 25-26 vjeç, apo jo? Aq? E pra. Dhe sytë, që thua ti, janë pasqyrë. E unë aty shoh gjithçka. Mos m'i hiq sytë, qen se fillova prapë nga grushtat. M'i jep sytë. Ashtu dhe mos m'i hidh sa andej-këndej. Pra e kishim fjalëën që je fshatar. Sytë e tu nuk kundërshtuan gjë. Ato u habitën që unë e gjeta megjithëse nuk është zor i madh të gjesh nga veshja se je qytetar apo fshatar. Dikur, para cilimit, nga veshja mund të dalloje se dhe nga ç'fshat je, tamam — tamam se ç'fshat jo, po krahinën domosdo... Tani t'i biem shkurt, thuaj emrin e fshatit? Si?! S'do?

— ...
— Po si ta ha mendja ty se do të mbetesh kështu, i paidentifikuar, ë? Se nuk do të merret vesh se kush qe ai që hodhi atë torbë në ambasadën sovjetike? A e di ti se me hesh-

tjen tënde ti i bën dëm vete? Ti qdhe imund të mos jesh fare fajtor. Ty të kanë thënë na hidhe këtë torbë, këtu ose atje, dhe ti e hodhe. Apo jo?

— ...
— E shoh që ke vendosur të më qmendësh, — humbi dumrin Ridvani, — por dije se para se të qmendem unë ti... nejse t'i lemë mënjanë kërcënimet dhe torturat. Ta marrim shtruar. Je apo s'je fajtor, ti more djalë i mirë, je i detyruar të thuash emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, emrin e nënës dhe të babës dhe shtetësinë. A more vesh?

— ...

— Si, as kaq gjë s'kupton? A je shqiptar apo s'je?

— ...

— Nga hyre në Shqipëri? Nga ajri, toka apo deti. Ç'je more mut, fol? Je grek, amerikan, jugosllav, ë? Do të ma hedhësh se s'je dhe shqiptar? Po surrati yt duket që atje tej që është surrat shqiptari? A e kupton, o kafshë, se me kokëfortësinë tënde i bën varrin vetes? Shiko këtu. Mos m'i hiq sytë. Apo ke qejf të ta qërroj syrin? S'kam asnjë përgjegjësi në qoftë se ty të pëlcet njëri sy apo tjetri. Gojë s'ke, veshë jo, na dhe pa sy, — thirri hetuesi e pa pritur ia veshi me shpinën e dorës mu në sy.

— Pis-pisi! U bë bytha jote të tallet me mua. Bën sikur s'ke gojë, s'ke veshë? Mos do më gënjesht se s'ke as sy? Ato janë thesari im. Dua t'i le aty në ballë, dua t'i jap në dorë, një nga një. Fol, qen. Emrin?

— ...

— Mbiemrin?

— ...

— Vendlindja?

— ...

— Atësia? Babanë, babanë si ta quajnë?

— ...

— Po nënën që të ka pjellë, o bir kurve, ë? Si ta quajnë nënën?

— ...

— S'do të flasësh? Mirë. Pa ta shoh pak syrin? E, s'ka gjë, paska plasur një kapilar gjaku. Si? Sheh turbull? Nuk më sheh mirë? Vetë e ke fajin. Unë po të flas si njeri, urtë e butë ti bën sikur s'dëgjon. Në fund të

fundit ti je i detyruar të thuash si të quajnë, nga je, i kujt je. Çdo njeri në këtë botë është i detyruar të thotë se kush është e nga është kur pyjet nga organet e rendit, aq më tepër ti që s'ke as pasaportë. E, t'u qartësua pamja? Ë? Diçka më mirë apo jo? Hajde tani, fillojimë. Çdo i arrestuar regjistrohet, i hapet një dosje, apo jo? Dhe çdo gjë fillon nga emri e mbiemri. Mos më bëj të humb durimin. Mirë? Emrin!

— Mbiemrin pra? S'do? Dakort. Domethënë ke vendosur të mbetesh i panjohur. Pa emër, pa mbiemër, pa vendlindje, pa nënë, pa baba. Po a s'na thua si erdhe deri në Tiranë pa pasaportë? Si kalove p.sh. urën e Rogozhinës, nëse ke ardhur nga jugu? Apo urën e Matit nëse ke ardhur nga veriu, apo Qafkrrabënn nëse ke ardhur nga lindja? Po në hotel si fjetë pa pasaportë? Ti pandeh se unë dhe organet tona janë të paafta për të gjetur se kush je, nga je? Se ku ke ngrënë, ke pirë e ke fjetur? Pa kujtohu një çikë a s'je ti që pyete atë cigareshitësin në cep të rrugës se ku bie Ambasada Sovjetike?

Sytë e djaloshit sa s'dolën nga vendi. Edhe ai i miri edhe ai i dëmtuan, që tani ishte mavijosur.

— E, e pe? U habite, ë? Sytë s'i paske gjë. Të tradh tokan. Nuk i paske në komandë. S'ke ç'bën. Syri është sy, s'është gojë. Nejse.

Nga vetulla e dëmtuar plasi një kapilar që mo sa dukej sapo ishte kuaguluar. Pikla e gjakut po rrëshqiste drejt syrit. Ridvani nxori me të shpejtë shaminë e tij të pastër dhe ia thithi atë vragëzë të hollë gjaku.

— E di që ke sy të bukur? — pyeti Ridvani dhe i pa me adhurim ata dy sy aq të pastër, të çiltër, ngjyrë qielli në gur kali, si të tejdukshëm. Sy që kishin vesh, gojë, që reflektonin aq thellë ç'kishte e ç'nuk kishte shpirti, që zbulonin dhe skutat më të fshehta.

— Me siguri që ke ndonjë vajzë atje në fshat. S'ia ke vënë syrin ndonjërs? Apo je i fejuar? S'besoj të kenë lënë pa ngacmuar çupat e fshatit. Muhabet kati do thuash, apo jo? Ashtu është. Kot po llap. Ç'të të bëj ty, ë? Fillojmi nga torturat? Si thua? Mos pandeh se merita ime kaq ishte, sa të të kapja? Jo... tani fillon detyra ime e re, tani do të marrësh vesh se kush jam unë. Ë? Do ta zhvillojmi proçesin e

deponimave urtë e butë apo... Hic, mos e gënje veten. Ti do të poftosh qdo gjë, që nga fillimi deri sa të kapa me torbën që hodhe në ambasadë. Dhe dëgjo këtu. Sytë mos m'i largo. Nëse të dhimbisen. Gati? Fillojmë? Hë pra e sheh se s'ka agjë të keqë? Ashtu? Sytë mos m'i ndaj.

— Emrin, emrin po të them? — ulëriu Ridvani, dhe mbe-ti me grushtin lart pér ta qëlluar. Në sytë e djaloshit ai pa frikën të cilën nuk e kishte vënë re. U gëzua dhe uli grush-tin.

Frika pér syrin, frika pér dhëmbët e thyer, frika pér thonjtë, frika pér kockat e shqyera, frika pér jetën është e vëtmja armë e efektshme pér hetuesit. A nuk janë shpikur të gjitha torturat pér të kallur frikën?

— Po ti një emër ke, o qen bir qeni! A je njeri? È?

Sytë e djaloshit, që pak më parë shprehën frikë, tanë shpalosën një dyshim të madh, një hutim, që njëkohësisht e habiste se si kishte rënë në këtë dhomë të çuditshme sa të errët, të thellë, të shurdhët, aq dhe të ndritshme nga një llambë që i ngjante diellit të ndezur e që veç dritës së fuqishme sikur lëshonte dhe kripë që të vriste sytë e të përcëllonte plagët e përgjakura.

— Shikomë në sy. Muə shikomë. S'ka më asnje minutë të qetë pér ty. Nuk do të të lë të mendosh asgjë. Mos u huto ashtu. Ta shpjegoj unë gjithçka. Mos i rrötullo sytë andej-këndej. Kjo është dhoma e torturave. Nga kjo dhomë s'ke si del. S'ka dalë kurkush, veç njerëzve të zgjuar që kanë hundë dhe e ndiejnë crën e vdekjes. S'është gjë burgu para kësaj dhomë. Burgu është lule, ashtu si një lëndinë. È merr vesh se kur është ditë e kur natë. Puna është që të vesh në burg pa pasoja. Këtu është nata e tretë e fatit po me një ndryshim se fatin tënd ti e vendos vetë. Ti ke lindur me fat. Fati yt është se unë që të kapa jam njëkohësisht dhe hetuesi yt. Pra ti mua s'ke se si të më gënjesht, të më thuash se para dy orësh e pesë minutash nuk ishe ti në Rrugën e Durrësit, përballë ambasadës sovjetike që hodhe torbën, apo jo? Pra nuk ka pse të torturohesh pér këtë punë. Që të quajnë Ali, apo Jorgo gjithashtu s'ke pse torturohesh se nuk jo, ti sajtor që quhesh Ali apo Kadi. Dakort? Ashtu, shumë mirë. Tanë po më pëlqen vërtet. Po diku ke lindur apo jo? P.sh. në filan fshat, ë? Dhe pér babë ke filanin, pér nënë filanen. Apo je kopil? Si, s'ke njeri fare në këtë botë?

Djaloshit i pëlqeu mendimi që të ishte kopil. Sytë e tij u qetësuan.

— Të pëlqen të jesh kopil, ë? Po më gënjen. Ja, e shikon si e meritove një grusht, apo më mirë një kamxhik? Na! — ulériu hetuesi dhe ia veshi turinjve, pastaj, sikur të mos kishte ndodhur asgjé, ferkoi kurrizin e dorës së djathtë e cila vazhdoi t'i dhimbte nga sa e sa grushte që i kishte dhënë djaloshit.

— Paske kockë të fortë, — shiko si ma ke bërë dorën, plagë. Nejse. Ku e lamë bisedën?

Atë çast ra telefonin.

Ridvani mori dorezën dhe dëgjoi gjatë urdhërin përtej telit. Ishte vetë ministri.

— Siurdhéron, siurdhéron, — përsëriti Ridvan Geseri dhe e mylli telefonin. Aty mbi tavolinë ishte kamxhiku të cilin e rrëmbeu dhe iu sul djaloshit duke e goditur kudo, në fytyrë, në kokë, në gjoks, në shpinë e sérish në kokë derisa u lodh. Ridvani vuri re se djaloshit i kishte rënë të fiktët. Ashtu, i kruspultt, i lidhur pas karriages, i gjakosur ai dukej vërtet si një shkëmb që ishte rrokullisur nga mali e kishte zënë vend në mes të pérroit i thërmuar e i ciflosur, por prapë shkëmb.

4.

Djaloshi nga fshati mbeti ashtu kutullaç jo se ishte i mbrojtur si kërmilli në guackën e vet, as si iriqi nën gjemba e tij, por së paku ashtu mbronte sytë, buzët, fytyrën, sidomos sytë. Me zor i hapi, aty mbi gjunjët, po nuk pa njëloj me të dy. Njëri shikonte turbullt dhe i digjte sikur të ishte mbushur me rërë të imët lumi. I digjte thellë. Dhe lëkura e kockat i digjnин, deri në palcë, po më shumë i digjte inati. I vinte të pëlciste që ishte lidhur aq keq sa s'luante dot, nuk lufkonte dot, as nuk sulmonte as nuk mbrohej. S'kishte si të hakmerrej që të qelësonte veten. E vetmja armë që kishte ishte heshi, duke mos treguar as emrin e tij, as atë të fshatit.

Hetuesi i hodhi një kovë me ujë. Djaloshi u tremb por instiki e zgjoi në çast dhe gjuhja e etur, e tharë si eshkë, ni-

si tē presë rrëketë e pikat që kullonin fytyrës.

— Të paska marrë etja, ë?

— Po, — doli një zë i vrarë nga fytì drizë.

— Hë, qen bir qeni, tē erdhi goja, ë? Na, — dhe sërisht mbi fytyrën e tij kamxhiku nisi tē fërshiéliente si gjarpër derisa dora e hetuesit u lodh. Po ajo dorë mbushi një gotë me ujë dhe ia vuri në buzë. Buzët, si tē ishin tē pavarura nga i zoti, lëvizën si shushunja. Zgjateshin, futeshin në gotë, e mundoheshin tē arrinin ujin. Pastaj u zgjat gjuha si gjuhë qeni dhe ajo filloj tē pinte si për hesap tē vet. Gota vazhdonte tē lëvizte deri sa erdhi në një pozicion tē iillë sa që uji as afrohej, as largohej. Buzët dhe gjuha zgjateshin po më kot.

— Emrin? — tha hetuesi dhe ngriti paksë gotën duke ia afruar buzëve.

«Emrin edhe mund ta them. Punë e madhe. Nga emri ai s'merr vesh asgjë» — tha me vete djaloshi duke ndier se si uji ia njomi gojën e fytin.

— Emrin pra, merr vesh, apo tē fillojmë nga e para? — tha hetuesi dhe largoi gotën nga buzët.

«Ky s'ditka asgjë përmua. Po e mori vesh s'ka për tē zënë magjia, ka për t'u prishur. I ziu fshat». — tha me vete dhe si një fëmijë fajtor ngriti kokën përballë kamxhikut.

5.

Tre ditët e afatit që ambasadori u dha ministrave dhe përfaqësuesit tē KQ mbaruan. Mbaroi dhe afati që ministri i Punëve tē Brendshme i dha Ridvan Geserit.

Djaloshi nuk hapi gojën. Tha vetëm emrin e tij. Quhej Grigor. Kaluan dhe tri ditë tē tjera. Si këto tri ditë s'kishte punuar kurrë ndërlidhja ushtarake e Ministrisë së Mbrojtjes, ndërlidhja e Ministrisë së Punëve tē Brendshme, ndërlidhja e policisë, e komitetet e ekzekutive, e komitetet e partisë tē tē gjithë qyteteve, lokalitetet e fshatrave. Kudo kërkohet tē njoftohej me urgjencë nëse është parë një djalë aty rrëth tē 25-26 vjetëve, i quajtur Grigor, i gjatë 1,82cm,

flokë gjysmë bjond, fytyrë me copa, sy bojëqielli, shpatulla të gjera e të drejta, krahë e këmbë të gjatë që të linte përshtypjen e një gjysmë qytetari gjysmë fshatari, kurse në njoftimin pér rrëthim e Tiranës thuhej se ky djalë ishte parë në rrugën e Durrësit me një torbë në dorë.

Si pasojë e mungesës së vigjilencës u shkarkuan në vend nga detyra dy policët e dy pikave të ambasadës. U shkarkuan dhe dy rojet civile. U zëvendësuan të gjithë mbikqyrësit vullnetarë e në shërbim të sigurimit që nga cigareshitësi, berberi shitësi i vajgurit, i qumështit, këpucari i riparim-shërbimeve, tre fshesaret që zëvendësonin njëra-tjetrën qdo tetë orë. U paralajmëruan pér pushim nga detyra gjithë personeli i polici-së rrugore e i sigurimit të kontrollit të pikave të kalimit.

Ministri i Punëve të Brendshme nuk mund të kuptonte dot se si kishte mundësi që një njeri, një djalosh që bie të bëjë gjithë atë rrugë të gjatë, të hyjë në Tiranë, të kalojë qetë-qetë e pa u vënë re në rrugën e Durrësit dhe të hetë hedhë kot një gur në lumë dhe një shtet i tërë i organizuar të mos jetë në gjendje të vërtetojë se kush është ky djalosh, i biri i kujt, i ç'fshati, qyteti dhe pse zgjodhi Ambasadën Sovjetike fill pas vdekjes së Stalinit.

Ministri mori sërisht në telefon. Ridvani, si të kishte pas genë pranë telefonit, u përgjigj në çast.

— Po, shoku ministër unë jam. Si? Jo, jo, asgjë. Sot do ta le të qetë disa orë. Po kujdeset mjeku. Jo, jo. Është shëndoshë e mirë. Siurdhëron. Do t'ju njoftoj menjëherë. Si nuk e kupto rëndësinë?

Ministri mbylli telefonin me një ndjenjë justifikimi, si-kur ai kishte bërë gjithçka që mund të bëjë një ministër dhe se gjithë përgjegjësinë ia la atij hetuesit të ri e ambicioz.

Nëse ministri dukej sikur u qetësua pas asaj telefonate Ridvan Geseri u pre në fytyrë. Ai sikur nuhati fundin e kariersës. I trembur pa mjekun në sy. Mjeku mblodhi supet dhe buzët si pér të thënë Ridvanit se do të ishte çudi e natyrës po të kalonte këtë gjendje të rëndë trupi i torturuar.

— Ma lër mua sot. Nesër besoj se e ke gati. Pusho dhe ti një çikë. Kë qetësues në shtëpi?

— Kam.

— Pi tri tabletë dhe fli. Dhe ti do të gdhihesh më i qe-

të. Duhet menduar diçka e re, ndonjë lloj torturë e veçantë. Ky s'qenka njeri. As kafshë s'mund të thuash. Sikur të mos kishte thënë atë «po» të ujit dhe emrin, do të kisha zbuluar një specie të veçantë që i rezistoi të gjitha torturave që njeh literatura botërore. Me këtë tip, me këtë konstrukt fizik nuk u hake dot. Duhet të ketë trashëgim genesh speciale për durimshmëri. Ajo «po» që tha kur i pihej ujë është një rrezë drite pas së cilës duhet të kapemi. Për mua ajo dobësi që tregoi kur tha se i pihej ujë është një shenjë rudimentaliteti e një lloj naiviteti fëmijëror. Pra... na intereson ta marrë veten e të kërkojmë torturat në një prizëm tjetër, mbasë psiqik.

Ridvani qeshi me përcnim. Pothuajse gjithë personeli i shërbimit të burgut dhe i spitalit burg e shikonin doktorin shtrembër dhe si me nënvleftësim. Ai kishte disa vite që grumbullonte material për një studim ku të vendoseshin baza shkencore në sistemin e torturave, duke kombinuar dhimbjet fizike të padurueshme e të durueshme me presionin psikik.

— Të gjitha torturat janë presion psikik e fizik, — tha i vendosur e i mërzitur Ridvani.

— Shko qetësohu, shko sonte në shtëpi. Me këtë s'punon dot. Nesër ta bëj unë qiqër.

Ridvani, në vend që të përgjigjej, pa shtrembër nga telefoni, i cili s'kishte rënë kurrë si këto ditë.

— Përgjigjem unë.

— Të iki thua, ë? — foli i pavendosur Ridvani.

— S'ke ç'bën. Veç në ndejç të më ndihmosh mua.

— Po fle këtu, — tha hetuesi përsëri në mëdyshje dhe ishte gati të ikte nëse mjeku do të përsërishte propozimin e tij.

— Ke nevojë të ndërrrosh ambjent. Dhe ti ke një javë që torturohesh duke tortuar këtë, — foli mjeku.

6.

Ridvani futi dorën në xhepin e vogël të pantallonave, nxori çelësin po mezi e futi në bravën automatike. Në shkallët e apartamentit, si gjithnjë, ishte errësirë. Kishte një ja-

vë plot pa shkelur në shtëpi, që atë ditë kur arrestoi djaloshin nga fshati, Grigorin, i cili kishte heshtur duke përballuar çdo vështirësi. Ishte vonë dhe ai s'donte të trokiste, s'donte ta dëgjonin komshinjtë, as ta shikonin. Një javë i mbyllur në dhomën e torturave të burgut të Tiranës ditët kishin bërë punën e tyre. Më në fund hapi derën dhe u fut në korridor si hajdut.

Nga dhoma e gjumit, që poshtë derës, vinte deri te këmbët e tij një fashë e zbehtë drite. Ridvani mori me mend që e shoqja, Rita e tij e brishtë, ose do të kishte fjetur, ose do të kishte humbur në leximin e ndonjë romani policesk nga ato të përdorimit të brendshëm të ministrisë. Prania e një gruaje në shtrat sikur e qetësoi Ridvanin. Lëvizi ngadalë dorezën po nuk i shpëtoi dot britmës së Ritës, e cila u ngrit e trembur duke zgjatur dy krahët lakuriq si për t'u mbrojtur.

— Budallaçkë, jam unë! — thirri Ridvani dhe u sul drejt saj që ta qetësonte po ajo ulériu:

— Mos, mos më prek! O, sa më trembe. Pse s'i re derës? Pse je kaq i verdhë? Po në telefon pse sillesh aq keq me mua? S'mund të më merrje në telefon që të të prisja? Ridvan, ç'ka ndodhur me ty? Fol Ridvan. Pse më shikon ashtu. Po ai djali që kape gjallë është?

— Sigurisht që gjallë. Megjithëse...

— O, Ridvan, — psherëtiu Rita dhe duart e kontraktuar, të cilat mbanin çarçafin si mburojë, u liruan. Çarçafi mbi krevat dhe Rita u shfaq e tëra lakuriq, ashtu i pëlqente asaj të rrinte në shtrat, — e di ti që po bëhen plot shtatë ditë që ai djalosh ka qénë gjithnjë këtu?

— Mos fol budallallëqe, ai ka qenë në duart e mia. Ai është përpëlitur, ka rënkuar dhe është torturuar, ja nga këto dy duar, — tha Ridvani me të shpejtë për të qetësuar të shoqen.

— Jo, jo. Ridvan. Ai çdo natë, që në këtë orë e deri në mëngjes ka qenë këtu, me mua. Atje në atë karrige. Më ulet e s'do t'ia dëjë fare se e shuaj apo e ndez dritën.

Ridvani vuri buzët në gaz dhe pyeti.

— Po tani ku është? Nuk e shoh në karrige? — tha Ridvani dhe ktheu kokën.

— Mos u tall, Ridvan! Ai vjen e rri aty. Herën e parë

erdhi atë natë që më telefonove ti e më the që e detyrove të flasë, që tha po dhe se quhej Grigor. Që atë natë ti s'më telefonove më, — tha Rita e shqetësuar.

— Mirë paskam bërë që s'të kam telefonuar. Do t'ju prishja qetësinë, — u përgjigj Ridvani me të qeshur dhe zgjati dorën drejt supit të lakuar të gruas. Rita u tkurr si të ishte lule mos më prek dhe e pa të shoqin si të ishte mëkatar.

Dora e Ridvanit u zgjat, e përfshiu për beli të shoqen dhe e ngjeshi pas trupit të tij. Rita, gjithnjë e gatshme dhe gati e pangopshme, për çudi të çudive, këtë radhë i vu si kuçi të dyja duart dhe e shtyu të shoqin. Sytë e saj ishin zgurdulluar.

— Ç'ke, Rita?

— Gjak. Mos është gjaku i tij?

— I kujt, moj?

— I Grigorit? Ja, në këmishë, në jakën e këmishës.

Ridvani u spraps, u tkurr dhe u tremb sikur këtë çast, në dhomën e gjumit të tij, do të vinte vërtet Grigori, ai djalosh aq i fuqishëm si një qenie mbinjerëzore që nuk u mposht nga asnjë torturë.

— Po shkoj të lahem. Bëj gati një palë ndërresa, — tha Ridvani.

Rita, si të kishte turp nga i shoqi, veshi robdeshambrin prej mëndafshi. Ridvanit i bëri përshtypje. Ajo nuk e kishte një zakon të tillë, përkundrazi, robdëshambrin e vishte vetëm kur binte zilja e derës ose kur hapte dritaret e dhomave. Asaj i pëlqente të ecte në shtëpi lakuriq dhe kur qëllonte pérballë pasqyrës hidhte sytë fshehurazi dhe vështronë këlimthi e me epsh trupin e saj të lakuar sikur të ishte trupi i një tjetre që largohej kur largohej ajo, që afrohej kur afrohej dhe ajo dhe që nuk bashkoheshin kurrë.

Ridvani u la, u fshi, u parfumua me dy pikëla të vogla të një parfumi rus «Krasnaja shapocka» dhe u sul për në dhomën e gjumit. E shoqja nuk ishte shtrirë në shtrat. Robdeshambri ishte përdhe. Te pasqyra e madhe e tualetit qëndronin si statuja të bukurisë ajo dhe një grua tjetër e ngjashme me të si dy pika uji. Ridvani u afrua. Atij iu duk më e bukur Rita e pasqyrës dhe zgjati duart drejt saj. Ndonëse përqafoi atë që kishte më pranë e që ia njihte edhe ngrohësinë e gjakut, u drodh. Rita e tij ishte e ftohtë si xhami i

pasqyrës që e reflektonte. Dhe trupi i tij ishte i stohjtë.

— Nusja e xhaxhait më tha se ajo ruska e bukur, grua-ja e atij ambasadorit paska dështuar goxha djalë. Paska qenë në muajin e gjashtë, ë? — pyeti Rita.

— Kur kështu? — tha Ridvani dhe hoqi duart nga beli i gruas.

— Sot në drekë. Ambasadori paska ulërirë si ari. Kaq të frikshëm i paska Rusia arinjtë?

— O, zot! — tha Ridvani. — E di ti moj fyckë se çdo të thotë kjo për ne, për mua?

Rita mblođhi supet delikate, duke përdredhur pa belin dhe buzët e tulta.

— Do të thotë që ata, sovjetikët, ta marrin seriozisht punën e magjisë, të asaj torbe të mallkuar. Dhe ai tuafi, profesori, ia bëri mendjen pordhë për ato qelbësira: mut qeni e mut maceje. Prandaj më telefonoi ministri?! Dhe unë rri këtu me ty, — shfryu Ridvani dhe filloi të vishte po atë kostum që pat hequr.

— Vish kostumin tjetër, ku do të shkosh?

— Atje, ku! Te ai lugat që u ka kallur datën të gjithëve. Te ai që vjen këtu e rri në atë karrige e të shikon ty, — u tall Ridvani.

E shoqja e ndoqi nga pas po Ridvani kishte inbyllur derën. Rita u kthye. Sa hyri në dhomën e gjumit e pa Grigorin te karrikja bosh ku zakonisht hidhte rrobat e saj të brendshme kur zhvishej, aty përballë pasqyrës.

Ridvani hapi derën e dhomës së torturave dhe u tremb kur nuk gjeti aty as Grigorin, as mjekun, as gardianin. Atë cast ra telefoni. Ridvani e mori dhe u drodh kur dëgjoi zërin e trembur të së shoqes që pëshpériste:

— Ridvan. Ai është këtu, në karrige. Rri e më shikon.

— Lakuriq je akoma? — pyeti Ridvani.

— Jo. U vesha.

— Mos ki merak atëherë.

— Ridvan, mos u tall. Unë kam frikë? Po shkoj nga mama. Mirë? Në qoftë se do të kthehet në shtëpi më telefono nga mama, mirë?

— Mirë, moj, mirë. Veç mos u bëj budallaçkë.

— Ç'bën ai, ë?

- Kush moj?
- Ai pra, Grigori yt. Aty e ke?
- Grua, mblidh mendjen! Ik, ik nga mamaja.
- Aman më thuaj, aty e ke, apo jo?
- Po ti aty e ke, te karrigia akoma?
- Tani që po flas me ty sikur nuk e shoh më?
- S'ke se si ta shohësh. Ai është këtu. I shtrirë. Tani, do t'ia shkul thonjtë e këmbëve se të duarve ia kam hequr që mbrëmë.

Në telefon Ridvani dëgjoi klithmën e të shoqes.

- Qetësohu, pra. Këtu e kam, — u detyrua të gënjenite Ridvani, — Dhe ik nga mamaja. Ik pra, nisu.

— Ika, ika. Natën e mirë!

- Natën e mirë, — tha Ridvani, mbylli telefonin dhe i ra ziles.

Në dhomë hyri gardiani.

- Ku e keni çuar atë mutin?
- E ka marrë mjeku në dhomën e tij.
- Si është?
- Erdhi në vete po gojën nuk e ka hapur akoma.
- Ma sill këtu se ia hap unë.

Grigorin e sollën me vig. Sa pa hetuesin u tkurr si të ishte një zvarranik dhe priti gjithë frikë goditjen e parë. Ridvani përdrohni buzët.

— È shikon si je katandisur? Si një krimb toke që tkurret sa e prek me gisht. Para një jave ishe si div. Ime shoqe kur të pa atë mëngjes nga dritarja të dalloj menjëherë prej gjithë atyre kalimtarëve të rrugës së Durrësit. Si thua, je gati të fillojmë, ë? O shpirtin, o do më thuash nga ç'fshat je? O, po kjo? Ç'do të thotë kjo? — u habit Ridvani.

Grigori lëvizi vetëm njërin sy, Tjetri ishte vrarë aq keq sa kishte humbur atë shkëlqim të veçantë, atë dritë që vetëm syri e ka. Ishte kthyer në një si zar, i qelqtë vërtet, po që nuk komunikonte më. As jepte, as merrte. Ishte shuar njëherë e përgjithmonë jeta në atë sy.

— Ou. — tha sërish Ridvani, — po unë budallai të pas-kam prishur njërin sy?! Po me këtë tjetrin shikon mirë? Ashtu?

Grigori i bëri shenjë se shikonte. Ridvani u kënaq që komunikoi.

— E po, gjysma e së keqes. Dhe me një sy e shikon gjithë botën, — shtoi Ridvani dhe i ra përqark vigut e doli te këmbët e Grigorit, mori nga tavolina pincat e thonjve dhe sapo zgjati dorën që të shkulte sa për fillim thoin e vogël të gishtit të vogël, i cili është më i kollajshëm për t'u shkulur, u hap dera e dhomës dhe hyri si veri mjeku duke lëvizur në ajër dorën sikur të mbante në të flamurin e bardhë të paqes. Flokët i kishte të shpupurishura, jakën dhe kollaren të hapur. Bëri tepër i dërmuar ato katër pesë hapë dhe ia zuri dorën Ridvanit. Duke ia hequr pincat i tha që ta ndiqte nga pas deri në dhomën e tij. Ridvani u bind dhe, i tërhequr përdore si të ishte fëmijë, i vajti pas doktorit.

— C'dreqin ke që më tërheq si kalama? — e pyeti hetuesi.

— Prit, kur të vemë në dhomë. S'dua të na dëgjojë njeri.

— Po këtu çdo gjë dëgjohet, regjistrohet. Nuk e ditke ti këtë gjë?

— Ani. Dua të jem vetëm për vetëm.

— Mos e ke fjalën për Grigorin?

— Sigurisht. Për kë tjetër, — tha i shqetësuar mjeku.

— Më duket se të gjithëve po ju zë magjia e tij.

— Vdiq ajo. Sonja, Sonja e ambasadorit.

— Unë di që ajo dështoi, — tha i trembur hetuesi.

— Dështimi është i shpjegueshëm, kurse vdekja... ja, s'ka dhjetë minuta. Dhe para se të vdiste kishte përmendur emrin e këtij tonit, Grigorit.

— Grigor është emër rus. Grisha i thërrisin shkurtimisht.

— Ambasadori thotë se në fisin e saj s'ka asnjeri me emrin Grigor.

— Mbështetjet do jetë ndonjë dashnor i saj i hershëm.

— O, ti gjithnjë i merr gjérat...

— Mos duhet të besoj dhe unë në magjinë e Grigorit? Se dhe ime shoqe çoc ka lëvizur. I duket se ai, Grigori, i vete në dhomë të gjumit dhe rri në karrige dhe e shikon.

— Në djall të venë të gjithë. Unë kam hallin tim dhe tëndin. Mos e torturo më Grigorin, more vesh?

— Po c'të bëj, ta përkëdhel, t'i jap qumësht me kaka?

— Ai po vdes. Ai nuk e ka të gjatë. Duhet shtruar urgjentisht në spital.

— Po u shtrua në spital mua nuk ma japid më për ta pyetur. Vdiq dhe karriera ime. Ky mut është shansi im i fundit, o bëhem prapë hetues, o kushedi se ku do të më degdissin. Ministri më tha copë dje në telefon. Duhet të zbulojmë emrin e fshatit dhe qëllimin pse u hodh kjo dreq magjie në ambasadën sovjetike. Tani që vdiq dhe gruaja e ambasadorit...

— Prandaj të them të kesh kujdes. Ty të kanë vdekur dhe të tjerë në proçes, apo jo? Prandaj dhe të shkarkuan.

— Ç'dreqin ka që qënka kaq keq?

— Veshkat i ka copë. Do ja kesh dërmuar fare. Gjak bën, jo shurrë. Ja analizat, — tha mjeku dhe i tregoi me gisht një copë letër mbi tavolinë, — dhe mëlcia, shpretka...

— Ato mund të kenë qënë të sëmura që në fshat, që në fëmijëri. Thirri mendjes doktor!

— Unë po të paralajmëroj si shok. Ai po vdes. Duhet ta shtrojmë në spital. E di sa kocka i ke thyer?

— Në spital jo. As mos e hap gojën. Le të flasë e pastaj merre e çoje ku të duash dhe studioje si ta kesh qejfin. Unë kam punë me të. Ministri pret, — tha Ridvani dhe u lëkhye në dhomën e tij të torturave dhe i qëndroi mbi kokë djaloshit nga fshati.

Syri i mirë i Grigorit u tremb.

— Mos ki frikë, nuk do të të torturoj. Mjeku sapo më tha që je i sëmurë nga veshkat, nga mëlcia e shpretka. Më tha se je nisur për në atë rrugë. E merr vesh se për ku, ë?

— Po, — tha Grigori që çuditit Ridvanin dhe mjekun të cilët u panë sy më sy.

— Atëherë më thuaj nga ç'fshat je dhe pse e bëre këtë magji. Ja, këtë. E shikon? — e pyeti Ridvani dhe i tregoi torbën, ia hapi dhe ia vuri te koka gjithë ato vogëlsira që mbushnin shaminë.

Me të parë torbën Grigorit iu err syri.

Mjeku e përkëdheli sikur Grigori të ishte një fëmijë dhe i foli:

— Dale, dale. Mbaje veten. Nuk je dhe aq keq tani. Mos ki frikë. Nuk vdes kaq kollaj njeriu.

Grigori puliti sytë. Rrudhi ballin. Nën koren e plagëve, nga lëvizja e lëkurës, plasën kapilarët e vegjël të gjakut.

Syri i mirë i Grigorit u hap. U hap dhe ai i keqi që nuk shikonte. Në syrin e mirë hetuesi pa frikën e vdekjes. E njihetë mirë se si shfaqeja ajo në sy, në fytyrë dhe u gëzua. Ishte një çast kritik në detyrën e tij të vështirë. Po ta lije të kalonte ai moment i torturuari mund të kalonte në gjendjen më kritike, në vëtmohim, që ishte vdekje për të si hetues. Ndjenga e lashtë e hakmarrjes bëhej armë në ndërgjegjen e trupit të cflilitur dhe ai ishte gati të therorizohej veç mos i' i jepte atë kënaqësi hetuesit.

— Do të flasësh apo të të çoj në esfel, në atë botë, ë? Ç'doje ti atë mëngjes para ambasadës sovjetike me këtë torbë? Pse e hodhe atje magjinë? Veç teje kush e di punën e magjisë? Kush të çoi atje? Po fol, o qen! Fol se të erdhi sosja, — humbi durimin hetuesi dhe ngriti dorën. Mjeku nuk e la ta qëllonte.

— Dëgjo këtu, Grigor! E ke në dorë jetën tënde. Të rrosh apo jo. Nuk e kuptoj pse ngurron? — ndërhyri mjeku.

Syri i vrarë i Grigorit lëvizi. Qepallat u hapën. Syri i mirë u mbyll. Grigori u bind se njëri sy i kishte ikur. Në atë errësirë ai pa fare qartë tërë fshatin e tij të mbledhur në kishë po jo si çdo herë. Këtë radhë njerëzit ishin ngjeshur sipas familjes, fisit. Ishin tok burra, gra, fëmijë e pleq, dhe çdo familje ose fis kishin vënë në mes të parin e shtëpisë.

— Nga çfshat je, ë? — dëgjoi Grigori zërin e mjekut të cilin e dalloj menjëherë.

«Po i thashë emrin e fshatit gjithë fshatin e mori lumë. Më mirë të vdes unë. Punë e madhe! Një bari më pak. Unë gjysmën e jetës që më ka mbetur e kam falur për Stalinin, çerekun e kam jetuar.

— Hap syrin tjetër, qen. Jo këtë të shuarin, — ulériu Ridvani.

Syri i keq mezi u mbyll. Me dhimbje. I miri u hap gjithë drojë.

Ridvani u gëzua sërisht. Ai pa aty frikën e vdekjes.

— Mirë, — tha Ridvani i kënaqur, — ti bëj tënden,

hesht. Unë do bëj timen. Më qafë paç vëten, — tha dhe e qëlloi me shpinën e dörës në fytyrë, pastaj më pincat që i kishte bërë gati ia hoqi thoin e gishtit të vogël.

Dhimbja therëse sikur e këputi Grigorin në mes. Dhimbja ishte e padurueshme. Pas torturës së parë do të vazhdonte e dyta, e treta deri në pafundësinë e natës e të ditës, nëse do të arrinte të rezistonte. Grigori mbylli syrin e mirë dhe ra në errësirë. Ai nuk pat provuar gjatë gjithë asaj jave atë që ndjeu në atë torturë të vogël, të shkuljes së thoit të gishtit të vogël të këmbës. Ai sikur dëgjoi një zë fëmije që i pëshpëriste në vesh dhe i lutej ta shpëtonte nga dhimbjet. Grigorit iu duk sikur e njihte atë zë. E kishte pas njobur që kur s'mbahej mend.

Një kovë me ujë iu hodh në fytyrë.

— S'do ta lë të çlodhet. S'do ta lë as të bëjë gjumin e torturës, — pëshpëriti me zë Ridvani.

— Jë i vetmi hetues që të fiktin e quan gjumin e torturës.

Të gjithë fjalët Grigori i dëgjoi shumë të qarta ndonëse ato i pérziheshin në zërin e fëmijës që vazhdonte t'i lutej.

Grigori turfulloj nga uji i ftohtë që iu përplas në fytyrë. Në fillim iu hap syri i keq. Ai pa në atë mjergullnajë qumështore një fëmijë të vogël duke ikur me vrap. Grigori hapi dhe syrin e mirë si për t'u bindur nëse ishte e vërtetë ajo që shikonte syri i keq, fëmijën duke vrapuar nëpër mjergull si të ishte një engjell i pistë, i veshur me rroba leshi e opinga lëkure me dy xhufka si lulëkuqe. E pa vërtet dhe u trondit. Ai fëmijë ishte ai vetë. Syri i mirë dhe syri i keq u përlotën. Grigori ishte i pari njeri në këtë botë që shikonte veten fëmijë. Me fytyrën e tij tërë plagë e viza të holla gjaku të mpiksur u ndeh një kënaqësi e buzëqeshje të cilën s'mund ta kenë veç njerëzit e lumtur po me shpirt të pastër.

Mjeku i ra me bërryl hetuesit dhe i bëri shenjë të vinte re fytyrën e përgjakur po të gjuar të Grigorit. Hetuesi s'dalloi gjë.

— Q'ka? — pyeti hetuesi.

— Nuk e shikon?! Ai është duke vdekur, ose është çmendur.

Hetuesi u zbeh në fytyrë.

— S'ka se si të shpjegohej ndryshe kjo fytyrë e paqme, e lumtur, e qeshur.

— Do ta ketë zënë gjumi, — tha hetuesi dhe i shkuli thojin tjetër.

Grigori u drodh sikur ta kishte zënë korenti. Dy sytë e tij u hapën njëherësh.

— Dëgjo, bir bushtre, o fol o të varrosa të gjallë. Hiç mos më shiko ashtu. Pse habitesh? Hamdi, o Hamdi! — thirri hetuesi.

Hetuesi, mjeku dhe Grigori dëgjuan një gërvishjtje metalike çjerrëse që të linte përshtypjen e hapjes së një dere që nuk ishte hapur prej vitesh. Dera ishte një pllakë metalike e puthitur pas murit aq sa nuk binte në sy. Së andejmi doli Hamdiu, një polic i veshur keq, me uniformë tepër të çrrëgullt, me këpucë pa lidhi. Ai nderoi gjysmë ushtarakisht dhe pa pritur urdhërin qetësahu u afrua si njeri i shtëpisë. Barkun e kishte të madh, gjoksin të gjerë, nofullat na, sa të një divi. Sytë dhe mustaqet sikur i kërcenin nga fytyra.

— Ç'e do Hamdiun? Ç'ke ndër mend të bësh? Do t'i thyesh prapë ndonjë kockë? Për ideal të Partisë nuk të lë, — ngriti zérin mjeku. — Nuk është në gjendje të përballojë më asnjë lloj frakture. Ky po vdes. Nuk e shikon?

Grigorit i lëvizi syri i keq. Çuditërisht ai sy i dëmtuar sikur ishte shkëputur nga i zoti dhe kishte fituar pavarësi. Ai ishte bërë shumë më i ndjeshëm e vigjilent se syri i mirë. Grigori nuk besoi në atë që po shikonte syri i keq. Hamdiun iu duk sikur e kishte parë diku, në ushtri apo në qendrën e lokalitetit, në ndërmarrjen e grumbullimit, apo në postën e kufirit?

«Po më njobu, ç'do të bëj? Ç'do të them? Hiç, do ta mojoh. Aq duan këta sa të marrin vesh emrin e fshatit, pastaj e shtrojnë në dajak me kuç e me maç dhe pa e marrë vesh të vërtetë iku fshati, u bë pluhur e hi. O, nënë! Më jep zemër, o nënë!».

Gjatë atyre shtatë ditëve Grigorin e kishin ballafaquar me shumë njerëz. Me cigareshitësin e rrugës së Durrësit, me këpuçarin, me shitësin e bulmetit, me një anëtar të frontit të bllokut, me dy policë e dy civilë. Të gjithë ata pohonin se atë mëngjes e kishin parë në rrugën e Durrësit dhe se i kishte pyetur ku ishte ambasada sovjetike. Grigorit i dri-

dhej mishi, i kërcisinin kockat e thyera, i dhimbnin plagët e torturave kur dëgjonte se si gënjenin këta njerëz të cilët ai nuk i kishte parë kurrë. Ambasadën sovjetike ai e dinte se ku binte, siç dinte se ku binte edhe rruga e Durrësit. Grigori heshtte para pohimeve të tyre. Mohonte me kokë e me sy. Grigori as mund të thoshte se e dinte cila ishte rruga e Durrësit dhe cila ndërtësë ishte e ambasadës sovjetike nga frika se mos zbulohet se dikur kishte pas qenë nxënës në shkollën e mesme bujqësore.

Grigori rënkoit. «Oh, sa mirë do të qe të bëhem si me më gjithë sërisht fëmijë i vogël, ashtu me opinga lope me xhufka të kuqe. Fëmijë që s'di të flasë akoma».

— Hamdi, — u dëgjua zëri i hetuesit, — sill arkivolin, disa gozhë dhe çekiçin.

— Si urdhëron, shoku Ridvan. Zëre se i solla, — tha Hamdiu dhe doli po nga ajo derë që hyri.

Në dhomë ra një qetësi prej varri. Mjekut i qeshi nuri. Ridvani ndezi një cigare «Labinoti», e thithi si i etur disa herë, pa se si u formua koka e kuqe e cigares dhe e shoi gjithë nervozizëm mbi ballin e Grigorit.

Grigori s'bëri zë. E duroi. Vetëm mbajti sytë mbyllur deri sa ndjeu frymën e hetuesit që fryu mbi ballin dhe largoi pluhurin.

— Ç'e do arkivolin, — foli mjeku me zë të lartë i bindur që do e dëgjonte dhe Grigori.

— Më duket se ky vdiq, apo jo? Cigaren që ia shoja te balli as e ndjeu fare, pa shikoje një çikë, i rreh zemra? — tha hetuesi duke i shkoqitur fjalët.

Mjeku i kapi pulsin dhe duke vënë buzën në gaz tha paksa i hutuar dhe me keqardhje:

— Mezi ia dëgjoj.

Hamdiu solli arkivolin dhe e vuri krahas vigut. Si një njeri që e dinte shumë mirë se çduhej të bënte e kapi përmes Grigorin, e ngriti peshë dhe e plasi në arkivol.

Grigori, që i kishte dëgjuar të gjitha fjalët, hapi syltë. Dhe i miri dhe i prishuri ishin njëlloj të zgurdulluar. Ai u bind që e futën vërtet në arkivol. U bind që fjalët e injekut dhe të hetuesit ishin të vërteta.

«O zot, mbama gojën», — tha me vete Grigori duke prioritë ndodhët një nga ato çuditë e ikonave të kishës së fshatit.

Hetuesi mori kapakun e arkivolit dhe ia vuri me atë kujdes që vihen kudo në botë kapakët sipër arkivolave po duke e lënë pak mënjanë që t'ia shikonte si pér të fundit herë fytyrén.

— E, — pyeti hetuesi, — si thua, do të flasësh apo do të shkosh në atë dynja, ë?

Grigori puliti syrin e mirë, duke parë me habi e tmerr se ç'po ndodhëte.

— Të dola borxhit. U bë një javë që më lodhe. T'u luta me të mirë, t'u luta me të keq, të torturova ty e veten time. Doktori thotë se ti je nisur pér në atë botë. Shko. Do të jesh njeriu i parë në këtë dynja që po shkon atje i gjallë. Gozhdët m'i solle? — ngriti zërin hetuesi.

— T'i solla, si s't'i solla. Ja ku i ke. Dhe çekiçin.

— Shko thirr dhe Adnanin. Vetëm s'besoj se e mban dot. Varri gati éshtë?

— E, hu! Që në mëngjes. Janë tri varre të hapura.

— Këtë vëre atje, nën hijen e fikut. U bëmë miq dhe s'dua që ta zërë vapa.

Hamdiu mezi mbajti të qeshurën.

Grigori nuk po u besonte veshëve. Po qeshte apo po qante ai që quhej Hamdi?

Hetuesi dhe mjeku u panë sérish sy më sy. Hetuesi lëvizzi kapakun duke e mbyllur më ngadalë se sa kur bie nata. Grigorit po i zihej fryma. Një ankth po e pushtonte të térin. Ai lëvizi këmbët pér t'i bindur se ishte gjallë, se çdo gjë që po ndodhë ishte një fanepsje, një èndërr e ligë me sy hapur. A nuk pa ai pak më parë vetveten èngjëll me opinga lope e xhufka të kuqe që ecte nëpër mjergull? Këmbët që i lëviznin u tkurrën. Dhimbja e gishtërinje pa thonj që u përplasën pas arkivolit e gézoi. Ai lëvizi shpatullat. Arkivoli ishte i ngushtë. I ndjeu me sup dy paretet anësore.

«Po verifikon veten», — tha mjeku dhe u bë kureshtar.

Grigori u bind përfundimisht. U kontraktua si një sustë çeliku dhe i ra me gjunjë kapakut të arkivolit që po ia zinte frysmin. Kapaku u ngrit përpjetë.

— Mos, mos! — ulëriu Grigori dhe i dha trupit përpara, u ngrit ndenjur, duke mposhtur çdo dhimbje kocke të thyer dhe, apo mblodhi fuqitë e fundit pér të dalë nga arkivoli, ndjeu një goditje në kokë, një grusht të rëndë që e trullosi.

— S'ke ku vete, qen bir qeni. Tu dhimbskajeta, ë? Kur të do bytha flet. Aty do të ngordhësh, — shfryu gjithë; inat hetuesi dhe si e ngjeshi me duart e tij. Grigorin në arkivol, si të kishte të bënte me një thes me kocka të thyera, i vu kapakun. Po me atë inat mori gozhdën e parë dhe e mbërtheu me çekic. Dhe pse gozhda kishte hyrë brenda ai vazhdoi të gediste.

Arkivoli gjëmoi si daulle pastaj sikur mori rrrokullimë mës bubullimash e shkrepimash që nga maja e malit të xhveshur deri sa ra në një qetësi të shurdhët në një errësirë të plotë e të rëndë, pa ajër, pa dritë. As jetë, as vdekje. As në qelli, as në tokë, as nën tokë. Ankthi e mbyste. Sikur të mos ishin dhimbjet e torturave ai do të kishte vdekur. Lëvizzi dorën. Gishtërinjtë pa thonj e ndien dërrasën e arkivolit. Sa më shumë që prekte dërrasën aq më shumë e ndiente dhimbjen e gishtërinjve që nisën të njomeshin nga gjaku.

«Qen kam gjallë», — i foli vetes po në vend që të qetësohej u drodh sikur të kishte prekur në korent dhe thirri më të madhe, si të ishte në fund të pusit, në të dalë të fshatit.

— Po thërret, — foli mjeku. — Hapja, hapja se mund të çmendet.

— Në djall të vçjë, — iu përgjigj hetuesi, — zaten ai i çmendur është.

Grigori i dëgjoi zërat mbytur, sikur i vinin nga qelli, pastaj dëgjoi ca zëra të tjérë tepër të njohur bile ai dalloj fare qartë zërin e kryetarit të këshillit të fshatit që shante zdruktarin e kooperativës.

— C'janë këto gozhdra të ndryshkura. Sigjete katër gozhdë të mira. Kështu do ta fusin në dhe xha Mitin? Ku janë djemtë, ku është Grigori, se atij i vjen dorësh. Hë mor bir, mirë se na la xha Miti, po pa kapak s'do ta fusin në dhe? Xha Miti, shokë, është i pari në fshatin tonë që ia fal jetën e tij të shitenjtë Stalinit të madh. E fali me gjithë zemër. Ja, vdekja e tij flet më shumë sejeta e tij. Shqiptari e ka patur dhe e ka zakon që kur jep fjalën e nderit nuk kursen ar birin, as jetën e tij. Rroftë Stalini i madh, martë nga ditët tona ashtu siç ia kemi premtuar të gjithë në letrën që i quam atje larg në Tiranë, në ambasadën sovjetike. Shokët të përgatiten sipas listës. Hë, u gjetën ajo gozhdë të shkreta apo jo?

— U gjetën, o Sofo, u gjetën, — thirri sekretari i organiza-

tës së partisë, sytë e të cilit gati po i dilnin nga zgavrat. Gjithë ata që shikonin pëllëmbën e dorës së shtrirë të Grigorit bënë kryq e nisën të falen të çuditur e të trembur. Tamani në pëllëmbën e Grigorit po mbinin si fidane katër gozhdë. Dhe vetë Grigori u habit se ç'po ndodhte në pëllëmbën e tij, se si rritheshin katër gozhdë të sermta dhe se si, duke u rritur gozhdët, i mbushej dhe dora me gjak.

— Mbërtheja bir, — foli nënë Marga duke bërë kryq, — zoti dhe Stalini i madh qenkan me ty. Ja thagma: në pëllëmbën tënde mbinë gozhdët.

Grigori mori një nga një gozhdët dhe i mbërtheu me një lehtësi të çuditshme. Në fillim e dëgjoi goditjen e çekiçit mbi gozhdë pastaj sikur çdo gjë u shurdhua. Nuk dëgjohej as dhe një zog i gjallë, as fletët e pemëve, as kroi që rridhete. Grigori mbeti vetëm për vetëm me arkivolin. Asnjë këmbë njeriu nga gjithë ai kallaballék që mbushte varrezat sikur i përpriu dheu. Po zhurmat kush i shoi? Po ky, im atë, pse vdiq? Kur vdiq? Apo s'ka njeri në arkivol? — tha me vete Grigori i trembur dhe lëvizi arkivolin. Arkivoli ishte i lehtë pupël, si pa peshë. E hapi kapakun që sapo e kishte mbërthyer dhe shtangu. I ati ishte aty. I verdhë dyllë, si çdo i vdekur, veçse fytyra e tij çuditërisht ishte e lumtur, e qetë, me një paqë e qetësi sikur flinte për shtatë palë qejfe.

«Babë, je i gjallë apo i vdekur, babë! Më thuaj ç'të bëj me ty, babë! Jemi vetëm për vetëm, babë! S'na shikon njeri. Fol, babë! Ç'të bëj me ty, ë?

Arkivoli filloi të gjëmonte si daulle, sikur brenda të ishin mbyllur njëqind shejtanë.

Mjeku kapi për mëngë hetuesin dhe sërish iu lut:

— Ai po përpëlitet. Hape sa nuk është vonë. Hape të them!

Hetuesi e hapi kapakun dhe e shtyu pak majtas. Të dy u përkulen mbi arkivol. Grigori ish qullur i téri nga një djerse sikur në atë botë të kishte pas rënë brymë. Mjeku u habit, fërkoi sytë dhe e pyeti hetuesin.

— Ore, më duket se flokët e këtij qenkan thinjur?! Ky sikur i kishte si të verdhë flokët, apo jo?

Hetuesi nuk iu përgjigj. E zuri për jake dhe e ngriti Grigorin ndenjur. Sa e lëshoi Grigori ra sërish në arkivol ashtu siç qe pak më parë, pa ndjenja, qull në djersë dhc krejt i thinjur.

Mjeku e pandehu tē vdekur. Zgjati dorën dhe u çel nē fytyrë kur ndjeu pulsin.

— Gjallë qenka, gjallë. Veç mē çudit se si u thinjka njeliu pér pesë minuta.

— Pse pesë minuta e mbajtëm tē mbyllur?

— Plot pesë minuta, — u përgjigj mjeku.

— Po sytë pse nuk i hap? Mos pandeh se është akoma nē atë botë? — pyeti me ironi hetuesi dhe gjithë delikatesë, sikur tē kishte tē bënte vërtet me një tē vdekur i hodhi disa pika uji nga gota e tij drejt e nē kapakët e syve.

Grigori puliti qepallat.

— Po i hap, — pëshpëriti mjeku kureshtar dhe i habitur, — lere tē qetë. Aman lère tē qetë. Tē shohim si do reagojë.

Fytyra e Grigorit, ashtu, gjysmë e ngrirë, shprehte tmerr dhe ankth bashkë. Lëkura e zbehtë, e mbushur me gjak tē mpiksur, iu duk mjekut një maskë si ato tē indianëve tē Amerikës e lyer me lloj-lloj baltërash e lëng pemësh.

As dielli e as hëna nuk lindin aq ngadalë sa ç'nisë Grigori tē hapte sytë. Mjeku, tepër i gëzuar nga gjithçka po ndodhët, i bëri shenjë hetuesit që tē priste. Më nē fund Grigori i hapi sytë dhe zbuloi më shumë se gjysmën e kokërdhokëve. As te syri i keq, as te syri i mirë nuk kishte asnijë shenjë jete. Grigori dukej tamam si një i vdekur që po ngjallej sërisht.

— Ka frikë tē hapë sytë, — tha mjeku.

— Është tinzar. I pëlqen tē luajë tē vdekurin, — u përgjigj me inat hetuesi.

— Do tē ketë besuar që vdiq e tanë nuk i besohet që është gjallë, — nguli këmbë nē mendimin e tij mjeku.

— Dëgjo këtu, o bir kurve, mjaft luajte teatër me mua. Hapi sytë! — urdhëroi hetuesi.

Grigori u bind. I hapi sytë. Ishte aq i lodhur, aq i dërmuar sa do tē qe vërtet i lumtur nëse s'do tē qe hapur kurrë kapaku i arkivolit dhe ishte gati tē vdiste vërtet veç tē mos ia mbyllnin më kapakun e arkivolit. Ankthi e tmerrri qe jo vetëm nē sytë që u hapën po dhe nē fytyrën e tij prej maske. Një luftë e tmerrshme dukej ashiqare nē tërë qénien e tij.

— Kot e ke që mundon veten. Fol tē shpëtosh. Apo do një kafe? — pyeti hetuesi.

Mjekut i grishi miti

— Nje kafe do tē ishte ilaq, — tha mjeku.

— Hamdi, bëji kafe! — urdhëroi hetuesi.

Me tē dëgjuar fjalën kafe iu kujtua i ati, atë ditë që vdiq. Atë ditë Grigori piu gjithë xhezven e madhe me kafe që e ëma sapo e kishte hequr nga zjarri.

«Lojte mënc? Ç'bëre, o ditë zi! Ne s'kemi kafe për botën, ti e pi si ujë. Shko porosit arkivolin dhe therr ndonjë bëgëti. Hajde, nisu!

Sytë e Grigorit iknin e vinin. Aty i humbte shikimi aty i ngjallej. Ishte tamam si një njeri që vdes e ngjallet, ngjallet e vdes, e nuk merr vesh se c'po ndodh.

Kur Hamdiu pruri kafetë mjeku zgjati dorën, e futi në arkivol, nën shpinën e Grigorit dhe e ndihmoi tē ngrivej.

— Hajde, hajde! Po tē mbajmë dhe me kafe, pale! — u tall hetuesi.

Mjeku ia mori dorën për t'i dhënë filxhanin e kafesë. Të pesë gishtérinjtë pa thonj ngjanin si pesë thëngjij të ndezur. Mjafton t'i fryje dhe ato mund tē merrnin flakë si pësse shkarpa.

— E mban dot filxhanin? — pyeti mjeku.

— E mbaj, — mezi foli Grigori dhe lëvizi gishtérinjtë, tē cilët kapën filxhanin. Sa e vuri në buzë, sa piu gllenkën e parë pa sërish tē atin tē vdekur, shtrirë në shtrat, tē veshur me rrobat e mira, i rruar e me një nur tē paqëm prej tē krishteri që shkon i qetë në botën e përtejme sikur atje do tē çlodhej e do tē prehej i sigurt në parajse.

«Pse vdiq im atë? Ai qe shëndoshë si molla? Ç'donte ai majë çatisë? Si vdiq? Pse vdiq? O nënë». — rënkoj Grigori dhe, si piu dhe pikën e fundit tē kafesë, hapi sytë.

— Ashtu, — tha i kënaqur mjeku. — Tani tregoi hetuesit se si është ajo puna e magjisë, asaj që hodhe në ambasadën sovjetike.

— Magjisë — tha Grigori dhe në çast iu kujtua shkaku i vdekjes së tē jatit.

— Hë, — e nxiti mjeku i gjëzuar që metoda e tij po jep te rezultate.

— Im atë vdiq pas tre ditësh. Vdiq shumië shpejt. Ai kërkoi tri ditë afat sa për të rregulluar çatinë që pat pikuar kur ranë shirat, — nisi tē tregojë Grigori.

— Dëgjo këtu, bir kurve! Mos m'u shit mua si i lajthi-

lur a ~~llat~~ ^{llat} percakt. ~~Unë~~ ^{Unë} dua të di kush e bëri këtë. magjinë. E shlikon këtë apo jo? — ujeriu heqesi dhe ia ngjesht ^{ia} ~~ia~~ bën në fytyrë.

Grigori u përmend dhe u tremb.

«O, nénë, ti që ma dhe gojën merrma prapë», — tha e uli svtë përdhe, te këmbët, te arkivoli.

— Ngrijj sytë qen, dhe fol ose...

Mjeku i ra në bryl. Hetuesi i nervozuar, mezi e mbajti yelen.

— Nuk e shikon se si po tallet? Ne e pyesim për magj�-
në ky flet pér tē atin.

— I ёштэ tronditdur psiqika. Shikoje, ky sikur ёштэ shnärfvlyuar.

Grigorit iu ngjall sërish në sy i ati dhe fshati me ato rrugica të shtrembta, shtëpitë prej guri, mbuluar po me rrasa guri, malin e zi që i rrinte e i rëndonte si saç mbi çatitë, përroin gjithë zhurmë që shtronte valën e tallazin vetëm në luginë, pranë shelgjeve dhe selvive, aty buzë mullirit të xha Tushit.

— Si quhet fshati, ë? — pyeti me zë të butë mjeku i bindur që po hynte në lojë.

Grigorit i iku nga syri i mirë fshati, sikur ju mjergullua e u mbulua në çast, si në përrallë, me një pelerinë të zezë, të stërmadhe. Pelerina e mbuloi dhe atë vetë. Ajo ishte e rëndë sikur të ishte e endur me fije plumbi. Grigori ra, gjysma e trupit, bel e sipër, ra jashtë arkivolit. Mjeku me Hamdinë mezi e drejtuan dhe e futën sic qe para se ta ngrinin për të pirë kafe.

= I ra tē fikët, — tha mjeku.

— Bëji një gjilpërë mutit, sille në vete. Për ideal do t'ia marr shpirtin e do t'ia hedh në hale! — tha hetuesi.

— Shef! — foli mjeku, — ky po lëviz buzët, po flët.

— Bëji gjilpërën pra, ç'pjet! — ngriti zërin het

= Veç t'i bëj një kafeinë. S'kam ç't'i bëj tjetër

— Atë e di ti. Unë dua të flasë, të nxjerrë zë.

— Ate e di ti. One dudu te riase, te mja.
Grigori nuk reagoi fare nga injekzioni.
— Lermë, o doktor, t'ia marr shpirtin me zor. Ky millet
yec me dajak merr vesh.

— O nënë! — foli me gjysmë zëri Grigori.

— O nene! — ion me gjysme zeri qirri. Hetuesit iu dridh dora që mbante kamxhikun. Doktorit i qeshi nuri.

— Ke për të parë po s'foli. Po deshe e vëmë në bast, — tha mjeku.

Grigori i hapi të dy sytë. Mjeku u përkul mbi ballin e Grigorit. Vështrimi i shuar e i papërqëndruar nisi të qartësohej deri sa dalloj mjekun pastaj hetuesin.

— U zbut, — pëshpëriti hetuesi, dhe duke iu afruar te veshi i foli: — Fol, veç fol. Thuaj ç'të duash.

Mjeku nuk po e kuptonte se ç'po ndodhët me pacientin e tij fytyra e të cilit mori një pamje kërcënuese. Dhe buzët, që pak më parë kishin lëvizur si të ngrira u gjallëruan e thirrën gjithë ankth:

— Mos, mosni! Na, Murro, Balo! Ejani këtu. Desh të shqyen qentë, o Sotir.

— E mo, doktor, e dëgjon se ç'na prallis? Ky vazhdon të tallet me ne. Ky do çuar i gjallë në atë dynja. Ja tregoj unë qejfin këtij qeni e bir qeni, — tha i nxehur hetuesi dhe sa i hante krahu goditi gozhëtë me çekiç, puthisi kapakun e arkivolit dhe gjithë inat godiste me çekiç mbi kapakun e mbërthyer.

— Pam, pum. Pam, pum!

— Ham, hum. Ham, hum!

.. Dy qenve nuk u pëlqeu ardhja e sekretarit të rini-së. Ata, ndonëse u qetësuant nga Grigori, vazhdonin të lehnin:

— Ham-hum! Ham-hum!

— Ç'kanë këta qentë me mua? — u ankua si me të qe-shur Sotiri.

Grigori mblodhi supet e për të shfajsuar qentë foli:

— Mbështetjet me habere të këqija, o Sotir!

— Shumë të këqia. Lum si ti që je larg fshatit e nuk merr vesh se ç'bëhet në botë.

— Mos ka ndodhur gjë nga shtëpia? — tha i trembur Grigori.

— Shtëpia na marri të keqen. Stalini nuk është mirë, po vdes Stalini. Ti ke tri ditë që s'je dukur në shtëpi. E verifikova. Ngrehu të zgresim bashkë. Për ty u ngjita deri këtu. Si organizatë ne duhet të jemi të gjithë sonte në mble-dhjen e madhe të fshatit. Ka ardhur shoku Ali nga komiteti i Partisë së qytetit dhe Xhezua i komitetit rinisë. Hajde nisu. Jemi vonë.

— Po dhentë ku t'i le? Të m'i hajë ujku?

— Le t'i hajë. Ato të kooperativës janë. Përgjegjësinë e mbaj unë. Kam ardhur me urdhër të kryetarit. S'duhet të mungojë asnjë.

Grigori u tremb dhe iu vu si manar sekretarit të organizatës së rinisë së fshatit.

— O Sotir, po ti harrove që unë jam i përjashtuar nga organizata e rinisë? C'ne unë tanë në mbledhje?

— Në fatkeqësi duhet të jemi të gjithë tok. — Mbledhja bëhet me gjithë banorët e fshatit, — iu përgjigj Sotiri.

Grigori ktheu kokën nga stani. Qentë lehnin si të tèrbuar.

Dhe në fshat lehnin qentë.

— Më shumë u dhimbset qenve Stalini se sa njerëzve, — foli si nëpër dhëmbë Sotiri duke parë me inat Grigorin që u bë shkak të vonoheshin aq shumë.

— Nuk është e vërtetë, — kërceu Grigori si për të hequr nga vetja atë akuzë, — Mos e thuaj atë fjalë se është e rendë e nuk e mban çdo njeri. Në më ke shok siç më ke patur në Tiranë, kur ishim në shkollë, më thuaj si është e vërteta?

— I ka rënë hemoragji cerebrale. Te koka ka mjekët më të mirë të Bashkimit Sovjetik, — tha me lot në sy Sotiri.

Dhe Grigorit iu mbushën sytë me lot.

— E dashke dhe ti, e dashke! — u habit Sotiri dhe pa më dhimbsuri ish shokun e ngushtë.

— C'flet budallallëqe, si s'e dashkam!

— Për ideal të ngatërruar jeni ju pa triska fronti! — u habit Sotiri.

— Hiç s'jemi të ngaftëruar. Si gjithë njerëzit dhe ne.

— Ashtu qoftë, megjithëse do ta shohim në mbledhje se sa e doni Stalinin, — preu bisedën Sotiri dhe mbërtheu kopsat e bluzës, meqë i ishin afruar sheshit të kishës, në mes të fshatit. Sotiri bëri dy-tri hapa të matura dhe u distancua nga shoku.

Në kishë ishin futur aq shumë njerëz sa Grigori dhe Sotiri mbetën te dera. Jashtë çdo rrëgulli e zakoni, para ikonostasisë, ishte vendosur një tavolinë e mbuluar me beze të kuqe. Në të kishin zënë vend shoku Ali i Komitetit të Partisë së qytetit, sekretari i rinisë së qytetit, Xhezua, kryetari i kooperativës Sofoja, sekretari i Partisë së fshatit, kry-

etari i Frontit të fshatit dhe Oli, Kryetarja e gruas, dhe në cep fare rrinte si mbi gjeniba papa Mihali mbi shpinën e të cilit dukej sikur do të binte shigjeta e Shën Gjergjit majë kalit.

Sotiri i bëri shenjë kryetarit, Sofos, që erdhëm.

Sofua i tundi kokën dhe diç i pëshpëriti në vesh sekretarit të rinisë së qytetit.

— Atëherë fillojmë, — tha Sofaja pa lëvizur nga vendi.

Fytyra e tij ishte e zbehtë, e pa gjumë, me lot në sy dhe më e pikëlluar se e shën Marisë që rrinte e heshtur, me kokën pak mënjanë pranë të birit të kryqëzuar, aty në ikonën e madhe mbi presidiumin e mbledhjes. — Fjalën e ka sekretari i rinisë së qytetit, shoku Xhezo, i cili do të lexojë gazetat që sapo na i sollën nga qyteti.

— Pse, — u habit Grigori, — ne na paskan pritur?!

— Nuk e shikon që kanë ardhur edhe nuset me gjithë kalamaqër?

— Heu! — u habit Grigori dhe i erdhi mirë që një fshat i tërë s'fillonte nga mbledhja pa ardhur dhe ai.

Xhezua, duke pastruar zërin nxori nga xhepi gazeten «Zëri i Popullit» dhe nisi t'i lexojë sipas datave. Zëri i tij ishte i pikëlluar sa s'kishte ku të vinte më.

Buletin mbi gjendjen shëndetësore të shokut Stalin në ora 2 e mëngjesit të datës 4 Mars 1953.

Natën, duke u gdhirë 2 Mars 1953, J.V.Stalin pati pa pri-tur një hemoragji cerebrale që prëku pjesë të trurit me rëndësi jetike. Si pasojë u paralizua këmba e djathtë dhe kra-hu i djathtë; me humbjen e ndjenjave e të folurit. Në 2 dhe 3 Mars iu bënë mjekimet e nevojshme për të përmirësuar funksionet e çrrëgulla të frymëmarrjes e qarkullimit të gjakut. Gjer tanë këto masa nuk kanë sjellë ndryshime të rën-dësishme në sëmundjen.

Në ora 2 të mëngjesit të datës 4 Mars gjendja shëndetësore e J.V.Stalinit vazhdoi të jetë e rëndë. Konstatohen çrrëgullime të rëndësishme në frymëmarrje. Shpejtësia e marrjes frymë gjer në 36, me pushime periodike të gjata. Konsiderohet gjithashtu një shqetësim i pulsit gjer në 120 të rrahura në minutë, tensioni arterial maksimum 220 dhe minimumi 120. Temperatura 38° . Për shkak të çrrëgullimit

· në marrjen frymë dhe të qarkullimit të gjakut ka mungesë oksigjeni. Shkalla e çrregullimit të funksionimit të trurit është shtuar pak. Po zbatohen tani një seri masash terapeutike pér t'i rivendosur funksionet e organeve me rëndësi jetike.

Nënshkruar nga:

A.F.Tretiakov, Ministër i shëndetësisë i B.S.; I.I.Kuperin, nënkyrytar i drejtorisë mjeksore dhe shëndetsore të Kremlinit. Profesor P.E.Lukomski, kryeterapeutist pranë ministrisë së shëndetësisë të B.S Profesor N.V.Konovalov anëtar aktiv i Akademisë së Shkencave mjeksore. Profesor A.J.Miasnikov anëtar aktiv i Akademisë Shkencore mjeksore. Profesor E.M.Torejev anëtar aktiv i Akademisë Shkencore mjeksore. Profesorët I.N.Filimonov, I.S.Gllazunov, R.A.Tkaçev, docent V.I. Ivonov — Nezmanov.

Xhezua u mbush me frymë. Pushoi pak, pa me pikëllim nga shoku Ali dhe vazhdoi po me atë zë të pikëlluar:

*Komunikatë mbi sëmundjen e rëndë të shokut Stalin.
Moskë 4 Mars*

(TASS)

Komiteti qëndror i Partisë Komuniste të B.S. dhe Këshilli i ministrave të B.S. njoftojnë fatkeqësinë që goditi Partinë tonë dhe popullin tonë me sëmundjen e rëndë të shokut J.V. Stalin.

Natën duke u gdhirë 2 Mars, kur ai ndodhej në Moskë në apartamentin e tij shoku Stalin pësoi një hemoragji cerebrale që preku pjesë të trurit, që janë të rëndësishme pér jetën. Shoku Stalin humbi ndjenjat. U shkaktua paralizimi i krahut të djathët dhe i këmbës së djathët pastaj ai humbi të folurin. Turbullira të rënda u shfaqën në funksionimin e zemrës dhe në marrjen frymë. U thirrën personalitetet më të mira mjeksore pér të mjekuar shokun Stalin P.E.Lukomski, profesor terapeutist; anëtarët aktivë të Akademisë së Shkencave mjeksore të B.S N.V. Komovallov, profesor A.J.Miasnikov profesor terapeutist. E.M.Torejev, profesor terapeutist, I.N. Filimonov profesor nervopatolog, I.S. Gllazunov profesor nervopatolog, V.I.Tvonov — Nozmanov, docent terapeutist.

Mjekimet i bëhen shokut Stalin nën drejtimin e A.F.Tretiakov Ministër i shëndetësisë së B.S. dhe S.I.Kuperin nën kryetar i drejtësisë mjekësore dhe i shëndetësisë së Kremlinit.

Mjekimi i shokut Stalin po vazhdon nën mbikqyrjen e vazdueshme të K.Q. të P.K. të B.S. dhe qeverisë Sovjetike.

Duke marrë parasysh gjëndjen e rëndë shëndetësore K.Q. i P.K. të B.S. dhe Këshilli i ministrave e quajtën të nevojshtme të botohen që sot buletinë mjekësorë mbi gjëndjen shëndetësore të Josif Visarianoviç Stalinit.

K.Q. i P.K. të B.S. dhe Këshilli i ministrave e gjithë Partia dhe gjithë populli sovjetik janë të ndërgjegjshëm mbi gjithë rëndësinë e faktit; që sëmundja e rëndë e shokut Stalin do të sjellë një ndërprerje shumë a pak të gjatë të pjesë-marrjes së tij në veprimtarinë drejtuese.

Për sa i përket drejtimit të Partisë dhe të vendit, K.Q. dhe Këshilli i ministrave i kanë plotësish parasysh të gjitha konsekuençat që sjell pushimi i përkohshëm nga ana e shokut Stalin e veprimtarisë së tij drejtuese në shtet e në Parti.

Komiteti Qëndror dhe Këshilli i Ministrave shprehin sigurinë se Partia jonë e gjithë populli sovjetik do të tregojë në këto ditë të vështira unitetin më të madh, qëndrueshmërinë morale e vigjilencë, do të dyfishojë energjitetë në ndërtimin e komunizmit në vendin tonë, do të bashkohen në një grusht rrëth Komitetit Qëndror të Partisë komuniste e rrëth Qeverisë së Bashkimit Sovjetik.

K.Q. i P.K. të B.S.

Këshilli i Ministrave të B.S.

Buletini mjekësor ora 16. të datës 5 Mars.

Moskë sipas TASS-it.

Gjatë natës dhe gjysmës së parë të ditës gjendja shëndetësore e Stalinit u keqësua. Çrregullime të mëparshme të funksioneve më të rëndësishme të trurit iu shtuan ndryshimet aktuale të sistemit kardio-vaskular. Në mëngjesin e 5 Marsit gjatë 3 orëve u vunë re fenomenet e pamjaftueshme të frysëmarrjes. Në orën 8 të mëngjesit u zhvilluan simptomat

e pamjaftueshmërisë së fryshtëmarrjes dhe vaskulare okulli (kolopssus).

Tensioni arterial ra, pulsi u shpeshtua dhe të zverdhurit u shtua. Elektrokardiograma tregoi ndryshimin akut të qarkullimit të gjakut në arteriet koronare të zemrës.

As për Pashkë kur lexohej ungjilli i madh nuk kishte rënë një qetësi e tillë. Të gjithë ishin si të shushatur sikur trupi i Stalinit nuk ishte atje larg në Kremlin po aty, në kishën e madhe të Shën Vangjelit brenda altarit dhe do të rronte apo do të vdiste e kishte në dorë fshati Kurtiz, rrëzë matlit, të zi, buzë detit, dallgët e të cilit, të largëta e të shurdhëta, hynin nga dritaret anësore të kupolës së kishës, ku zoti Krisht, veshur me pelerinën e tij të çngjyrosur e të ciflour, bekonte me dorë nga lart-poshtë. Grigori pa sytë e Krishtit. Ngaqë nuk e duroi dot atë vështrim sikur gjeti qetësi në dy engjëj lakuriq që ndiqnin njëri-tjetrin.

Qetësinë e kishës e pushtoi kërcitja e një karrigeje. Kryetari Sofo u ngrit dhe gati i ngashëryer i dha fjalën shokut Ali, të dërguarit të Komitetit të partisë së qytetit. Dhe ai ishte i ngashëryer, gati-gati me lot në sy e me një ngulç në fyt i cili nuk e linte të fliste. Ngashërimi, dhimbja, kujtimi i tij sikur ishte i ngjitshëm, si një sëmundje. Si ai ishte i gjithë presidiumi i fshatit dhe të gjithë fshatarët e mbledhur shuk e grusht njëri pas tjetrit si ato delet në vathë. Përveç Papa Mihalit plak që rrinte si mbi gjemba aty në presidium, sikur mbante në atë kurrizin e tij të dalë një turp, një mëkat që po ia kërruste dhe më shumë shpinën.

— Nuk jemi mbledhur përtë qarë, as për të ngushëlluar si mund t'ia ketë qejfi ndonjërit edhe këtu. Jemi mbledhur siç mblidhen kudo në botë njerëzit e varfër, punëtorët e fshatarët, jemi mbledhur përtë treguar forcën tonë, dashurinë tonë për Stalinin e madh e të pavdekshëm. Ne si fshat çduhet të bëjmë, ë? Këto dy ditë doli një iniciativë e madhe që shpreh dashurinë, respektin e madh të popullit tonë për gjeniun e kohërave. Sot është dita e tretë dhe unë sot munda të vij mes jush, ashtu siç erdha dhe në kohë të luftës dhe në ditët e formimit të kooperativës. Populli shqiptar edhe këtë radhë, në këto ditë të vështira, e gjeti rrugën e tij dhe mënyrën e tij përtë shprehur besnikërinë dhe dashurinë.

Në qytete, në lagje, fabrika, itzina, në fshatra, në kooperativa njërezi mblidhen ja si këtu sot dhe me gjithë shpirt janë ditë, muaj, vite nga jeta e tyre për Stalinin e madhi. Që kur lindi kjo iniciativë kam genë në njëmbëdhjetë mbledhje të tilla dhe kjo është e dyshimtë dhe, si të gjithë dëkun unë jam bashkuar me popullin, kam dhënë nga jeta ime. Dhe këtu do jap por kam qejf të shikoj siç po ju shikoj kështu të pikëlluar dhe t'ju dëgjoj se si do i të shprehni ju respektin e dashurinë tuaj për Stalinin. Sa vite jetë nga jeta juaj do t'i falni atij? Populli ynë ka një shprehje të artë: «Marq nga ditët tonë». Shokë erdhi dita të tregojmë veten, të nderojmë fshatin, kombin tonë. Stalini nuk duhet të vdesë, shokë!»

Vdekja e Stalinit sikur u bë e vërtetë. Grigori zgjati kokën për të parë se ç'po ndodhë. Ai do të besonte sikur nga altari të nxirrin trupin pa jetë të Stalinit e ta vinin në mes të Kishës. Sikur të kishte kaluar vërtet hija e vdekjes salla u drodh, dhe njërezi panë njëri-tjetrin të hutuar. Disa plaka bënnë kryq. Nuset shtrënguan në gji fëmijët. Teto Nasta, e emë e kryetarit Sofo, e cila e kishte mbajtur me bukë e kripë shokun Ali gjatë luftës, e kishte larë e ndërruar njësoj si Sofon, ia kishte shëruar plagët me lot e me melhem, u ngrit dhe tun-di para presidiumit shkopin që mbështetej kur ecte, një shkop i thatë thane i nxirë e i tymosur.

— Ke të drejtë nënë Nasta dhe të na rrähësh me atë shkop. Në fakt unë nuk desha që kjo mbledhje të bëhej këtu në kishë, po këta, shokët kryesorë të fshatit, ngulën këmbë për këtu se fshati s'paska sallë tjetër që të na nxejë të gjithëve. U thanë disa arsyë dhe ja, teto Nasta, që s'ia përton, na tregoi shkopin. Këtu është kishë, ashtu ëshië, kishë, dhe njërezi mund të impresionohen. Është vend i shenjtë, vend i zotit po të mos harrojmë, shokë, se edhe gjatë luftës ne jemi mbledhur e kemi punuar edhe në vende të shenjta. Në kisha, xhami, teqera e manastire. Dhe s'na gjeti gjë, përkundrazi, fitur. Teto Nastia, ka të drejtë, po unë do t'i shpjegoj asaj mbështetëse mbledhjes, kur të vete të pi kafenë. Se veç zotit të madh të saj, Krishtit, ka edhe një zot tjetër. Është Stalini, shokë! Për të jemi mbledhur vëllezër e motra, është dashuria për të që na mbledhje këtu dhe ne duhet të tregojmë sonte se sa e duam. Nuk po e lë për në fund, po e them që tani. Në njëmbëdhjetë mbledhjet që kam organizuar i kam falur Stalinit gjithsej dyshimtë vjet jetë nga jeta ime. Këtu, në fshatin

tua j, që unë e quaj dhe fshatin tim po i fal edhe kater vjet jetë ngajeta ime. Ai të na rrojë, shokë. Se nga ai...

Kisha gjëmoi nga duartrokitjet pa fund. Aliu nxori shaminë dhe nuk i erdhi zor të fshinte lotët.

— Shokë, lerini duartrokitjet, këtu jemi në kishë, shokë!
— thërriti Aliu.

U desh të ngrihej Sofoja që të vendosej një farë qetësie. Kisha ziente si të ishte një koshere gjigante dhe jo me bletë të buta apo të egra; po me njerëz të gjallë si në ethe. Gjithçka u shthur, njerëzit filluan të lëviznin si milingona duke spostuar e duke zëvendësuar njëri-tjetrin si të verbërit që preknin me dorë shoqi-shoqin.

— Ç'po ndodh? — pëshpëriti shoku Ali.

— Ku ta di unë! — tha Sofoja i habitur.

— Ç'kanë që lëvizin? Ç'kérkojnë? — pyeti sërish Aliu.

— Njëri-tjetrin. Po mblidhen si familje, si fise, si dhentë kur..., — prifti e preu fjalën. Dy sytë e tij të thellë e të thatë si dy puse bosh kishte vetëm frikë dhe tmerr.

Grigori nuk duroi dot. Zbriti ato 5-6 shkallë të brendshme të kishës dhe duke çarë me bërryl nisi të afrohet drejt ikonostasit, pranë ikonës së Shën Mëhillit që dhe ai, majë kallit si Shën Gjergji, rrinte dhe vështronë i habitur. Më në fund Grigori iu afroa të atit, të emës, vëllait të madh që i kishte marrë të shoqes fëmijën dhe ia bënte me dorë Sifit, vëllait të vogël që të afrohej dhe ai.

— Shyqyr që erdhë, o bir, — pëshpëriti e ëma dhe zuri për dore Grigorin.

— Dëgjoni këtu çuna, — pëshpëriti Mit Kurtezi, — unë duhet të flas, bile që në fillim.

— Ç'kc ndër mend të bësh, o burrë, — e qortoi e shoqja, Marga.

— Na e do puna të flas i pari. Mbase u heq fëmijëve njo llën që u rëndon mbi shpinë. Mirë unë që do të vdes pa triska fronti, po këta ç'faj kanë?

— Ç'hyn triska e frontit këtu, baba, — foli i hutuar Grigori.

— Hyn bir, hyn!

Kisha sikur po qetësohej. Njerëzit gjetën njëri-tjetrin.

— Kush do të çajë akullin, — i pëshpëriti Aliu Sofos, — ke përgatitur njerëz që të solidarizohen, ë?

— Më erdhi zor, o Ali, Si t'u thoja njerëzve jepni jetë për Stalinin?

— Po komunistët, ç'thonë?

— Në organizatë thanë se do të flasin.

— Ku i ke? Apo janë strukur pranë grave? Mirë, mirë, vendos qetësinë. Sa më shumë që të zgjatë ky hutim, aq më keq është.

Sofua hypi mbi karrige dhe ngriti të dy duart lart dhe i tundi në ajër, nën këmbët e gjakosura të zotit Krisht që po e zbrisnin nga kryqi për ta varrosur. Koka e Krishtit ishte e varur si e këputur. Megjithatë sytë e tij të mëdhenj, gjithë dhembje e dashuri, shikonin turmën e mbledhur në kishë.

— Qetësi, shokë! Qetësi! Ju pak më parë duartrokëtit shokun Ali kur tha që si total ka falur gjashtëmbëdhjetë vjet jetë.

— Dhe kam dëshirë, shokë, — ngriti zërin Aliu, — që emri im të regjistrohet këtu, në listën e fshatit tuaj, të cilin e quaj si fshatin tim.

Sofua, ashtu siç i pat duart të hapura nën këmbët e gjakosura të Krishtit, i përplasi njëra pas tjetërs. Pas tij kisha gjëmoi sérish nga duartrokëtit. Salla se si u elektrizua!

— Me leje! — ngriti zërin dhe dorën Miti Kurtezi.

Si shuhet vala në tenxhere kur i hedh ujë të ftohtë u shua tërë kisha nga zëri i xha Mitit.

Një mizë e keqe u dëgjua të zukasë nervoze. Ajo vinte vërdallë si e plagosur. Donite të dilte e s'dilte dot.

— Bobo! — pëshpëriti Aliu, — pse me kulakët do ta nisim listën?

— S'është kulak, shoku Ali, është pa triskë fronti.

— Jo mut, po shurrë, — pëshpëriti i pakënaqur Aliu.

— Të mos ia jap fjalën atëherë?

— Prit. Po u ngrit dorë tjetër mos ja jep, po s'u ngrit...

— Hë, mo shoqë, kush e do fjalën, — ngriti zërin Sofua duke parë në krahun tjetër.

Po fshatarët, që e donin dhe e respektonin xha Mitin, ia lanë radhën atij.

— Jepja, jepja shpejt, — përshpëriti Aliu.

— Hë, xha Miti, fol. Më fal se s'ië vura re.

— Jo për gjë tjetër, se unë e di ku e kam vendin dhe siranë, po me që jam më i moshuar, pas xha Lazarit që nuk ka ardhur se është në shtrat të vdekjes, thashë të them dy fjalë

para se tē jap jetën time. Unë jam bariu i kësaj grigje tē vogël ja, i plakës sime, i tre djemve tē mi, i nuses së djalit dhe i këtyre vocrrakëve. I mblodha rrëth vëtes e u thashë se dua tē flas. Ç'flas unë, është ligj pér këta.

— Jo, jo, xha Miti, — e ndërpren Aliu, — sot kanë ndryshuar gjërat. Sot qdo njeri është i lirë dhe zot i fatit tē tij. E arritëm më në fund këtë ditë. Ti fol pér veten tënde, ashtu si e ndjen ti pér Stalinin e madh. Përsa i përket shqetësimit tënd se je me triskë fronti apo pa triskë fronti kjo është një gjë tjetër që e mendon dhe e zgjidh Partia. Dashuria pér Stalinin ka rrënëtë tē thella. Ja dhe te ty ajo ka rrënëtë me gjithëse...

— I ka si nuk i ka — tha prerë e ftohtë xha Miti tē cilët nuk i pëlqeu ndërrhyrja e Aliut.

— Sa tē shkruaj? — pyeti Sofoja si pér tē kaluar, radhën.

— Sa tē duash, o Sofo. Unë plak jam.. Cairën time e kam ngrënë që kur. Ky që e kam mbi kokë, Shën Mëhilli që e paçim uratën, e di kur e kam ditën.

— Thuaj, thuaj, sa? — e ngacmoi Aliu si pér ta ngrohur plakun e pér t'i dhënë kurajë gjindjes që dëgjonte me gojë hapur.

— Gjithë c'më ka mbetur, — ngriti zérin dhe kokën gjithë krenari xha Miti e si me inat shtoi duke treguar me shkop ikonën e Shën Mëhillit: — Bile që sot, që tanë le tē vijë ky. Veç ama, dhe këtij dhe juve ju lutem pér një gjë tē vogël. Jo pér triskën, o shoku Ali, jo. Dua tre ditë afat sa të rregulloj çatinë se më pikoi dje kur ra shiu. S'dua t'i lë pa zënë ato gjerba. I di unë rasat e çatisë sime. Tri ditë e jam gati tē vdes unë e tē na rrojë Stalini sa malet që kemi rrëth e pér qark:

Marga nisi tē qajë. E qara e saj u dëgjua në qetësinë e kishës dhe e drodhi ajrin e mbushur me temian.

— Më mirë tē qajë Marga ime se sa tē qajë gjysma e botës, — tha gjithë solemnitet xha Miti sytë e tē cilët xixëlluan sikur në qast të ishin ndezur përballë tij dy qirinj.

Xha Miti nuk vuri re se dora me pesë gishtërinjtë e djalit tē vogël Sifit po i nxirrte sytë.

— Prit, o Sifi. — foli xha Minai, — krushku i xha Mitit, — je i vogël tē dalësh para pleqve, ka rradhë mulliri.

— Ti xha Mina qofsh me nder, më fal që kërcëva po

rradha iu dha Kurtezëve. Dhe unë jam Kurtez nga baba ndaj më takon të flas pas tij dhe të them se Stalini nuk është vetëm i brezit tuaj, i pleqve. Ju luftuat me emrin e tij në gojë, kurse ne u rritëm me hijen e tij. Ai është babai ynë, shkruaj njëzet vjet nga unë, Josif Kurtezi.

Grigorit i erdhë çudi me gojtarinë e të vëllait. Në kishë gjëmuani duartrokositjet. Ato i përkisnin edhe atij, sepse Josifi është vëllai i tij. Nëse pak më parë, kur ishte duke ardhur në këtë mbledhje bashkë me sekretarin e rinisë së fshatit, Sotirin, ish shokun e tij, i pat thënë se e donte Stalinin, që i bindur se ato fjalë i tha edhe nga frika, i tha se duheshin thënë, kurse tanë, duke dëgjuar duartrokositjet, ai besoi se e paskësh dashur vërtet Stalinin dhe për çudi krahu i tij u ngrit lart e kërkoi leje të flasë.

— Shënomëni dhe mua, 10-15-20 vjet! — tha dhe ndjeu se një lëmsh lotësh po i zinin fytin.

Xha Minai, krushku i xha Mitit, ngriti dorën.

— Prit xha Mina, prit, e ka rradhën dhëndri yt, Dhosi. Xha Miti ka tri djem apo jo? E mo Dhosi, apo ti mban anën e xhaxhait. — e ngacmoi Sofoja i cili nuk i honepte dot Kurtezët, sidomos atë xhaxhanë e arratisur në kohën e formimit të kooperativës. Sa punë i hapi atij ajo arratisje! Fshati i tyre hyri i fundit në kooperativë në gjithë qarkun.

— Xhaxhanë s'ke pse ma kujton, o shoku Sofo. Ai iku për të zezën e tij dhe tonën. Dhe vdiq i mërguar, vdiq a e vranë, a e varrosën apo jo, një dreq e di. Veç unë di një gjë. Nëse ai xhaxha do të më kishte këruar jetë ngajeta ime nuk do t'ia jepja kurrë, kurse Stalinit i jap. Shënomëni sa të duash, — tha Dhosi dhe u ul.

Fshati nuk duartrokiti për Dhosin. Hija e xhaxhait e ftoku mbledhjen.

Në mes të kishës u ngrit një dorë e thatë e plakut vëmitar e qyqar, xha Melsit, i cili me zi u mbush me frymë e pa pritur leje nisi të flasë me një zë si të këputur. Gjithë gjindja e kishës mbajti frymën.

— Po ky kush është? — pyeti Aliu.

Sofoja mblodhi buzët.

— Nga mosha vjen pas xha Mitit. Nga mendt është i pari i fshatit. Po shëndetlig. Çudi, si qenka ngritur nga shtrati!

— Jeta që më ka mbetur nuk më dhimbset hiç. Jam qyqar e barrë për komshinjtë. Për vete lus zotin të më marrë.

Them shyyqyr që po më lënë sytë se, të them atë që s'duhet thënë, që kur kam lindur, s'kam parë një ditë që ta mbaj mend. Luftëra, varfëri, zibiti sikur të jemi të mallkuar. Zoti dhe ju të gjithë që po më dëgjoni të më falni. Burri që është burrë është bërë pér të duruar e jo pér t'u qarë. Nejse, nuk e kam fjalën këtu, po do thoni ju pse i thashë? I thashë që të mos më pandehni hileqar. Ja, do mendoni ju, erdhi dita dhe xha Melsi gjeti rastin t'ja bëj peshqesh jetën e tij Stalinit. Jo. Më dënoftë zoti dhe në botën tjetër. Dua të të pyes, o shoku Ali a mos bëj keq që t'i jap Stalinit ngajeta ime? Jam i sëmurë. Dhe Stalini i sëmurë, apo jo? Mos vallë jeta ime e molepsur në vend që të bëjë mirë i bën dëm Stalinit, ë? Ju që i dini punët bëni si të doni, daç shkruani emrin tim, daç jo. Unë timen e bëra.

Sa u ul xha Nelsi u ngrit shoku Ali.

— Dëgjoni, dëgjoni, — u mundua të vendosë qetësinë. — Mua personalisht po më pëlqen shumë serioziteti i kësaj mblehdhjeje dhe sinqueriteti i atyre që kanë folur deri tanë. Një gjë duhet të kemi të qartë, motra e vëllezër. S'ka gjë më të dhimbshme se jeta, por ama kur ju ngriheni njëri pas tjetrit dhe falni jetën tuaj që të rrojë Stalini nuk ka gjë më të madhërishme. Ky aksion duhet parë si një fitore e madhe politike e ndërgjegjes sonë. Çfarë s'ka kërkuar Partia dhe nuk e keni dhënë, ë? Ju bëri thirrje në kohën e luftës dhe ju u ngritët si grusht i vetëm. Ndatë kafshatën e hidhur të bukës, ndatë shëllirën, ndatë jatakët dhe dhatë lulet më të bukura të fshatit njëzet e tetë djem petrita ranë dëshmorë. Dhatë dhe ato çika tokë që kemi nxjerrë me thonj dhe ato cika bagëti që mezi i kemi ushqyer dhe u bashkuat tok në kooperativë. Një u nda nga tufa e këtij fshati, u tremb e iku, vëllai i xha Mitit, i kötyre tre djemve. Po ja, shokë, këta Kurtezot, u ngritën të parët dhe dhanë jetën e tyre. Ç'i thoni kësaj, ë? Si tha Dhosi, ë? Po të më kishte kërkuar jetën ja xhaxhai s'do t'ia jepja, kurse Stalinit ia jap.

Kisha gjëmoi nga duartrokitjet. Dikush u ngrit nga fundi e bërtiti:

— Mos e zgjat më, o shoku Ali. Merr listën e bukës te shoku Sofi dhe thirri një e nga një emrat, ose shëno aq sa ke dhënë li si total.

— Jo, jo! — ngriti zërin shoku Ali; — Në asnje mënyrë

në mënyrë globale. Jo. Secili për vete. Aq sa ju thotë zemra. Ju a thashë, shokë e shoqe. Ky është një aksion i madh politik dhe me shumë përgjegjësi. Mendoni shokë kur të vejë lista e fshatit tuaj, me emrat tuaj, në Kremlin, te Stalini, ë?

Kisha u shthur. Njerëzit të mbledhur tok e shuk, sipas familjes, për të qenë pranë e pranë, u shpërndanë si të çliruar.

Shoku Ali u përpooq të vinte qetësinë po qe e pamundur. Turma, si e çliruar nga një ankth, s'përmblahej. Aliu rrëmbeu shkopin e papa Mihalit dhe me të filloj të godasë tavolinën...

... Grigori dëgjoi të trokitura sikur t'i binin me vare mu në kokë. Goditjet i vinin me dhimbje që fillonin nga brendësia e trurit, te kafka e kokës. Ndonëse hapi sytë s'pa asgjë. Një errësirë e dendur, e rëndë, frymëmarrëse. Nuk arriti dot të përmendej, të kuptonte se ku ishte: në kishën e fshatit, apo në një vend që zor se mund të ekzistojë në botë, në një kovaçanë të ngushtë sa një varr dhe ku koka e tij ishte një-kohësish edhe kudhër edhe varë dhe ai vetë, me duart e tija godiste vetveten. Vetëm kur u hap pak, fare pak, kapaku i arkivolit, aq sa mezi rrëshqiti një fashë e ngushtë drite, ai besoi se nuk ishte në kaosin e kishës së fshatit, as në atë vendin që zor se ekziston në botë. Fashoja e dritës zgjerohej dalëngadalë. Syri i mirë pa se si hyri drita dhe veshi i kapi atë zhurmë të thatë të fërkimit të dërrasave të kapakut me pjesën tjeter të arkivolit. Grigori u bind se nuk ishte i vdekur por nuk u bind se ishte i gjallë. Ç'donte ai në atë arkivol? Pse ikte e vinte nga ajo botë në këtë botë? Ç'donin më prej tij? A nuk i tha ai gjithë ç'i panë sytë në kishën e fshatit të tij?

— Fol, qen! — ulëriu zëri i hetuesit.

Zëri i fortë e goditi në fytyrë Grigorin dhe e trembi më fort se goditja e kamxhikut.

— I thashë, — mërmëriti i frikësuar dhe i hutuar Grigori i cili u zgjua, u përmend dhe pa se ku ishte ai vend aq i çuditshëm, arkivoli i tij i magjishëm;

— Ç'farë the, mor mut, kur i the? E dëgjon, o doktor? — foli hetuesi duke parë me inat mjekun.

— Thuaji dhe njëherë, o qen bir qeni! Fol pra... ato që na the. përsëriti.

Grigori u tkurr si krimbi i bindur se tani mbi fytyrën e tij do të binte sërish ajo vare e rëndë.

— Ky po tallet me ne, o doktor!

— Jo, — kundërshtoi doktori. — kur i mbyllëm kapakun e arkivolit ky nisi të lëvizë buzët. s'të kujtohet? Mbësë ka folur në kllapi. Ky vazhdon të jetë në gjendje kllapie. Kllapia kuptohet kur syri është i përhumbur, i shuar dhe nuk reagon. Ja, shikoje. — shpjegoi mjeku e ia hapi kapakun e syrit të mirë. — E shikon? Bosh! S'ka jetë fare. Zemra i rreh sikur po shuhet dhe ajo, kurse truri... Paska një sistem nervor të çuditshëm. Reflekset i ka si të përgjumura.

— T'i hedh një kovë ujë? — pyeti hetuesi.

— Hidhi, hidhi. Të shohim si do të reagojë!

Një kovë uji u përplas në fytyrën e dérmuar të Grigorit. Gjuha e tij doli me zor midis buzëve të puthitura e të thara, lëvizi ngadalë nga e majta në të djathtë, mblodhi pikat e ujit nga rrëkeja që rrëshqiti nëpër mollëzat e faqeve plagë dhe u fut brenda në gojë. Sërish doli, bëri po atë lëvizje dhe sërish u fut brenda.

Mjeku u kënaq duke e parë. Mori gotën e ujit mbi tavolinë dhe hodhi disa pika në dy anët e hundës dhe ndoqi me kureshtje rrugën e pikave të ujit të cilat i priti gjuha. Sikur gjuha të kishte sy s'do të kishte pritur me aq saktësi.

— Iu pika ujë qenit, — konstatoi hetuesi.

— Sigurisht.

— T'i japim? — pyeti hetuesi.

— Prit, — u përgjigj mjeku i cili futi dy gishtat në gotën me ujë dhe i shkundi duke lëshuar disa pikëla uji mbi buzën e sipërme.

Rruja e pikave të ujit, pavarësisht se rrëshqisnin nëpër të çarat e buzëve të bëra pleh, ishte far e shkurtër për të rënë përdhe, po ja që gjuha i priste, i merrte me vete dhe i fushte në gojë.

Mjeku filloi të luajë me piklat e ujit, duke i hedhur gjithnjë e më afër buzës që ato ta kishin kohën e ngacimit të nervave të buzëve sa më të shkurtër. Po gjuha i kapte, si të ishte e paisur me antena.

— C'bën, — pyeti hetuesi, — po luan me të?

— Jo. Po bindem se ky paska instikte të përkryera. Nuk

e shikon se si kalon gjuha nga njëri cep i gojës te cepi tjetër dhe i mbledh piklat e ujit?

— Ashtu? — bëri sikur u habit hetuesi. — po dhe unë kam instikte të përkryera, doktor, — ngriti zérin dhe me sa fuqi që i hante krahu ia veshi fytyrës. Koka e Grigorit u përplas pas arkivolit. Sytë i lëshuan shkëndija.

Grigori pa një shkrepëtimë të gjatë që nga maja e malit deri rrëzë detit. Pastaj u err. Pus u bë. I trembur nga shkrepëtima dhe errësira, që ra si perde e zezë, ai thirri qenin dhe ndolli i alarmuar dhentë. Ndonëse errësira ishte e madhe ai shikonte qartë gjithçka: majën e malit, detin, dy re qumështore në qiell, valanidhet e rralla në korije, gjethet e shkurreve, barin që po shpërtihente në atë fillim marsi dhe që rritje si me magji dhe dhentë që shkëputeshin nga kullota e afroheshin të habitura. Kur e mbloindi veten Grigori pa se në qiellin e pastër s'kishte pasur asnë shkrepëtimë si ajo që i panë sytë. U bind se qe alarmuar kot gjoja e zu nata dhe shtërngata në mal. Në shpirt ndjeu një ankth, brengë e mall për të atin, sikur gjithçka që tha ai në mbledhjen e kishës, se i falte jetën e tij Stalinit veç t'i jepnin tre ditë afat, u bë.

Grigorit iu mbushën sytë. Ndonëse fshati ishte tutje, një orë udhë me çapin e dhenve dhe i fshehur pas degëve të kumbullave e thanave të çelura, ai pa si në pasqyrë të atin duke ndërruar irrasat e çatisë. Këmbët e Grigorit u nisën vetë drejt fshatit, pa marrë leje nga ai. Dhe pas tij dhentë e në fund qeni që i ngucente.

Pa iu afruar shtëpisë i doli përpara Sofoja dhe e priti me këmbët e para.

— Pse i zbrite dhentë? Ç'ka ndodhur?

Grigori u zu ngushtë. S'kishte se ç'gjenjeshtër të sajonte.

— Po, them të ndihmoj pak babanë.

Sofoja qeshi dhe i bëri rrugë.

— Atje e ke, majë çatisë, po puna tënde more djalë është në mal, me dhent, — e këshilloi Sofoja gjithë duke u tallur, — hë, ç'do të thuash, sikur u mate të flasësh, — pyeti Sofoja.

— Po, për Stalinin desha të di, u bë më mirë?

— Të ha meraku pér shëndetin e tij, ë? — qeshi Sofoja.
— Si s'më ha meraku? Shtëpia jonë i dha 35 vjet jetë,
veç tre ditëve të babait.

— Dhe ti pandeh se na i mbushiët mendjen me ato fjalimet e zjarrra. O ç'ju gënjen mendja, more qyqarë! S'ka triska fronti pér ju, jo!

— Nuk dhamë jetën tonë pér triskat, o Sofo? E dhamë se dha gjithë Shqipëria.

— Po, po, me fjalë s'ua del kush juve Kurtezëve, veç ujin nën rrugoz e shpinin në mullirin e tjetër kujt.

— Pse s'e thua tamam fjalën, o kryetar? — ngriti zërin Grigori dhe u habit me veten që foli ashtu me Sofo Bregun, i cili i ktheu shpinën, bëri sikur nuk e dëgjoi dhe iku.

«Plas po deshe» i tha vetes Grigori dhe nuk ndjeu fare se ishte rrëthuar nga delet të cilat ishin ngjeshur te këmbët e tij dhe i lëpinin duart e djesësitura.

— Ju rëntë ujku, — mallkoi Grigori dhe çau pérpara drejt shtëpisë.

I ati majë çatisë kishte ndezur çibukun e lëshonte shtëllunga tymi si oxhak.

— C'erdhe? — pyeti plaku.

— Të të ndihmoj.

— Skam nevojë. Nesër që është dita e fundit e mbaroj.

Grigori u ngjit nëpër shkallët e drunjta, mbështetur rrëzë murit dhe u ul pranë të atit.

— Ç'ka ndodhur? Ti s'më duke shënuar mirë, as jo e më, as vëllezërit? Ç'kini, ë? Pse qesh?

Grigori uli zërin e i pëshpëriti të atit.

— Po pi duhan si Stalini, me llullë, hajde Mit Kurtezi, hajde?

— Unë s'ia kam nevojën Stalinit, ai ma ka mua? Pa mua ai s'bën dot. Nesër ai do marrë ditët e mia, frymën time. E treta ditë nesër, ë? A do t'i a thonë vallë Stalinit se jetën e tij të dytë, pas lëngatës së vdekjes, e ka prej meje, ë?

— Emrin e ke i pari në listë, — thaq me të qeshur Grigori.

— Jo, i ndërruan emrat. Bënë listë të re, sipas biografisë, po ama i tërë fshati e di që i pari fola unë, i pari e dhashtë unë jetën dhe jo ashtu kot por pér tre ditë. Unë me një këmbë në varr jam. Shën Mëhilli ka kohë që më ka ardhur. Doli puna e Stalinit, hajt thashë t'ia jap atij. Një rrugë pér

në atë botë e dy punë. Çatia nuk pikon, e sajova kot sa përtu çmallur. E shikon si më dridhen duart? S'jam mirë, bir! Me dhëmbë po e mbaj shpirtin. Kam tre ditë që pështyj gjak. Enët e mijë dhe teshat e mijë digji. Veremin e kam të vjetër. Vetëm ti e di e mos e bëj për zë. Le të quhet se vdiqa për atë. Pas vdekjes sime duhet të mos ju shohin më me sy të lig.

— O baba, léri këto. Pa hajde zbresim dhe shtrihu në shtrat. Lëre dhe atë dreq llulle. Sofo Bregu e ka kuptuar hilën tênde.

— As që e ve në dyshim. Ai me armët e tia unë me të miat. Gjithnjë e kam mundur Sofo Bregun.

— Dhe ai gjithnjë sipër teje, sipër tërë fshatit. Dhe jo vetëm ai por tërë soji e sorollopi. Shkollën ma preu përgjysmë.

— Inatin mbaje fshehur. Je i zoti t'ia hedhësh me hile? Shtatë hile baraz me një trimëri.

— Po më mëson keq, o babë!

— Jo unë, bir. Koha.

Xha Miti thithi fort llullën po tymin nuk e kapërdiu dot. E mbyti kolla e i plasi gjaku. Mbi rrasat e çatisë u formua një rrëkezë.

Grigori lëshoi kujën. Në oborr doli plaka duke bërë kryq. Komshinjtë lanë bahçet dhe u sulën të ndihmonin Grigorin që ta zbrisnin xha Mitin nga oxhaku. Ishte punë që s'bëhej. Streha e çatisë nuk i lejonte burrat që ta zbrisnin. I tërë fshati u ngrit në këmbë.

— Shkallë të gjata, kush ka shkallë të gjata? — thërrisnin gratë, — po vdes xha Miti majë çatisë.

— E po kjo gjëmë kështu??

— E mbajti fjalën xha Miti. Tri ditë tha. E treta sot, ë?

— Nesër më duket se është e treta, nesër.

Sofua që kishte parë gjithçka me sytë e tij nga dritarja e zyrave të kooperativës u zbeh në fytyrë. Me dorën që i dridhej mori telefonin dhe kërkoi të lidhej urgjent me komitetin e partisë së qytetit.

— Alo. Aliun dua. Shokun Ali. I thoni se e dua pa derman. Jam Sofo Bregu, kaq i thoni. Faleminderit. — Dëgjo këtu ti moj fyckë, — iu drejtua centralistes, — sa të lidhesh me shokun Ali më thirr. Te xha Miti jam.

Oborri që mbushur plot, si për vdekje. Sepse të gjithë

ishin tē sigurt se xha Miti do tē vdiste. Dikush solli dy pälë shkallë tē gjata tē cilat i vunë dhe arritën deri buzë strehës së çatisë. Dy rradhë djemsh tē rinj tē fshatit, që poshië deri lart, u ngjitën e me duam e tyre e kapën xha Mitin dhe e pasonin shkallë pér shkallë duke e mbajtur me kujdes dhe me frikë. Kur e zbritën në tokë xha Miti hapi sytë. Fytyra e tij ishte e fikur, e vyshkur, e verdhë si një ftua.

— E po kjo thagmë! — përshpëriti një grua gjithë duke bërë kryq, — e kërkoi i ziu dhe i erdhi vetë vdekja!

— Xha Miti është i shenjtë, moj korbë! Tërë vuajtjet e dheut i ka hequr ditëziu e s'e tha një fjalë tē ligë, dhe jetën që i kishte mbetur e dha pér baba Stalinin.

— Nuk ka vdekur, moj gra! Mos ma qani burrin para kohe, — ngriti zërin e zemëruar Marga dhe u priu çunave të fshatit, që mbanin tē shoqin, koka e tē cilit mezi mbahej nga qafa kockë e lëkurë si qafë e rrjepur pule.

— Shoku Sofo! Shoku Sofo!, — u dëgjua zëri i hollë i centralistes, — telefoni nga qyteti.

Sofua mezi doli nga oborri i xha Mitit. Hyri në zyrë dhe rrëmbeu telefonin.

— Po vdes, o Ali. Po vdes xha Miti.

— E pastaj, — u dëgjua zëri i Aliut.

— Si pastaj. Po harrove ti që xha Miti u ngrit i pari në mbledhjen e fshatit, në Kishë, para tre ditësh?

— A... Po! Vërtet. Çudi,ë?! Tri ditë afat kërkoi. U bënë tri ditë, ë?

— Sot është e treta ditë.

— E ç'të keqe ka, — sikur u tall zëri i Aliut, — vetë i kërkoi. Nuk ia imponuan. Njerëzit dhe do vdesin.

— Më shqetëson fakti që ai i dha jetën Stalinit. Tani në fshat po thonë se Stalini rron nga ditët e xha Mitit.

— E pastaj? — u dëgjua sërisht zëri i shokut Ali.

— Si pastaj, — u habit Sofua, — po nëse Stalini do rrojë nga ditët e xha Mitit a mund ta trajtojmë atë dhe familjen e tij pa triskë fronti?

Në telefon u dëgjua një e qeshur që Sofos nuk i pëlqeu.

— Mbete fshatar, o Sofo ziu! — tha me dashuri e qesëndi zëri i Aliut.

— E po në fshat jam. Skam se si të bëhem qytetar në fshat.

— Mirë, mirë; mos u shqetëso farc. Shohim e bëjmë. Në dorë e kemi atë punë.

— Po vdiq do na hapë telashe. I tërë fshati në oborrin e shtëpisë së tij është.

— Mos u mërzit, Sofo. Mos u mërzit.

Pa vendosur dorezën në trup të telefonit futi kokën Grigori.

— Po ti, prapa derës paske qenë? — ulëriu Sofua.

— Mos e mbyll telefonin, — iu lut Grigori, — me që je i lidhur me qytetin, thuaju atyre të spitalit të dërgojë ambulancën:

— Ambulancën?! — u habit Sofua sikur t'i kishin kërkuar hënzen.

— Ambulancën, — tha prerë e me inat Sofaja. — Pse? Mos u bë pishman yt atë? Tri ditë afat kërkoi, tri ditë i dhëmë, — shtoi dhe nisi të dridhët një cigare si çdo njeri që e pi duhanin dhe ka qejf përmuhabet.

Grigori u hutua.

— Tjetri po vdes ti dredh cigare. Ke në dorë telefonin dhe nuk jep urdhër për një ambulancë?

— Mos u habit, o Grigor Kurtezi? — Në dorë e kam telefonin po sikur s'ma bën zemra ta kthej nga rruga tët atë. E para sepse ajo qe dëshira e tij. Vetë e kërkoi vdekjen, vetë ungrit i pari. Pastaj ju djemtë. Nuk është kollaj të jesh i pari!

— Po e zgjat shumë muhabetin, o Sofo! Im atë po vdes!

— Nuk ma mban. Ja, në dorë e kam telefonin dhe të lidhur me qytetin po të them të drejtën nuk ma mban.

— Pse? — u habit Grigori.

— Si pse? Po aq budalla s'jam unë që të marr ambulancën e të vijë mjeku ta mjekojë tët atë! Kështu, si kërkon ti, del që të rrojë yt atë e të vdesë Stalini. Po pse ma mban bytha mua një përgjegjësi të tillë, kur tërë fshati e di që yt atë ia falì gjithë jetën Stalinit e s'kërkoi asgjë, veç tri ditë sa të zërë gjerbat?

— Dale, dale, — ia preu fjalën Grigori.

— S'ka dale, dale. Ja, hajde ti këtu në vendin tim, bëhu kryetar e të shohim si do veprosh. Si do i thuash Stalinit? S'kam q'të bëj, o Stalini i madh. Për ne Shqiptarët është më e shtrenjtë koka e xha Mitit se koka tate, ë?

— Çdo njeri ka jetën e tij, — u përgjigj Grigori po jo shumë i vendosur.

— Po s'mund të jetë një'ojjeta e xha Mitit me të Stalinit? — u nxeh Sofua, — pse e bëmë ne mbledhjen, pse i gjithë fshati, e gjithë Shqipëria, që të mos them e gjithë bota u mblodh e secili sipas vullnetit të tij i fali jetën e tij Stalinit? Për ideal më vjen keq për ty e pér tërë familjen tënde. Si guxove ti të vish këtu e të kërkosh një ambulancë, një mjek nga qyteti kur vetë yt atë ia fali frymën e tij? Po sikur Stalini të kishte zgjedhur jetën tënde, ë? Do kishe sy e faqe ti t'i bëje bisht vdekjes?

Grigori u zbeh, u zverdh, u skuq. Një bojë i vinte një bojë i ikte. Ashtu, i hutuar, me sy të zgurdulluar, u mat të fliste, të shpjegohej po Sofua nuk e la.

— Lëre, mos e dhit muhabetin më shumë. Unë po e bëj një vesh shurdh e një sy qorr. Zëre se nuk erdhe. Mirë? Hë, fol, çdo të thuash? Fol, mos ki frikë.

— Aman, o Sofo, si e rrrotullon muhabetin ti. Ma bëre kokën dhallë.

— Hë pra, rrrotulloje ti ndryshe. Zëre se je ti kryetar, jepi ti dum këtij muhabeti. Po ama gjykoje punën me përgjegjësinë e kryetarit. Se ju, populli, e keni kollaj. Pësh-pësh në vesh të njëri-tjetrit e ç'nuk thoni. Duhet t'ju rëndoje mbi shpinë përgjegjësia, posti, pa të shohim se si do flisni. Ore, po të shohë çdo njeri bythën e tij e merr lumi popullin. Populli do bari, do fre, i do thënë ku është e mira ku e liga. Ju mblodhëm në kishë, ju thamë se si është puna e Stalinit, se Stalini është bariu ynë, se ai e di ku janë kullotat e ç'bar duhet të hamë, se ka dhe barëra të helmuara, apo jo? Ti e di mirë s~~a~~, je vetë bari, bile me shkollë. I bëre dy vjet më duket, ë? Nejse, ku ta kisha fjalën? Po, te Stalini. Dhe ju e dëgjuat dhe kuptuat se Stalini ështëjeta jonë dhe nuk ia kursyet jetën tuaj. Tani ti më vjen mua e që kam telefonin në dorë e thua thirr ambulancën. O Zot, në goftë se ka, hajde këtu në fshatin tonë dhe bëj sehir.

— Mirë do bëjë po të vijë, veç po iu mbush mendja, se s'ma ha kjo radakja që dhe zoti është nën urdhërat e tua, — tha i nxehur dhe i hutuar Grigori.

Dhe Sofua, që nuk e priste kurrë një fjalë të tillë, u nxeh, përplasi dorezën e telefonit e cila iu thye në dorë dhe brofi në këmbë.

— Eshtë, si s'është! Edhe zoti edhe shejtani janë në dorën time. Do ti të jap urdhër të therren gjithë pulat e oborrit e të mos dëgjohet më kënga e gjelit.

— Kënga e gjelave?! — tha Grigori me sy të çakërritur.

— Asnjë kakaritje pulash, asnjë kokë zogu, asnjë këngë këndezi, — tha gjithë kënaqësi Sofo Bregu, — dhe e di si do ta justifikoj.

Grigori mblođhi supet i habitur. Sytë e çakërritur i dolën si të bufit.

— Se dëmtojnë pasurinë e përbashkët.

Grigori shtangu. Nuk e merrte dot më mend se si do të ishte të nesërmen fshati i tij pa ato pula nëpër këmbë, nëpër gardhe, gura e qymezë. Kush do t'i këndonte mbrëmjes? Po në mëngjes kush do t'i zgjonte nga gjumi plakat e pleqtë e fshatit?

Grigori iu afrua shtëpisë. Qetësia nuk i pëlqeu. Oborri, i mbushur me njerëz, ishte si i shurdhuar.

— C'ka ndodhur? — pyeti Grigori sikur të ishte një kurbetli i largët që kthehej pas kaq e kaq vitesh e s'po e njihet shtëpinë e tij.

— Vdiq, — tha dikush.

— Të kërkoi ty. Ne i thamë se vajte te Sofoja për ambulancë.

— Jo, — kundërshtoi Grigori, — nuk qeshë te Sofoja për ambulancë. C'ne ambulancë? Ne ia dhamë vetë jetën tonë Stalinit. Babai kërkoi vetëm tri ditë afat.

Njerëzit u panë sy më sy por nuk folën.

7.

— Si thua, — pyeti mjeku hetuesin, — ta hapim arkivolin? Nuk më pëlqen që ka rënë në qetësi.

— Mos ka vdekur? — foli Hamdiu.

— Dhe kur flet budallallëqe thua, o Hamdi — iu kanos hetusei duke parë orën. — As shtatë minuta s'i janë bërë.

— S'ka rëndësi koha, — përshpëriti mjeku.

— Mos ka gjetur rehat qeni dhe rri shtrirë, ë? — pyeti hetuesi.

Mjeku vuri buzën në gaz kur dëgjoi «Mos ka gjetur rehat qeni».

— Të shohim, — tha mjeku, — unë e kam të fiksuar në sy shprehjen e fytyrës së tij të tmerruar kur i mbyllëm kapakun, zëre se e kam fotografuar. Ta hapim ngadalë, pa zhurmë, mirë?

— Si urdhëron, — u përgjigj Hamdiu.

— Ule, ule zërin. Qetësi. Aman mbani qetësi, — u lut mjeku.

Kapaku filloj të lëvizte duke rrëshqitur lehtë. Dhe drita e dhomës filloj të hynte në arkivol derisa e largoi errësirën dhe ra mbi fytyrën e Grigorit, i cili nuk reagoi fare.

— Ka vdekur, — tha Hamdiu.

— Jo, jo kundërshtoi mjeku, — ose po fle, ose ka rënë në kllapi. Nuk ia ndjeni frysëmarrjen sa të lehtë e ka? Ja dhë pulsi!

— O doktor, — ngriti zërin hetuesi, — ai po tall koqet me ne. Ai po çlodhet, po fle për shtatë palë qejfe. E njoh unë gjumin e torturës. S'ka më i ëmbël se ai. Kam pasur raste që kanë qenë dakort të vdesin veç t'i lija të flinin. S'di si ta shpje goj. Është një lloj gjumi i veçantë. Më kanë thënë jo një a dy, por dhjetë a dymbëdhjetë që ishin gati të falnin në çast 5 vjet, dhjetë vjet jetë për dhjetë minuta gjumë. Kam pasur një herë një fshatar nga Tushemishti i Pogradecit që e zumë në kufi. E di si më tha kur e takova në burgun e Burrelit. T'i kam bërë hallall të gjitha, o Ridvan Geseri, veç gjumit, dhe të gjitha torturat t'i durova veç gjumit. Me atë ma qive nënën. Për ideal të partisë kështu më ka thënë.

— E pranoj, — pohoi mjeku, — veç këtu kemi të bëjmë me një rast të veçantë gjumi, që bëhet brenda në arkivol, pra mund ta quajmë gjumi i vdekjes. Shëët, më duket se po zgjohet. Nuk i ngre dot kapakët e syve. E shikon se si i lëviz muskuli?

Hetuesit iu mbush mendja se mjeku ishte një kaqol i madh që ditën e ngryste në burg e natën e gdhinte, mbi libra.

— Hë, zoti Grigor, hape syrin! Ke shtatë minuta që fle. E di ç'do të thotë shtatë minuta gjumë? Hape syrin se ta qërrova dhe këtë e pastaj fli sa të duash se natë do ta kesh tërë jetën.

Qepallat e të dy syve lëvizën. U ngritën me zor. Syri i

mirë pa ashtu turbull një kapak arkivoli sipër kokës. Síkur të mos i kishte besuar asaj që pa, syri u rrrotulla. Dalloj dy hije njerëzish mbi kokë: një hije e bardhë e një e zezë, pastaj pa sérish kapakun e arkivolit, i cili filloi të lëvizte vetë.

— C'bën? — pyeti hetuesi mjekun.

— Po e lëviz që të bindet se është në arkivol.

— Sikur s'e di ai se ku është! — qesëndisi hetuesi.

— E di dhe s'e di. Siç nuk dimë ne se ç'ka ndodhur në trurin e tij, këto shtatë minuta. Të kujtohet kur ia mbyllëm kapakun? Ai nisi të lëvizë buzët.

— Hë, pra, — s'duroi hetuesi, — bëje që të lëvizë prapë, të flasë. Atë dua unë, jo broçkulla.

— E di në ç'gjendje është ky tanë, ë? Është në gjendje haluçinative.

— Unë di gjendjen time që s'jam as në qelli as në tokë, që s'kam mundur t'i nxjerr një të dhënë të saktë.

— As ke për ta marrë në këtë gjendje që është. Prit. Pas fazës deprimante ne duhet të arrijmë deri atje sa njeriu të depersonalizohet. Duhet t'ia thyejmë unin, t'ia shuajmë atë që mban gjallë shpirtin rudimental, hakmarrjen. Me heshtjen e tij ky bënj luftë me ne. Lufta është rezistencë, është ekzistencë, është krenari.

— S'dua teori doktor! Sipas teje duhet ta lemë të flejë, të çlodhet që kur të zgjohet të tallet me ne duke luajtur budallanë? — ngriti zërin Ridvan Geseri, dhe e kapi përfyti Grigorin, e ngriti dy-tre pëllëmbë dhe e përplasi sérish në arkivol.

Grigori i hapi të dy sytë. Në të keqin s'kishte dritë, në të mirin s'kishte asgjë.

— Do të përgjigjesh, doktor! — thirri hetuesi.

— Përgjigjem unë, — tha mjeku ngadalë dhe i qetë dhe me gishtërinjtë e tij të hollë e të gjatë ai gjeti arterien rurale dhe nisi të numëronte të rrahurat e zemrës; — pulsin e ka më të plotë e më ritmik.

— S'dua pulsin, doktor, dua fjalët e tij!

— Do t'i keni. Prit. T'i bëj një kafeinë?

— Po, po, kafe, çaj, qumësht, gjalp, mjaltë dhe arra, — s'duroi e tha hetuesi.

— Pak ajë do t'i bënte më efekt, — iu përgjigj po me ironi mjeku.

— Një kovë, — t'u tall hapur hëtuési.

— Një kovë në surrat e një gotë në stomak, — tha mjëku dhe i qetë, pa iu dridhur dora, nisi të përgatiste injeksonin.

Grigori e dëgjoi bisedën po nuk qe në gjendje t'i dallonte fjalët njëra nga tjetra. Atij, ato zëra, se si i vinin, herë larg, herë afër dhe jo sikur flisnin dy veta por më shumë. U mundua t'i hapte sytë po nuk mundi. Një zë i ëmbël, i largët, sikur e përmendi. Një ofshamë sikur rënkoit tërë fshati, e tronditi. Grigori mbajti vesh, dëgjoi fare qartë tingujt e këmbanës së kishës, dy goditje që binin me plogështi e dhimbje njëra pas tjetrës e përsëriteshin po njëloj, monotone duke mbushur ajrin me trishtim.

«Kush do të ketë vdekur tjetër?» — tha Grigori dhe thirri qentë, pastaj dhentë.

Nata ishte larg fshatit. Donte dhe një orë që të vinte muzgu. Grigori u nis. Vuri tufën përpara dhe duke zbritur i ngucet dhe nuk i linte dhenjtë të kullosnin barin anës rrugës.

Në të hyrë të fshatit, ku apo kishte nisur të binte muzgu, Grigori dëgjoi një këmbanë të dylë morti. Në jetën e tij të re s'kishte dëgjuar kurrë dy vdekje njëherësh. Sa hyri në rrugicën e parë, që priste për shkurt, pa priftin, papa Mihailin të dalë nga shtëpia e xha Lazes dhe të ecë me ngut pa hequr petrahilin. Flokët e thinjur e të gjatë ia valëviste éra që u ngrit nga deti dhe ra në fshat. Pas priftit plak vinte dhjaku dhe ai po aq plak sa prifti me temjanicën duke temjanisur rrugën. Grigorit i ra në fytyrë era e temjanit. Ai ù mat të fliste. Lëvizi buzët po zë nuk nxorri. Një ditë më parë ai kishte varrosur të atin. I la dhentë dhe ndoqi nga pas priftin e dhjakun. Të dy pleq, që ndonëse ngutshëm, çapiçeshin pranë njëri-tjetrit me flokë të gjatë e të thinjur që ua rrëmbente éra. Njëri me ungjill në dorë e tjetri me temjanicën që lëshonte nga pas erën e temjanit dhe ato tingujt aq të lehtë të zilkave. Grigorit iu duk sikur këta pleq kockë e lëkure kishin vendosur t'i dilnin përpara vdekjes e ta ndalonin që të mos hynte thellë në fshat.

Grigori i arriti dy pleqtë dhe dëgjoi mërmëritjen e tyre nëpër dhëmbë: Shenjt perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshiromë.

— Kthehu në shtëpi, — i tha dhjaku dhe i tundi temjanen, sikur do ta bekonte.

Tymi i temjanit iu ngjit nga gjoksi në fytyrë. Reja ë hollë, e butë dhe e tejdukshme e rrëshirës, gjysmë e bardhë dhe gjysmë e kaltër, ia turbulloj vështrimin. Megjithëse dhjaku iku pas priftit duke temianosur rrugicën, Grigorit i vinin në vesh fjalët e tij; «Kthehu në shtëpi, kthehu në shtëpi.»

Grigori iu bind atij urdhri si i verbër, pa ndjeu sikur u ngrit pakëz nga toka dhe ashtu lëvizi bashkë me tufën e dheneve dhe u gjend në oborrin e shtëpisë së tij. Në oborr i puqën këmbët dhe. Dera e shtëpisë ishte e hapur dykanatësh. Dhe dera e dhomës së madhe ishte e hapur dhe për çudi në mes të saj, tamam aty ku dje kishte ndenjur arkivoli me trupin e të atit ishte përsëri një arkivol por bosh. Pranë oxhakut ishte e éma, dy vëllezërit dhe gjeli pikali i shtëpisë që çukiste nëpër dhomë, sikur aty të mos kishte mjeri të gjallë. E éma dhe dy vëllezërit nuk e ndjenë kur hyri brenda, as kur u ul këmbëkryq pranë tyre. Veç kur foli, ata ngritet sytë dhe e panë.

- Erdhe bir! — tha Marga plakë.
- Erdha nënë, po s'po marr vesh fare se ç'po bëhet në fshat e ky arkivol q'do këtu?
- Sapo e sollën.
- Kush e solli, pse e sollën?
- Ata të fshatit.
- Si të fshatit?
- Ata të parisë, Sofua me skuadrën e vullnetarëve.
- Po përsë? Ç'punë kemi ne me arkivolin? Ne dje varrosëm tatën.
- Është për njërin nga ju të tre, — tha fare e qetë Marga. — Po shpérndahen arkivolë në të gjitha shtëpitë e fshatit, për ata që dhanë fjalën në kishë.
- Ah, — u habit Grigori, — për Stalinin! Po ata duhet të sillnin tre copë, se ne që të tre dhamë jetë.
- Hë për hë nga një për shtëpi. Nuk bëhen kollaj gjithë ato arkivolë që duhen, — tha vëllai i madh, Dhosi.
- Atëherë njëri nga ne duhet të bëhet gati? — pyeti i hutuar Grigori.
- Ashtu tha dhe Sofua. Na e la në në dorë që të vendosim, se cili do të vdesë i pari, — shtoi Dhosi.
- Shumë mirë, — tha quditërisht i qetë Grigori, — i pari po shkoj unë pranë tatës.

— Unë them me radhë, sipas moshës, — ngriti zërin vëllai i madh.

— Ç'je budalla, — kërceu Grigori, — ti ke gruan, ke dy fëmijë.

— Atë them dhe unë, — shtoi Josifi i vogël.

— Rri ore urtë ti. Spurdhiak, — ngriti zërin Grigori. — Ti është akoma i vogël, dhëntë zoti e ia arrin të rrash e të shikosh. Mbështetja vjen ajo ditë që njeriu të ketë qejf të rrojë.

Marga qeshi nën buzë. Buzët formuan atë vijë të hollë si gjajtan te goja pa dhëmbë. Grigori sikur po i shikonte si për të parën herë buzët e nënës, atë vijë të zezë që mbyllnin atë gojë pa dhëmbë pastaj ia pa sytë. Dy puse pa ujë, ndonëse fytyra e balli ishin gjithë viza, rrudha, vragna të djegura nga djersa e dielli dhe tharë si eshkë nga era e kripur e dëtit. Po ta shikoje kalimthi e të mos e kishe mendjen aty do ta merrie më kollai për nië copë eshkë të hedhur, se sa për fytyrë njeriu, ku s'kishte mbetur asnjë tipar femëror.

— Pse më shikon ashtu, — foli Marga.

— Po ti pse qeshe? — iu përgjigj Grigori.

— Me fjalët e tua! Kur do ardhka ajo ditë që njeriu të ketë neif të jetojë?!

Grigori u pre në fytyrë. Marga, që siç duket e mori përgjigjen nga fytyra e hutuar dhe e trembur e të birit, vazhdoi: — kam 75 vjet që pres si budallenjtë ato ditë që thua ti, o bir! Dhe juve, dy motrat, e dy vëllezërit tuaj të parë që vdiqën njëri pas tjetrit i bëra me shpresën e asaj dite. Dhe ia c'arrita: qivurin në mes të dhomës. Hajt, tanë, ndaleti mendjen e le të hyjë niëri e t'i bëjmë adetet. Unë jam nënë, s'mund të ve unë gisht se cili.

— Ju thashë, pra. Do të hyj unë, — nguli këmbë Grigori, por ama dicka ndieni sano svri i diathtë pa si shkarazi kapakun e arkivolit mbështetur pas murit, afër dritares, pranë saksisë ku kishte çelur borzilokut. Përtej qelqit të dritares ai dalloj nië bletëzë që mundohej të depërtonte nëvër xhamin e tejdukshëm dhe nuk kuptonte dot se si e pse s'po i afrohej borzilokut, të cilat përfundon me aromën.

— Dhe mos pandehni se kam frikë, — shtoi Grigori dhe iu afrova kapakut të arkivolit, që iu duk tepër i njohur dhe dërrasat e freskëta që mbanin erën e pishës, edhe ato dy vendet bosh të qëndron si sy edhe bezja e zezë e kapur me thumbar të vegjël dhe ato dy gozhët pësështë të mbërthyera anash.

aq sa majat sapo kishin dalë nga dërrasa e kapakut dhe ishin gati të hynin në dërrasën anësore të arkivolit për ta puthitur paq e përjetësishët deri sa të kalbeshin e të treteshin bashkarisht, beze, dërrasë, njeri dhe gozhdë.

Grigori e ngriti kapakun dhe e vuri skic pranë arkivolit. Për çudi dora nuk i dridhej. Ngriti këmbën që të hynte në arkivol po mbeti.

—Nënë, ku janë këpucët e mira? Me opinga do shkoj në atë dynja?

— Këpucët e mira ia veshëm tyt eti, — tha Marga dhe shikonte e habitur të birin që u rehatua në arkivol, që zgjati krahun dhe nisi të tërhoqte kapakun.

Të gjitha veprimet e tij ishin aq të lehta, të sigurta, sikur ai ta kishte bërë rrugë vreshti hyrjen e daljen nga arkivoli. Grigorit i erdhi keq kur pa sytë e çakërrisur të vëlle-zërve dhe ashtu, shtrirë siç qe, e pa të udhës t'i qetësonë.

— Mos u çudisni. Jam mësuar. Si e qysh s'ju thëm dot. Unë s'duhet të flas. Po fola ju mori lumi të gjithëve.

— Prit, o vëlla, prit. Nëna s'ka vendosur akoma se cili do të shkojë i pari. Na e la vërtet neve ta vendosim, por ne s'kemi folur akoma, apo jo, o byrazer i madh!

Vëllai i madh dëgjoi njëherësh dhe zërin e Josifit dhe zërin e gruas që ndillte pulat në oborr. Zëri i gruas i erdhi i dashur, i ëmbël, joshiës, si një zë jete që të ngjall në shpirt mall, gëzim, dashuri, që të ngre peshë, që të jep kurajo e të detyron të durosh çdo stërmundim njerëzor. Sytë e tij panë nga nëna. Ajo e uli vështrimin dhe e fshehu në oxhak.

Përjashta, tej oborrit, në rrugicën e fshatit, u dëgjua gërvima çjerrëse e rrotave të karrocës që po mblidhëtë të vdekurit e gjallë. Dhe mbi këtë gërvimë si vajtim monoton të gjithë çishin në shtëpi dëgjuan zërin e Sofo kryetarit që urdhëronte skuadrën e vullnetarëve.

Josifit iu drodh gërmazi. Ai u mat ta pyeste edhe një herë vëllanë e madh se si do ta ndanin punën, po zëri nuk i doli. Dhe kur e ndjeu se mund të fliste nuk foli. Një ngjyrë e kuqe turpi ia ndezi veshët, faqet dhe ballin. Këmbët nuk lëvizën dhe duart nuk u zgjatën që të ngrinin nga arkivoli vëllanë e mësëm. Nëna vazhdonte t'i mbante sytë në hirin e vatrës. Grigorit se si i erdhi dhe e mbyti një trishtim i zi dhe një mërzitje që nuk e pat provuar kurërë në jetën e tij. Vetja iu duk sikur ishte një njeri i braktisur nga të gjithë

dhe nga dy vëllezërit dhe nga nëna që vazhdonte të shikonte në vatër.

Para derës së oborrit të tyre pushoi e qara e qerres. Nga dera e hapur e dhomës, nga dritarja e mbyllur dhe nga oxhaku i madh i shtëpisë u dëgjua i fuqishëm zëri i kryetarit.

— E. more fisi i Kurtezëve, s'e keni vendosur akoma? Në kishë dolët me flamur të parët, kurse tanë s'keni dalë akoma me arkivolin te dera e shtëpisë?!

— Mbërtheni arkivolin, — bërtiti Grigori. — S'dua që ai ai qen të tallet me ne. Ja, ku e keni çekicin, në kamaren, në krâh të oxhakut, aty keni dhe sqeparin. Luani duart!

Grigori u qetësua kur dëgjoi se si gjëmoi çekici dhe sqeparin mbi dy gozhët që i binin përkatësish afër dy supeve. Pastaj dëgjoi kur dy vëllezërit godisnin njëherësh dhe dy gozhë poshtë që binin përkatësish pak më poshtë se dy gjunjët.

— Nxirrmëni në oborr, nxirrmëni de, c'prisni! — bërtiti Grigori...

... Hetuesi dhe mjeku u panë sy më sy apo dëgjuan zërin e Grigorit që foli nga arkivoli.

— C'tha, ë? — pyeti hetuesi i hutuar.

— Sikur tha që ta nxjerrim në oborr! — pëshpëriti mjeku.

Grigori, që iu duk se nuk e dëgjoi as nëna, as vëllezërit, u mundua e përsëriti duke ngritur dhe më shumë zërin;

— Nxirrmëni, nxirrmëni në oborr! S'dua që ai qen të tallet me fisin tonë.

— Si është puna, Grigor? — i pëshpëriti mjeku, — ma thuaj mua. Të ndihmoj unë. Fol!

— Nxirrmëni në oborr, nxirrmëni në oborr!

Mjeku mblodhi supet. Të kishte nevoj për pak ajër të pastër? Po fjala tjetër: «S'dua që ai qen të tallet me fisin tonë?»

— E mira është që ta nxjerrim, — tha mjeku.

— Në oborr? Të na shohin gjithë dynjaja?

— E nxjerrim në verandë, — tha Hamdiu, — veranda si oborr është.

— Hape derën, — urdhëroi hetuesi.

Po dera mezi u hap. Ishte një katana dykatëshe, që me sa dukej nuk qe hapur kurrë. Të tre burrat e hoqën zvarrë arkivolin, i cili u lëkund kur kapërceu pragun e derës. Veranda ishte aq e madhe saqë aty u zbulua gjysma e qiellit dhe gjysma e yjeve që i rrin në rreth e qark një hënë sa një thelë pjepri. Diku larg e thellë këndonin bretkocat. Dhe më tej, diku fshehur qante një bilbil. Derisa në fytyrën e Grigorit ra drita e hënës dhe e yjeve do të thotë se ato e panë, kurse Grigori hiç. Fytyra e tij ishte po ajo, veç qepallat sikur u qetësan, sikur drita e yjeve dhe hënës të ishin ballsam. Ato që e ndien më shumë natën, qenë flegrat e hundës.

- Hë? — pyeti me padurim hetuesi mjekun.
- Është akoma në kllapi, — u përgjigj mjeku.
- Po buzët pse i lëviz?

— Flet. Me siguri që flet. Artikulimi i gojës është i ngadalshëm, i plotë. Pak zë dhe ne do të marrim vesh gjithçka.

- S'na ka ndodhur kurrë kështu, — u çudit hetuesi.
- Truri është enigmë, — tha mjeku dhe gjuha i ngriu në gojë.

Grigori hapi sytë. Syri i tij i mirë që i qetë, i pastër, por tepër i habitur.

- Ku jam kështu? — foli Grigori.
- Si ku je? — ndërhyri me të shpejtë mjeku. — Në fshat je. Nuk i shikon yjet, hënën? Nuk e dëgjon bilbilin? Grigori mbylli sytë.

— Grigor, o Grigor? — i pëshpëriti në vesh mjeku. Grigori hapi sytë dhe pa natën, yjet, hënën, që atij iu duk se po binte në det. Fytyra se si i mori një qetësi dhe prejhe. I gjithë trupi i kontraktuar në arkivol sikur u çlirua. Ai mbylli sytë i qetë si i lodhur nga dita e gjatë dhe e mundimshme dhe iu bë se ishte shtrirë në dyshekun e tij prej lëpush-kash misri, aty pranë dritäres së hapur. Edhe pse me sy të mbyllur ai pa nënën, ndjeu dorën e saj në sup dhe dëgjoi: — Ngrehu, bir, ngrehu se vdiq krushku. E di që je i lodhur, por s'bën të mos vesh.

- Ç'është kjo gjëmë, moj nënë, po vdesin një nga një burrat e fshatit? — u habit Grigori.

— Vetë i falët jetën, sikur ju zu kolera.

Grigori u vesh dhe doli. Shtëpia deri te krushku ishte larg, në të dalë të fshatit. Eçte nëpër natë dhe i vinte si çu-

di kur dëgjonte qokun, bufin dhe gjithë zërat që ka nata, me ison e largët të përroit e fëshfërimën e gjetheve. Një lakuriq nate i kaloi afër kokës. Ai ndjeu në faqen akoma të ngrohtë nga jastékët se si lëvizi ajri. Kur hyri në dhomën e burrave, në shtëpinë e krushkut nuk u habit që e gjeti plot me burra e djem të fshatit. Dhosi, vëllai i madh, e pa me inat. Nuk i takonte Grigorit që të vinte aq vonë. Pëershëndeti me një lëvizje të plogët të kokës burrat e fshatit dhe zu vendin që i takonte, te dera dhe mbajti vesh bisedën e cila nuk u ndërpresa nga ardhja e tij.

— Po si kështu, kaq shpejt i shkoi xha Minai pas krushkut. ë? Pak si e çuditshme, — pyeti Sofua, i cili deri sa bëri atë pyetje duhej të kishte ardhur pak përparrë Grigorit.

— Shumë shpejt, as dyzet e dy orë. — tha Raçi, i biri i xha Minait. Llogaritari i kooperativës i cili fliste sikur po raportonte sukseset e tremujorit. — Sa u kthyem nga varrezat, kur varrosëm Macon e Lekën më tha se i dhimbte koka e i gjëmonin veshët. U ul ja aty, hapi radion dhe kërkoi një gotë raki.

— Mit Kurtezi u tregua burrë. Dhe Maqua me Lekën. E dhanë fialën dhe e mbaitën. Nëso Stalini do të shnëtøjë. Sjithë bota duhet t'ia dijë përnder xha Mitim se ai dha shembullin i pari. Pastaj Maqos dhe Lekës. Le të thonë se nuk është t'ë zot t'i bënin ballë ariut, po ama të mos harrojmë se ata thanë në kishë se ishin gati të jepnin nga dhjetë vjet Stalinit. Pse nuk i është afruar më parë ariu fshatit tonë. ë? Ja, unë 75 vjeç jam e s'mbai mend ndonië ari të ketë bërë zullum t'ë tillë nënierëz. Në misër po, se e shtvn uria, në stan po, se e ndiell era e qumështit po në mes të ditës e në të hyrë të fshatit?! Cdo gjë u shkrua atë ditë në kishë, o bir! Mos u cudit nëso do të vdes dhe unë. — kaq më tha e rrëkëlleu gotën e rakisë me një frymë, sikur të ishte gota e fundit që po pinte në jetën e tij.

— E pastaj? — pyeti Sofoja, të cilil nuk i pëlqeu që Raçi përmendi dy herë kishën.

— Hiç, vdiq sa piu rakinë. Iu muar goja. Se c'tha dicka që nuk ia mora vesh dhe vec kur u rrëzua nga karrigia. Thirra nënën. Ajo ia dha kujës. I fola se s'bën të qajë, se kjo nuk është vdekje si cdo vdekje. Se kjo është rruga e fshatit tonë, se jeta jonë nuk na përket më neye, por Stalinit të madh. Atë-

herë duhet të 'bëj gati varrin tënd, më tha nëna, se dhe ti fole në kishë. Pö, i thashë. Bëje gati, nënë.

Grigori kishte mbërthyer me sv Raqin dhe Sofo Bregun. Kur i lodheshin sytë shikonte xha Minain të shtuar në mes të dhomës, të rruar, të veshur me rrobat më të mira. Rreth e qark trupit të tij pà jetë lëshonin erë të mirë tufat e borzilokut, disa bisqe të celura thane e aty këtu si yje zverdhnin e zbardhnin disa lulëdele që dikush do t'i kishte këputur anës gartiveve të konshtit të shtëpisë. Këpucët e vietra të xha Minait ishin mbuluar me disa degëza të luleve të kumbullave budallave që ishin gëniver nga dielli i marsit.

Nata e përgjimit të xha Minait e kishte kaluar pikën e rrezikshme e të turnshme nér të zotët e shtëpisë, përfisin, e krushoinë. Qe mposhtur gjumi në të mbyll svtë e rniën. Ishte nxjerrë dy herë tabakaja me filxhanët e kafesë. Një filxhan qëndroi para Grigorit e një branë Sofos. Sofua e pinte kafenë me zhurmë. E thithje fort lëngun aq sa dëgiohei sic dëgiohei dhe muhabeti. Secili tregonte dicka më të rendë se gjëma që kishte nifikosur shtëninë e tò ndierit, si nér t'i thënë fisit se kjo vdekje është hiç para të këqijave e vdekjeve më të hidhura.

— E keaja s'ka fund. Lum ai që e zë nië e keqe e vogël në kanërdihet. — tha Sofua kur mbaroi së piri gjithë zhurmë kafenë.

— Nië filozof i huai ka thënë se lumturia është kur njeriu shnëton nsa fatkeqësia. — tha magazinieri i fshatit.

— Atëhëre, sipas tii, ne duhet të jemi fshati më i lumtur në botë se, që kur kam ardhur këtu te iu, veç fatkeqësira kapërceimë. — iu përgjigji magazinierit mësuesi.

— Më vjen keq, mësues, në flet kështu. — ndërvri Sofua. — ieta është e vështirë, luftë. Pse është e tillë, pa është e bukur.

— Po është e shkurtër, o krvetar. Ja që nsa kjo shtëpi në varreza. Pse të shkojmë nga kjo jetë në atë jetë buzënlasar?

— Sepse jemi mëkatarë, — ngriti zërin papa Mihali dhe me gisht tregoi dritën aë po agonte.

Grigori ndoqi gishtin e priftit dhe u habit që në dritare qenë tretur viet. Ai pothuaj nuk po dëgjonte më nsa bisedat aë no bëheshin. Sikur u mërzit që no agonte. Svtë i rrëshqiti nga dritarja te xha Minai, te këpucët që ishin mbuluar

aq bukur me lule kumbulle midis së cilave ai në lëkurën e çarë, pa një vrimë të vogël në mes të shollës. Këpucët e xha Minait, me aq sa mbante mend Grigori, ishin këpucët më të mira në tërë fshatin. Sa djem të fshatit ishin bérë dhëndurë, kishin shkuar në qytezë, në zyrën e gjendjes civile, në kishë e pastaj në dasmë me këpucët e xha Minait? Shyqyr që varfëria nuk është turp. Dhe Grigori e pat ndarë mendjen që kur të martohej të merrete hua këpucët e xha Minait, kur se tani që i shikonte të mbuluara me lulet e kumbullave, ndjeu se jo vetëm ai, por i tërë fshati, s'kishte për të pasur më dasma. Ato këpucë do t'i hante dheu. Do t'i kalbte lagështira e do treteshin bashkë me këmbët e xha Minait. Grigori sikur u zgjua për një çast nga gjumi letargjik i vdekjes, sikur u përmend dhe iu kujtua një gjë e hidhur, një grackë e poshtër, një hile e keqe.

«Dale, dale, — tha ai me vete pa e pasur të qartë nëse ishte në hetuesi apo në fshat. Vërtet dhanë nga pesë apo pesëmbëdhjetë vjet për Stalinin, por ama logjika e do që bëhet fjalë për pesë apo pesëmbëdhjetët e fundit të jetës. Pra në se do jetoja 60 vjet, do të rroj 55? Po jo të vdes sot si Maqua me Lekën?»

Një ngërç ia shtrëngoi si darë gjithë gjoksin. Një dhimbje shpirti e poshtër, një fyerje, përbuzje, një mospërfillje e tmerrshme që të bind se je hiç, mut që hanë pulat e qentë e fshatit, që të ngjitet pas këpucës dhe ti, gjithë neveri, e fshin. e fshin këmbën pas barit të udhës sa sholli i opingës bëhet jeshil.

— Po ti ç'je zgërlaqur e rri si bajgë. — i pëshpëriti në vesh vëllai i madh. Dhosi, — thuaj një fjalë, s'ka lezet. Je i shtëpisë, s'je i huaj!

Grigori i turpëruar filloi të dëgjojë bisedën e burrave që ndonëse u għdi vazħdonin tē përgjonin xha Minain.

— A e dini se fshati ynë u nderua në këtë fushatë më shumë se gjithë fshatrat e rrethit tonë? E dini, o njeréz se ne të gjithë, domethënë 78 shtëpi me 156 meshkuj pa llogaritur pionierët, i falém Stalinit të madh 1092 vjet?! — tha Sofio Bregu sytë e të cilit shkëlqenin e qeshnin.

Grigori pa nё sytë e Sofos reflektimin e dritës elektrike, atë xixë tē telit inkandeshent. Dhe sytë e tij sesi u ndezën. si të hipnotizuar nga sytë e kryetarit. Dhe sytë e gjithë atyre që qenë mblidhur aty, njerëzvë tē shtëpisë, krushqisë, fare-

fisit e miqve u ndezën si të ishin qirinj, e dhoma kishë e arkivoli me xha Minanë altar, që shikohej nga të gjithë me një dhimbje adhurimi, me një mëshirë shpresëdhënëse, një hutim e turbullimë që çuditërisht ndriçohej nga larg, shumë larg, nga një yll i kuq që lëshonte rreze e xixa dhe i bënte njerëzit e asaj dhome, fshati të ndienin një lloj krenarie për atë sakrificë sublime e për çudi ta ndienin veten krenarë që ngajeta e tyre të jetonte dikush tjetër, jo perëndi, por njeri, njeri si ata, me dy këmbë e duar, me gojë që ha e pi. Ky njeri-perëndi nisi ta mundonte Grigorin, i cili ishte gati të falte edhe pesë vjet jetë nga c'i kishte mbetur vec ta shikonte tamam sido që të ishte: njeri, perëndi, kafshë, send i fortë apo ajër. Nuk e duronte dot kur i shfaqej në forma nga më të ndryshmet e të çuditshmet dhe që me një dorë të padukshme ia zinte frymën duke ia zhytur kokën në pellg me ujë të qelbur përzier me gjak.

— Hiqe dorën. Hiqe se më zure frymën, — foli Grigori dhe u çudit pse njerëzit, Sofua, i vëllai Dhosi, Sotiri, sekretari i rinisë së fshatit të cilët i kishte aq pranë, aty te këmbët e xha Minait, nuk e dëgjonin zërin e tij.

— Hiqe dorën, qen! — ngriti zërin Grigori dhe bëri një përpjekje për t'i shpëtuar asaj dore perëndie në formë dare.

— E mbyte. — foli mjeku. — lëshoje Ridvan!

— Po pse, për t'ja këputur me gjumë e nxorëm në vendë?

Hetuesi liroi gishterinjtë e dorës. Grigori lëvizi qafën aty brenda në arkivol dhe nuk i besoi fytit të tij që ishte cliruar. Megjithëse sytë i kishte të mbyllur ai pa njerinë-perëndi. Nuk ishte gjigand, as i shëmtuar. Ishte i bukur, i ri, i veshur me kostum, me këmishë të bardhë, me kravatë të kuqe me kokë të vogël.

Grigori puliti qepallat. Donte të bindej se njeri-perëndia ishte ai, hetuesi i tij, që atë çast duhej të kishte marrë formën e përbajtjen e Ridvan Geserit dhe fuqinë e fuqimadhit atje lart, por jo deri në qill, por aty barabar me retë dhe hyntë e dilte midis tyre io me krahë engjëlli, po ashtu si gjithë njerëzit, kur i zë mjegulla në pyll.

Grigori hapi sytë. Syri i mirë qe skuqur pak. Sigurisht nga shtrëngimi që i bëri hetuesi, megjithatë ai pa fare qartë dhëmbët e shtrënguara të Ridvan Geserit, ato dhëmbë të bardha por pak katroshë. Dy dhëmbët e qenit ishin pak më tepër

të gjatë nga ç'janë zakonisht. I majti vinte pak si i dalë nga jashtë. Kurse i djathti vinte drejt. Nga gjithë fytyra e Ridvan Geserit, Grigorit i qe ngulitur në tru si gozhdë goja me ato dhëmbë.

Hetuesi dhe Grigori u panë sy më sy. Mjeku u habit. Vështrimi i syrit të mirë të Grigorit qe jashtë çdo mase i habitur dhe gati dilte jashtë zgavrës, kurse i keqi ishte indiferent, i ftohtë dhe i qetë. Mjeku e përbajti veten. Ata dy sy me ato dy pamje aq të ndryshme, ishte e pamundur t'i shikoje. A mund të ketë në këtë botë një njeri me dy sy, një të gjallë, të habitur deri në lemeri dhe tjetri i qetë, i ftohtë dhe indiferent?

— Ç'dreqin ka që habitet? — tha Ridvan Geseri, — si i fyter, — s'më ka parë kurrë kështu asnje i pandehur! Mos është gmendur?

— Do të ishte një mrekulli nëse do të ishim në gjendje të mësonim se ç'po ndodh në trurin e tij, — tha mjeku.

— Më mërzite me këto mrekullitë e tua. Në mëngjes ministri pret t'i telefonojmë. Ç'do t'i themi, ë? — pyeti Ridvan Geseri me atë dinakërinë e tij të njohur nga gjithë punonjësit e sektorit që të bënte përnjëherësh bashkëpunëtor kur ishte afër dështimit dhe të injoronte në çast kur ishte pranë sukse sit.

Mjeku, i cili kishte akoma interes për çka po ndodhë me të pandehurin, bëri sikur nuk e dëgjoi, u përkul mbi arkivol dhe pa fytyrën me sy të myllur të Grigorit, i cili në atë pamje të qetë të bindte se po flinte.

— Ç'do të bëjmë, shoku Ridvan, po gdhin, ta fus brenda? — tha i druajtur Hamdiu.

— Fute mutin dhe bëj gati elektroshokun. Të përdorim edhe metodat e reja, apo jo doktor? — ironizoi Ridvan Geseri.

Mjeku nuk u përgjigj. Donte të lante duart si Pilati po interes i që i kishte ngjallur ky Grigor e shtyu për më vonë shkëputjen nga Ridvan Geseri.

— Mbësë disa goditje me tensione të dobta mund ta zgjognin Grigorin, — pohoi mjeku.

Hamdiu e kapi arkivolin dhe e tërhoqi sikur tërhiqte një deng. Arkivoli filloi të troshitej. Te pragu i verandës u tund. Dhe koka e Grigorit u lëkund si të ishte një kungull.

Grigori ndjeu se po ikte nga drita e mëngjesit dhe po hynte në një lloj drite tjetër si gjysmë dritë e gjysmë errë-

sirë të dhomës së torturave. Ajo lloj ecjeje si rrëshqitje, si zvarritje iu duk tepër e gjatë dhe, ndonëse ia ngjalli gjithë dhimbjet e tjera të trupit të dërmuar, të kockave të thyera, nuk kuptoi dot se ku ndodhej. Ai që duroi torturat si një njeri i egër, nuk duroi dot atë lloj përkundje. Vuante që nuk dinte se kush ishte, se ç'lloj fisi njerëzor i takonte, se cili fshat ishte i tiji, si quhej e në c'pjesë të Shqipërisë binte. I dhimbte shpirti që s'kish nënë, babë, motër apo vëlla dhe nuk kuptonte pse i kishte humbur. Ndiente se ato diku i ishin fshehur, kishin marrë arratinë e kishin frikë të takoheshin me të.

— Ky po qan, — tha Hamdiu, i cili bëri gati telat e korentit për t'i bërë elektroshokun.

— Po qan? — u habit mjeku dhe pa lotët që rrëshqisnin faqeve duke lagur koret e plagëve të përgjakura.

— Ky po na çmend, — pëshpëriti Ridvan Geseri dhe pa u bërë merak të shikonte lotët, siç po i shikonte mjeku dhe Hamdiu, i bërtiti rrëzë veshit.

— Do thuash, o mut muti të paktën si quhet fshati apo të ta marr shpirtin me këto duar, ë? Di unë pastaj se si ia zbuloj petët lakrorit tënd.

Grigori vazhdonte të qante.

Hamdiu, mjeku dhe hetuesi u panë sy më sy. S'kishin parë kurrë një njeri që të qante dhe njëkohësisht të ishte aq i përhumbur.

...Grigori nuk po bindej nëse fshati që i mbiu parasysh ishte fshati i tij apo një fshat i huaj në dhe të huaj, krejt bosh, thuajse i vdekur, pa këmbë njeriu, pa dhen e dhi, pa gomérë e kuaj, pa lopë e qe, pa bahçe e gardhe e pa tym. Këmbët, që lëviznin vetë, u futën mes shtëpive të para të rrugicës së parë. Dyert ishin të gjitha hapur po, as në oborre, as në bahçe e hajate s'kishë këmbë njeriu. Në oborr vinin vërdallë pulat. Deri sa ato guxonin të hynin e të dilnin lirisht bahçeve, hajateve e dyerive të hapura të dhomave përdhese do të thoshte se vërtet s'kishë më njerëz ai fshat rrëzë malit e buzë përrroit e sipër detit që rënkonte atje poshtë, e me dallgët e tij të përjetshme godiste themelet e malit.

Kambana e kishës ra për mort. Grigori u gjëzua që dëgjoi zérin e kambanës. «Atje do jenë» — tha me vete e pa vra-

rë mendjen se kush ka vdekur u sul. Dera e kishës ishtë e hëpur dykanatash. Në hajat ichin mbledhur gjithë qentë e fshatit. Një djalë i vogël, gjashi të apo shtatë vjeç, i veshur si gjithë fëmijët e fshatit, me rröba të leshta e opinga, mbante një shkop të gjatë në dorë dhe trembte qentë. Grigori ra në gjunjë para fëmijës flokëverdhë. Qurrat e thata kishin zënë kore mbi buzë. Sytë e mëdhenj si dy ullinj shkëlqenin nga kënaqësia. Ishtë i dobët, kockë e lëkurë, me faqe të zbehta e të hequra, po krahët e këmbët i kishte topolake. Nga malli që pa një njeri, Grigori zgjati buzët ta puthte në ballë, por fëmija u spraps dhe e kërcënoi me shkop.

- Nuk më njeh, — u habit Grigori.
- Të njoh si jo. Ti je bariu i fshatit, xha Gori.
- Po ti ç'bën këtu, s'ke frikë nga qentë?
- Po shkop! Ia çaj kokën, ia nxjerr sytë! Shiko xhepat plot me gurë, — tha fëmija me një krenari prej të madhi.
- Ç'punë ke ti me qentë. Ik, se do të të hanë.
- Më tha xhaxhi Sofo. Ai ma dha dhe shkopin. Po të mos jem unë, qentë hyjnë në kishë. Atje po bëhet mbledhje e madhe.
- Pse, ç'ka ndodhur?
- Ii, — u habit fëmija, — pse, s'ditke gjë ti?
- Jo, tani po zbres nga malë. Më kishte humbur një dele.
- Grigori u ul këmbëkryq pranë fëmijës dhe s'kishte të ngorë duke e parë. Nxorri nga xhepi shaminë, e lagu mirë e mirë me pështymë dhe filloi t'ia zbusë e t'ia heqë qurrat e thata. Fëmija iu bind, qëndroi si manar dhe, si ta kishte Grigorin kushëri, i foli ngadalë.
 - Shko futu në kishë, se të bërtet xhaxhi Sofo.
 - O, — bëri sikur u tremb Grigori, — ç'paska bërë vaki kështu?
 - Të thashë apo nuk të thashë? — pyeti fëmija.
 - Jo, s'më ke thënë asgjë deri tani.
 - Vdiq ai.
 - Kush, more, babai i Sofos?
 - Jo, jo. Vdiq Stalini.
 - Stalin, — u habit Grigori dhe ndjeu t'ia përshkojë trupin një korent që nga tëmthat deri te këmbët. Një korent i vërtetë që e tundi sikur të kishte rënë tërmët.

— Šhpëtoi fshati, xhaxhi Gori. As babai s'ka pér tē vdekur, as ti, asnje njeri...

— Shët... mos fol ashtu! — pëshpëriti Grigori.

Fëmija pa me habi Grigorin që zgjati aq shumë buzët, që vuri para tyre gishtin e bëri shë... shë... si mësuesi i fshatit që u mësonte gërmat e abetares.

Grigorin mezi e futën këmbët në kishë, ndonëse nuk ishte veçse katër hapa larg derës së hapur. Kishën nuk e kishte parë kurrë aq shumë të zezë. Të gjithë, burra e gra, djem e vajza, pleq e plaka, kishin rënë në gjunjë sikur të ishin myslimanë e kisha xhami. Përpara derës së altarit qëndronte në këmbë vetëm Sofo Bregu, me trupin e tij eshtak, të drejtë e të lartë, me ballin e tij të madh e gjithë rrudha. Në dorë mbante një copë letër të bardhë. Mbi të, as dy metra, në fagen e madhe të ikonostasit, në ikonën qëndrore, zoti Krisht me tri gishtërinjtë e dorës së djathtë të mbledhur tok s'merrëj vesh nëse bekonte apo mallkonte njerëzit që kishin rënë në gjunjë para këmbëve të Sofo Bregut, zëri i të cilit gjëmonte më një dhimbje sugjestionuese e tepër të singertë:

— Sot, më 6 mars 1953 në orën 6 të mëngjesit u mblo-dhëm në seancën e përbashkët të KQ i Partisë, Këshilli i Ministrave dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor të RP Shqipërisë.

KQ i RPSH, Këshilli i Ministrave dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor njofton me pikëllim Partinë e popullin shqiptar se sekretari i parë i KQ të PK të BS dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave J.V.Stalin vdiq më 5 mars 1953 në orën 9 e 50 të mbrëmjes pas një sëmundjeje të rëndë.

Një fatkeqësi shumë e madhe goditi Partinë Komuniste të BS, popullin vëlla sovjetik, gjithë njerëzimin paqedashës dhe partinë e popullin tonë. Zemrat e punonjësve tanë janë të pikëlluara pér këtë humbje të njeriut më të dashur, e shokut të luftës e vazhduesit gjenial të çështjes së Leninit, udhëheqësit e mësuesit të lavdishëm të mbarë njerëzimit, mikut më të dashur të popullit shqiptar.

Emri i Stalinit është i shtrenjtë në mënyrë të pakufishme pér Partinë e popullin tonë. Emri i Stalinit përfaqëson lirinë, jetën dhe të ardhmen e popullit tonë. Emri i Stalinit është simbol i miqësisë së pathyeshme e të përjetshme që

lidh popullin tonë me popujt vëllezër të BS. Emri i Stalinit është simbol i paqes dhe sigurimit të popujve.

Në këto çaste kaq të rënda për popujt sovjetikë, gjithë popujt e botës, populli shqiptar, punëtorë, fshatarë, intelektualë, gra, të rinj, të reja të Shqipërisë, shtrëngojnë rradhët e tyre rreth Partisë së Punës, çelikosin miqësinë e pathyeshme për popujt vëllezër sovjetikë dhe dashurinë e pakufishme për partinë e Lenin-Stalinit.

Para kësaj humbjeje shumë të madhe që prek Partinë Komuniste të BS, popullin vëlla sovjetik, gjithë njerëzimin paqedashës dhe popullin tonë, KQ i PPSH-së, Këshilli i Ministrave i RPSH, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH duke qenë në seancë të përbashkët vendosën:

1. Të shpallet zija kombëtare në gjithë vendin.
2. Të ngrihet flamuri kombëtar në gjysmë shtizë.
3. Të pushohet puna në qendra pune e prodhimi e shko-

llë

KQ i PPSH
Këshilli i Ministrave i RPSH

Sofo Bregut, kryetarit të kooperativës, dhe komandantit të çtës së fshatit, iu mbarua fryma, sikur çka lexo, ishin fjalët e tij të fundit. Një lëmsh helmi i mbledhur shuk gjeti rrugë te sytë dhe filloj të pikojë. Pikat e lotit rrëshqisnin faqeve, e binin si shi në plakat e kishës. Dora që mbante komunikatën i dridhej. Ai e mblodhi veten si një luftëtar i re gjur.

Tek-tuk në kishë u dëgjuan disa ngashërimë. Grigori se si shpëtoi nga ai tension elektrik që pushtoi sallën. Habia që po shikonte burra me nofulla të shtrënguara, që rrudhnin sytë, që kapërdinin lotët, që më e madhe se dhimbja të cilën e ndjeu si një gjëmë më të madhe nga c'i kishte ndodhur fshatit në ato gjashtë vdekjet njëra pas tjetrës, të gjashtë vullnetarëve që falën jctën për të jetuar Stalini. Grigori u mundua të qëndronte gjakftohtë përpëra asaj që i shikonin sytë, por që e pamundur. Pa sërisht te zoti Krisht mbi kokën e Sofo Bregut dhe u drodh. Që fëmijë ishte rritur në shtëpi e në kishë me emrin e zotit, me bëmat e shenjtorëve, të cilat i besonte dhe nuk i besonte. Gjithë jetës, sa mbante mend, kishte hyrë në

kishë për Pashkët e mëdha e të vogla, për ditët e shenjtorëve të shtëpisë e tërë fshatit, për lindje, në ceremonitë e pagëzimit, të martesave e të vdekjeve. Shenjtorët i pat parë me adhurim e frikë sikur i imponoheshin me një fuqi qellore. Kur në fshat kisha nisi të ftohej e njerëzit të mos shkonin më me rregullin e mëparshëm, ftohje që sesi erdhë, ai nuk e pat menduar kurrë, ai, në vetvete, sikur e ndjeu njëfarë lirie. Dhe kur në fshat, në brigada apo ndër mbledhje, sidomos kur vinin të deleguar nga qyteti në raste fushatash e flitej herë larg e larg e herë troç se s'ka zot, se zoti paskëtaj është vetë njeriu, ai nuk nxehet e nuk shante komunistët si i ati dhe e éma, por ama, as nuk entuziazmohej si vëllai i vogël, Josifi, që pat arrirë deri aty sa ta quante veten me shaka se ishte babai i Krishtit, shaka që nuk guxoi më ta thotë në shtëpi qysh të nesërmën e asaj dite kur hëngri mashën në çakë të kokës e gjaku nuk i pushoi veç kur e éma i vuri një shuk me duhan dhe ia lidhi kokën me napën e djathit.

— Ruana zot nga kjo frymë që po na hyn në fshat, — thoshte me frikë xha Miti e për çudinë e të gjithëve nisi ta bënte kryqin si fshehur, sa herë që shtrohej buka në sofër.

Grigori i uli sytë nga ikona e zotit Krisht mbi kokën e Sofo Bregut. Kur i ngriti sérish u tremb nga ajo që pa. Zoti Krisht iu duk si njeri i zakonshëm me ato sy pak të mëdhenj që shikonin si me dhimbje kallaballëkun në mes të kishës, ndërsa Sofo Bregu i brengosur, me sy të përlotur, i gatshëm të falte sérish jetën për Stalinin, edhe pse Stalinis kishte vdekur, iu duk më interesant se Krishti-njeri. Sytë e Grigorit uleshin e ngriheshin sa te fytyra e Krishtit, sa te e Sofos dhe u tremb kur ndjeu se ajo që ndodhi me Stalinin para ca ditësh në kishë e ajo që po ndodhë sot po në kishë, ishte një tërmët i madh. Tani ai ndjeu atë rrymë korenti që pat kaluar pak më parë në tërë njerëzit e mbledhur në kishë. Tërmëti që i fuqishëm e i çuditshëm. Ai aty shembte çdo gjë, shpërfytyronte gdo send, çdo njeri dhe po aty formonte si me magji po ato që kishte shembur e shpërfytyruar, por një cikë si ndryshe. Grigori sikur arriti të kapë ndryshimin siç e pa te i vëllai i vogël Josifi, që donte të bëhej si me shaka babai i Krishtit dhe siç po e shikonte te Sofua që po bëhej Krisht, aty para gjithë gjindjes së fshatit, që i kishte rënë në gjunjë.

Grigorit iu morën mendtë. Si është e mundur të ndodhë një çudi e tillë? Sofua se si u ngrit përpjetë e se si zuri vend

hë ikonën e madhe, ngjeshi aty shpatuilit dhe më trupin e tij muskuloz zuri gjithë pamjen e Krishtit. Dhe që atje lart i shkeli syrin Grigorit dhe i foli me një zë të çuditshëm që dëgjohej vetëm nga Grigori dhe Sofua vetë.

— Po ti pse nuk bie në gjunjë?
— Unë? E pse? Pse duhet të bie në gjunjë?
— Të biesh, pos! Si të gjithë edhe ti. Ti s'je vec të tjerëve.

— Po ti ç'je? Apo pse hipe atje lart?
— Unë s'jam si të gjithë. Deri sa jam këtu në krye, në altar...

...Një korent tepër i fuqishëm e tundi Grigorin dhc arkivolin.

— Ky qenka derr, jo njeri, — foli mjeku kur pa se Hamdiu e goditi për të tretën herë duke shtuar rrymën elektrike.

— Ai është derr, po unë ama qenqam gomar derisa mora mendt e tua për kombinimin e metodave. Derri do plumb, o doktor e jo dokrra. S'kemi fjalë. Ja ku është dëshmitar Hamdiu. Do të përgjigjemi të dy para ministrit, sigurisht po vdiq, — u detyrua dhe zbuti ultimatumin Ridvan Geseri.

— Jemi të detyruar të presim efektin e elektroshokut, — tha mjeku dhe për të parën herë ndjeu përgjegjësinë e profesionit të tij me një të pandehur, çështja e të cilët kishte kalluar kufijtë deri në Kremlin. Magjia në ambasadë, dështimi i fëmijës dhe vdekja e papritur e Sonjës, i jepte Grigorit një rëndësi të veçantë.

8.

Me urdhër të ministrit, Grigori u shtrua në një dhomë të veçantë të spitalit burg brenda territorit të spitalit të madh të kryeqytetit; ndërtuar që në kohën e Italisë, me dy korpusë të mëdhenj. Pas qëllimit njëri u trajtua si spital ushtarak e tjeter si spital civil. Midis tyre, rrëthuar me mur e me tela me gjemba, me karakolle në katër cepat, ishte ajo pjesë që quhej spitali burg, i cili bënte jetën e tij si dy spitalet e tje-

ra, po në një mënyrë të vetën. Ngado që ta shihje ai dallohej që ishte një burg si gjithë burgjet me të veçantën e tij se atje shërbenin sanitare e infermierë edhe të gjinisë femërore.

Nëse vije vërdallë në oborret e dy spitaleve do të shikoje atë Mizëri njerëzish hallexhinj me copa letrash në duar për të bërë analiza, do të shikoje në ambientet e dy spitaleve dhe të sëmurë me pizhamat e tyre tërë arna, do të shikoje dhe atë që ishte karakteristike e vulëvënëse për spitalet, personelin mjekësor, nga bluza e të cilëve ishte zor të dalloje se kush është mjek, infermier apo sanitari që hynin e dilnin, kurse në territorin e spitalit burg s'të zinte syri këmbë njeriu të gjallë. Askush nuk hynte e askush nuk dilte nga derë e hekurt, e përforuar me tela me gjemba e atij spitali aq sa të krijohej përshtypja se aty brenda s'kish as të sëmurë, as personel shërbimi. Kur hynin e kur dilnin të burgosurit e sëmurë? Po personeli kur hynte e kur dilte? A kishte të gjallë ose të vdekur pas telave me gjemba? Po Grigor Kurtezi si doli nga arkivoli e hyri në atë ferr human ose në atë qivur prej telash me gjëmba? Çdo gjë në spitalin burg ishte pak a shumë si në një ëndërr të keqe.

Pas dy ditësh Grigori hapi sytë dhe u tremb. Arkivoli që ishte bërë pjesë e trupit të tij, i cili nuk e lejonte të lëvizte këmbët, duart dhe shpatullat, ishte zgjeruar e rritur si me magji. Kapaku i arkivolit, që i mbyllte vështrimin, ishte ngjitur lart dhe ishte lyer me gëlqere, ndërsa arkivoli vetë se si qe zbutur, e zëvendësuar me një shtrat të fortë vërtet, por të gjerë aq sa po të kishte fuqi mund të lëvizte trupin. Të gjitha këto Grigori i zbuloi me shumë frikë duke bërë lëvizje të ngadalshme gati të pandjeshme si lule akshami që sado t'i rrish sipër e të vëzhgosh nuk arrin dot të vesh re se si hapen petalet. Gjithë këto të mira aq të dëshirueshme për një trup të torturuar ishin një habi për Grigorin dhe një frikë e re për një lloj kurthi a gracke, që ta detyronte të fliste nesër, ose pasnesër. Grigori hezitoi gjatë. Ta hapte syrin e mirë apo jo? Kishte shumë frikë se me të hapur syrin do të zhdukeshin gjithë ato të mira që ia ndjente kurrizi, gishtërinjtë e këmbëve, shpatullat dhe gishtërinjtë e duarve. Në të njëzet gishtërinjtë e tij, të duarve e të këmbëve, ai ndiente se diçka kishte ndodhur, diçka lehtësuese sikur t'ia kishin futur në ballsam magjik. Kureshtja filloi ta mundojë, po frika nuk e

la që të verifikojë. Po sikur me të hapur sytë kapaku i arkivolin, që ishte ngjitur aq lart e që ishte lyer me bojë të bardhë, siç lyente e ëma çdo pranverë gurin në cep të portës, parvazet e dritareve, bordurat e hajatit, trungjet e pemëve që të ngordhnin mikrobet e dimrit, të shkëputëj nga ajo fuqi e mbinatyrrshme e t'i binte si rrasë varri mu mbi hundën e tij?

«Ç'më duhet të shikoj si e qysh kur kështu siç jam e ndjej veten mirë» — tha Grigori dhe u habit e u tremb edhe nga vetja e tij që më në fund, si për çudi, arriti të ndiej, të kuptojë e të gjykojë.

«Të pres, të pres dhe një çikë» — i thoshte vetes së tij pa arritur të kapë nocionin e kohës, pa kuptuar se kish kaluar dy ditë e dy net aq afër vdekjes. Tani, pothuajse i përmirësuar aq sa ai kishte fituar ndjesinë e të ndjerit, të nuk haturit e të dëgjuarit, iu bë sikur dikush i rrinte te koka, e përgjonte dhe ia lagte buzët. E ëma nuk ishte. Do t'ia kish ndjerë erën asaj, as e kunata, po as edhe ndonjë ëngjëll nga ato që fluturojnë në qiell e flejnë nëpër retë e buta e të bardha të quillit. Grigori ndjeu fare qartë se ajo qenie njerëzore apo qellore që i rrinte te koka iu afrua edhe më shumë. Një petal trëndafili apo një pupël zogu sikur i rëndoi mbi kapakun e syrit të mirë dhe mundohej aq lehtësisht që t'ia hapte syrin. Grigori u bind se ajo që i rëndonte mbi kapak të syrit, sipër qepallave e nën vetullia, nuk ishte as petal trëndafili, as pupël zogu. Ishte një pulpë e butë e një gishti delikat po, derisa ajo pulpë gishti ishte vetëm në syrin e mirë, Grigori u tremb. Pra ishte një qenie njerëzore, përderisa e prekte aq lehtë, por ama, që dinte se ai, Grigori, kishte vetëm një sy, atë mbi të cilin rëndonte aq lehtazi gishti.

«Ai, hetuesi, nuk është. As doktori jo», — tha Grigori dhe sikur të luante bixhoz me jetën e tij vendosi të hapte syrin dhe e hapi për të parë se ku ishte e kush ishte mbi kokën e tij. Në fillim ai dalloi si në mes të mjegullës një qenie që i ngjante njeriut, që kishte një kokë, qafë, trup, të trija të bardha me përjashtim të dy njollave sa dy kokrra arra ose ullinj të pjekur në ngjyrë pak të errët. Dhe tej kësaj qenie në formë njerëzore, gjithçka ishte e bardhë. Nuk besoi atë që pa. Nuk i mbushej mendja. I dukej e pabesueshme. Po të mos ishte në arkivolin e tij, duhej të ishte patjetër në parajsë. Që të ndodhët kjo mrekulli duhej të besonte se ai vetë, Grigor

Kurtezi, ishte shndërruar në një Krisht ose në një nga nxë-nësit e tij apostolikë, ose thjesht ishte shndërruar e ishte bërë shën Grigor Kurtezi me fuqi hyjnore, i paprekshëm nga asnë fuqi e Satanait, domethënë ai i kishte dhënë fund jetës së mundimeve, ishte përjetësuar e kishte të drejtë të kalonte kufirin me tela me gjëmba pranë fshatit të tij, që e priste faqen e malit përgjysmë, duke e ndarë padrejtësish kullotën në dy pjesë dhe familja e tij, nëna, dy vëllezërit, kunata, dy nipat, mbesa e tërë farefisi të mos kishin më asnë pasojë.

— Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshiromë e shpëtomë, — dëgjoi Grigori fare të qartë e të pastër zërin e priftit e të psalltit të fshatit.—Mos ik, o Shenjt, mos na braktis, mos shko nëpër dete, oqeane, mos gris këpucët si Shën Spiridoni i Korfuzit që bredh derë më derë në Gregi, Maqedoni, Bullgari e Turqi. Ti je shenjti ynë, o Shenjt Grigor Kurtezi, ti duhet të na ndihmosh e të na shpëtosh së pari ne, se s'ka më keq e zi se sa jemi ne në fshatin tonë, në fshatin tënd. E dimë, o shenjt, se u shenjtërove nga dhimbjet e trupit e të shpirtit tënd, se nuk na kallzove si Judë Iskarioli me puthje e përqafime. Durove atë që s'e ka duruar kush deri më sot, u gozhdove për së gjalli si zoti Krisht. Dhe gishtërinjtë e tu që i bënë theror i shndërrrove me fuqinë e dhimbjes në qiri që pikonte gjak nga gjaku yt e jo dyll nga të bletëve punëtore. Shenjt perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, bëje thagmën tënde të parë në fshatin tënd ku të polli skamja e uria. fol me Atin, Birin apo Shpirtin e shenjë e jepu fund jo mundimeve tona, se pa to kemi frikë mos mëkatojmë e s'kemi se si të pastrojmë mëkatet e përditshme, po ndaloj për një çast, sa të mbledhim mendjen nga vdekjet që kanë pllakosur fshatin tënd, nga ajo lubi që ka marrë kosën e po na kosit si të jemi hithra e shpendra të helmatisura. Jemi njerëz edhe ne si gjithë njerëzit e kësaj bote të mbrumur nga balta dhe e dimë që do të kthehem sërisht në baltë, por sipas urdhërit të tij madhit Zot e jo kështu, se ia do qejfi Sofo Bregut e shokut Ali. Merru vesh mirë, o Shenjt Grigori ynë, e nëse kjo gjëmë që na pllakosi është dëshira e Perëndisë, po e durojmë e s'po ankohermi, po në qoftë ndonjë urdhër tjetër a intrigë, a poshtërsi, hile apo dinakëri dhe shkojmë si dhjamë qeni për hesap të Satanait, na jep shenjë e ne do ta kuptojmë.

Grigori nuk dyshonte aspak se zëri që dëgjoi ishte dueti prift-psallt. Me ata dy zëra ai qe mësuar që fëmijë e derisa u rrit e vajti në teknikumin bujqësor të Kamzës. Dhe pas shkollës të lënë përgjysmë, ai i pat dëgjuar ato dy zëra që ishin kombinuar prej vitesh derisa ishin plakur tok duke kënduar ungjift e lutësorët, herë njëri e herë tjetri e herë të dy siç i do rregulli i shërbesave fetare, por nuk kuptoi çudinë që ato dy zëra të kishin një fytyrë ëngjëlllore me tipare femre, tipare që dalëngadalë, duke u larguar mjergulla e bardhë po formoheshin. Grigori puliti sytë. Po t'i punonin gishtërinjtë e po të kishte thonj ai do të pickonte lëkurën e tij e do të vinte në vete, do të bindej se ç'po i shikonin tanë sytë, nuk ishte as vegim, as marramendje, por një e vërtetë si gjithë të vërtepat. Mbi kokë ishte infermjerja e caktuar nga drejtori i spitalit. Çudia ishte vetëm që ajo, ashtu siç e shikonte syri i mirë ishte tepër e brishtë dhe shumë e bukur, me kapuçin e bardhë në kokë, me lëkurën qumësht të bardhë të fytyrës, qafën e gjoksin pak të mbuluar nga bluza po e bardhë. Në tërë bardhësinë e pastërtinë e saj nxinin e vezullonin dy sy të zez të harkuar nga dy vetulla po të zeza që e vështronin po me atë habi që vështronë dhe ai, bile habia e saj sikur ishte më e madhe.

Dy net më parë, kur e sollën Grigorin në spitalin burg, ishte ora tre e natës. Në qìell po thyhej errësira e po binte ngadalë drifa e bardhë e agimit të ditës. Ajo ndjeu e para çelësin e bravës së madhe të oborrit të burgut që binte mbi drifat e infermierisë, tamam mbi shtratin portativ pas paraventos dhe u drodh si kulpër në krahët e mjekut të rojes dhe mezi u shkul nga trupi i tij, por nuk mundi të largohej se mjeku ia kishte thithur thumbin e sisës, sikur do t'ia hante.

— As në spitalin burg, rrëthuar me mure, tela me gjemba, roje e gardianë, s'bën dot dashuri njeriu i shkretë, — tha me të qeshur doktor Petraqi dhe ra në këmbët e bukura të infermieres duke ia përkëdhelur pulpat e kofshët në kohën që ajo, duke iu dridhur duart, mbërrhente kopsat e bluzës së bardhë të cilën e mbante pa këmishë. Zgjati dy buzët e saj të tulta si dy gonxhe trëndafili të zjarrtë, puthi tullën e doktor Petraqit, si pér t'i kërkuar ndjesë dhe u sul me shpejtësinë e një sorkadheje të trembur në korridorin e shkurtër të spitalit pér

të qenë pas derës, në krye të detyrës, apo të hynte urgjencia. Si infermieri ajo tashmë e kishte mësuar se nga ajo e nga mjekët e spitalit burg kërkohej vetëm korrektësi ushtarake, prezencë në krye të detyrës pavarësisht seç ndodhje me pacientin, shërohej, sëmurej më keq apo vdiste. Jeta e atyre që vinin aty nuk varej nga ndihma mjeksore. Ishin të tjerë njerrëz ata që e dinin ose kishin përcaktuar që ky apo ai të mje-koheshin ose të bëhej sikur mjekoheshin ose të vdisnin në mje-kim e sipër a operim. Në spital kishte rregull e disciplinë tepër korrekte, pak të habitshme, por ja që ashtu ishte. Të gjithë bënин sikur punonin, të gjithë ishin të preokupuar për punën pavarësisht se sa punohej e c'rezultate arriheshin. Në spitalin burg s'varej asgjë nga puna. Aty dihej që më parë se ç'do të ndodhje, se ç'do të raportohej e se ç'do gjë ishte e përcaktuar nga një urdhër apo fuqi, e cila ndonëse nuk ishte thënë e nuk ishte marrë as me gojë e as me shkrim zbatohet nga të gjithë. Në spital shkonin shpesh raste kontrolli ose inspek-timi nga instanca të ndryshme, të larta dhe çdo gjë dilte më se normale, ishte bërë çdo gjë, bile dhe e pamundura dhe të gjitha ishin të dokumentuara me përpikmëri e korrektesën më të madhe. Dhe Çiliana e detyruar të zbatonte këtë korrektësi u ndodh tamam në qastin që do të hapej nga jashtë dera e brend-shme e spitalit. Në aq kohë sa do që të hapet një derë me bra-vë e gelësa burgu, një vajzë e shkathët dhe e mësuar me ngac-mimet e personelit të vogël të spitalit burg, bëhet gati: fut gjinjtë në sytien, dyston jakën e fundin e bluzës së bardhë, i jep një të kreher të shpejtë me gishtërinj flokëve, vendos ka-puçin e bardhë dhe i jep fytërsë seriozitetin e detyrës sa hu-manitare aq dhe ushtarake.

Dera u hap dhe u përplas pas murit. Çiliana, që e dinte se si hapej ajo derë, gjithnjë rrinte një hap më larg. Megji-thëse dera bënte shumë zhurmë e potere ajo, si personel sanitar, duhej të ishte e urtë, asnjëherë e habitur apo e ekzal-tuar sikur kushedi se ç'po ndodhje. Të gjitha provat Çiliana i kishte kaluar me sukses të plotë. Çfarëdo pamje makabre që t'i shikonin sytë, veç këtë rradhë ajo nuk arriti dot ta mposhi-te vjetveten. Britma e saj që kaq e papritur dhe aq e fortë sa doktor Petraqit i ngriu gjaku, i shkoi mendja për keq, dhe,

pa mbërthyer mirë lidhësat e këpucëve, u sul në korridor i bindur se do të kish ndodhur diçka e ligë me Çilin, megjithëse ishte i bindur se Çiliana s'bënte kurrë skandale në çastet kur dikush nga personeli guxonte të zgjaste rastësish dorën. Dhe doktor Petraqi u habit, sepse s'kishte parë kurrë që vigin me të burgosurin e sëmurë ta mbante hetuesi, drejtori i burgut, gardiani dhe mjeku specialist, psikiatri Sherif Merzhan i dhe që të katër ecnin ngadalë sikur të mbanin me vig një njeri prej qelqi apo më saktë një të vdekur prej kristali të rrallë ngjyrë mjalti.

— Sallën e mjekimit gati e ke? — pyeti doktor Sherifi.

— Gati, po unë jam vetëm me Çilianën.

— Të ndihmoj edhe unë. S'ka nevojë për njeri tjetër. Shyqyr që qenke ti.

Doktor Petraqit iu përkëdhel sedra që Sherif Merzhan, mjeku më me influencë, mik shtëpie i ministrit tha: «shyqyr që qenke ti».

Kur e vunë në shtratin e mjekimit, që ndriçohej mirë, doktor Petraqi bëri gabimin e parë duke pyetur: gjallë éshtë?

Zakonisht në atë sallë mjekimi apo operacioni, apo ekzekutimi nuk flitej, nuk pyetej e as nuk merrej përgjigje. Mjekët specialistë, që kryenin sipas grafikut shërbimet e rojes, ose thirreshin, sigurisht të besuarit, duhej që, pa folur as me vetveten, të kuptionin vetë gjithçka. Ata shërbenin aty vetëm njëzet e katër orë ose më pak orë, aq sa duhej. Të nesërmen ata do të shërbenin në pavionet e tyre o në spitalin ushtarak, o civil dhe duhej të fshinin nga kujtesa se c'bënë e c'panë në spitalin burg gjatë shërbimit të tyre. Ata s'duhet të dinin asgjë. Bile në shumicën e rasteve ata nuk dinin ose s'donin të dinin as emrin e pacientit, as diagnozën të cilën zakonisht e shkruante Sherif Merzhan.

— C'duhet të bëjmë? — pyeti doktor Petraqi i bindur se do të punonte jo mbi një të burgosur të sëmurë, por mbi një të burgosur të vdekur, kufoma e të cilit duhej të linte përshtypjen se ishte bërë gjithçka për ta mbajtur gjallë.

— Ka disa fraktura. Duhet të bëjmë imobilizimin e tyre. pastaj të shohim! — tha doktor Sherif Merzhan.

Doktor Petraqi zgjati dorën dhc u mundua të kaptë pulsin. Sherif Merzhan përdrohhi buzët i pakënaqur.

— Gjallë është gjallë, — tha Sherif Merzhani, — bille duhet të bëjmë çmos që të mos na vdesë, të paktën pér disat. Megjithatë gishtërinjtë e doktor Petraqit kërkonin të kapnin pulsin.

— Mos ka hemorragji të brendshme, — pyeti Petraqi.

— Çdo gjë mund të bëjë vaki. Nga analizat del se ka pasur anemi. Grupi i gjakut është AB.

Sylë e Petraqit ndeshën me sytë e Çilianës.

— Kemi gjak AB, — tha ajo dhe u largua sikur të kishte marrë urdhër.

— Po grafia është bërë? — pyeti doktor Petraqi.

— Sigurisht. Pasi të mbarojmë punë do t'i marr me vete, sepse më duhen pér studimin, — tha i qetë Sherif Merzhani dhe si hapi dosjen me një tufë grafish ia zgjati një nga një.

Fytyra e doktor Petraqit u rrudh, sidomos balli i tij i lartë që ai, gjithë kujdes, e duke përdorur brilantinë, mundohet ta mbulonte me flokët anësore, të cilat se si u çkolidën dhe ranë duke mbuluar veshët.

— Është kafka, — ndërhyri duke sqaruar me qesëndi doktor Sherifi.

— Qenka vërtetë me vlera pér t'u studiuar, — pëshpëriti Petraqi sytë e të cilit prej njëzet e ca vitesh eksperiencës'kishin parë një kafkë të tillë si kafkë prehistorike që duhej t'i përkiste një specie që duhej të ngjante me njeriun, veç pa hundë, me nofulla disa pjesësh dhe me një ballor sikur të ishin tre koka të ndara nga njëra-tjetra.

— Kjo është e klavikulës së majtë, këto janë të dy këmbëvë, kjo e krahut të djathë, kjo e brinjëve.

«Pse s'thua që paskemi një njeri përslesh?» tha me vete Petraqi dhe u mundua të buzëqeshte e ta falenderonte doktor Sherif Merzhanin që i dha mundësi të shikonte një rast kaq të rrallë, me gjashtëmbëdhjetë fraktura kockash pa llogaritur dëmitimet e organeve të brendshme.

— Atëherë të fillojmë, — vendosi doktor Petraqi dhe pa pritur aprovimin e kolegut e të hetuesit zbrazi në legen gjysmën e thesit në allçi. Çiljana, që sapo hyri me dy shishe në duar, i vendosi në stativ dhe hapi dollapin e garzave.

— Merr gëershërë, prija të gjitha rrobat dhe pastroja lëkurën, — i pëshpëriti doktor Petraqi me atë të folurën e tij

karakteristike me zë të ulët e të pakët, shprehi e profesionit të tij si kirurg.

Për shtatë minuta duart e shkatheta të Çilit, duke prerë rripa-rripa teshat e leshta, nxorën në shesh trupin lakuriq e të deformuar të pacientit. Më vështirë e pati ta pastronte, gjithë dyshim se nuk kishte të bënte me një të gjallë, por me një të vdekur. A ka mundësi të kesh kaq fraktura, aq plagë e të mos rënkopsh?

Vetëm kur iu tërroqën dy anët e kockave për të bërë imobilizimin e frakturave, Grigori rënkoji.

Cili ana u bind se ai njeri lakuriq, i cili u fashua e u all-çizua, ishte një i gjallë por jo si gjithë njerëzit. Atij nuk i kishte mbetur pa u fashuar asgjë, vec syve e buzëve. Dhe të njëzet gishtërinjtë e tij pa thonj u mjekuan e u fashuan.

— Tani mund të shkojmë të qetë. — u tha doktor Sherif Merzhani hetuesit, drejtorit të burgut dhe gardianit.

Kur dolën në rrugë, doktori i tha hetuesit:

— A e vure re doktor Petraqin se si e fashoi Grigorin?

— Sigurisht,

— E çfarë të ra në sy? — pyeti Sherif Merzhani.

— Që s'la asnje pëllëmbë vend për mua. Po unë di një më shumë se ç'dinë mjekët, — tha i zemëruar Ridvan Geseri për këtë shaka me thumb.

— Për shembull? — pyeti kureshtar Sherif Merzhani.

— Doktor Petraqi harroi tia fashonte koqet.

Kur doli në rrugën e Dibrës, hetuesi pati fat. Nga sipër po zbriste për në qendër të qytetit një pajton. Në atë gjysmë drite e gjysmë errësirë të agut të asaj dite ai dalloj fenerin e ndezur të pajtonit, i cili lëkundëj si një djep dhe dëgjoi këmbët e kalit që godisnin asfaltin. I zgjati dorën karrocierit dhe hipi në ecje e sipër. Karrocierit nuk i kishte dalë akoma gjumi, kurse kali ishte si i hazdisur.

— Në rrugën e Durrësit, përbalë ambasadës sovjetike, — foli Ridvan Geseri dhe u mbështet në sedile pas kurrit të kërrusur të karrocierit plak.

Tirana flinte. Dhe qendra e saj flinte. Në sheshin Skënderbe kishte rënë një mjegull e lehtë. Sheshi i tërë ishte

mbushur me jevgħa dha arixheshka qe' me fshesat e tyre tē għata dukej sikur po shtynin mjegullēn.

— Skam parę kaq jevgħa, c'béhet kështu? — pyeti Ridvani.

— Mbase do tē ketē ndonjē miting. Thonē, se unē pēr vete nuk di gjie.

— Po tjetēr c'thonē? — e ngacmoi Ridvan Geseri karrocierin, po ai nuk u pērgjigj. Ridvani u bē kureshtar pse nuk u pērgjigj plaku dha zgħati kokēn dha pērkuli qafen. Karrocieri po flinte ose bēnte sikur flinte.

— Nē rrugġen e Durrēsit, — i pērsériti Ridvani pēr tu bindur nēse flinte apo bēnte sikur flinte.

— E di kali atē punē, — u pērgjigj karrocieri.

— Si e dika kali? — u habit hetuesi.

— Po a e dēgħoi Čili kur hipēt nē karrocē?

— Čili? — u habit sérish Ridvani sapo dēgħoi emrin e infermieres sē bukur.

— Po ċil eshtē, nuk ia pe pikat? E shikon si hyri nē rrugġe tē Durrēsit. E njeh Tiranēn me pəllēmbé. Kētu ka lindur, kētu u rrit e kētu po plaket. S'di si do bēj kur tē mē ngordhē.

— Mbaje, mbaje, — foli Ridvani sapo iu afraa shtepisē. Kali qendroi me urdhärin e Ridvan Geserit, tē cilit sikur iu bē qejfi.

— Paske kalē tē zgħuar, — tha Ridvani, pagoi dha zbriti. Sytē i mbetēn nē drittaret e apartamentit tē shtepisē sē tij. Tē gjitha drittat ishin tē ndezura. «Po ajo sikur tha se do tē shkonte nga e ċema, se kishte frikē nga hija e atij» — tha me vete Ridvani dha ngħiġi shkallét dy e nga dy. U qetēsua vetem kur hapi derën e dhomēs sē gjumit dha pa tē shoqen qe' flinte me tē ċemien. Me kujdes qe' tē mos i zgħonte mori nga komoja njē palē nderrresa dha u fut nē banjē pēr tē bérē njē dush, me ujin as tē ftohtē e as tē ngrohtē tē rezervuarit maję tarracċés. Sapo sapunisi trupin dēgħoi hapa nē korridor. Qe' tē mos trembeshin foli i pari.

— Jam unē, Ridvani, sapo erdha.

— Aman, o zot, — pēshpēriti Rita, — ti do mē vdesħej njē ditē. E moj, mama! A hyn burri si hajdut nē shtepinē e tij? Shiko si mē rreh zemra!

— Qetēsohu, bije, qetēsohu. Na, pi pak ujje. Ċ'ke tanu! Yt shoq, eshtē, nuk eshtē ai qe' mos qoftē.

Ridvani qeshi me fjalët e grave është si për t'i ngacmuar i foli:

— Ai do të vijë pak më vonë.

— I ardhë gjëma, i ardhë. Kur bëhen sebep ca horra! Sa për të na prishur gjakun. Nëmi mua këta çarçafë. Ti shtro për vete çarçafë të tjera.

— Më shtronit tavolinën se vdiqa për të ngrënë, — ngriti zërin Ridvani.

— Vdeksh ishallah, bashkë me atë katundarin e qelbur që më është bërë si hije. O, mama, kur do të shpëtoj unë nga ai lugat, ë?

— Ja, të erdhi burri, rri e qetë tani, mos bëj budallallëqe. Merr vesh, apo jo? Ç'do t'i japësh për të ngrënë, ë? Bëja gati tavolinën.

— Varrin, thuaj, varrin jo tavolinën.

Nga banja u dëgjuat e qeshura e Ridvan Geserit i cili, mbasi ishte larë e fshirë, rrinte brenda e gjithë qejf dëgjonte të shoqen e të vjehrrën.

Tavolina në kuzhinë ishte shtruar me gjithë të mirat. Ridvani futi një qofte në gojë, e përtypi shpejt e shpejt, piu gjysmë gote verë të kuqe, u shtriq dhe u ngrit duke u justifikuar:

— Vdiqa për gjumë. Eja grua.

Sa hyri në dhomën e gjumit u zhvesh lakuriq, u fut në shtratin e gjerë dhe ndjeu kënaqësinë që i jepnin çarçafët me atë erën e të shoqes. Në të vërtetë kishte ura, por, duke u larë e duke dëgjuar zërin e së shoqes, atij i erdhi një epsh i fuqishëm si një korent. Nëse kjo që ndjeu do t'i kishte ardhur në rrugë ai do të kishte kapur fshesaxhien e parë e do të zbrazej nga ai tension. Kur erdhi e shoqja në dhomë ai i bëri shenjë që të zhvishej e të futej në shtrat, ashtu siç e kishte pjellë e ëma. Rita s'po e njihte të shoqin, i cili e pushtoi dhe e ngjeshti pas trupit të tij dhe i pëshpëriti:

— E di se në shtëpi më solli Çili.

— Cila Çili, more, ajo kurva e spitalit të burgut?

— Jo, atë e quajnë Çiliana.

— Shkurt i thonë Çili, apo jo?

— Çili i thonë për shkurt po unë nuk e kam fjalën për të.

Çili quhej kali që më solli, — pëshpëriti Ridvani dhe duke përkëdhelur të shoqen iu bë se kishte në gjii Çilin e spitalit. Sa më shumë që përmendej emri i saj, aq më shumë i dukej se

vërtet kishte në shtrat Çilin, e në pëllëmbët e duarve gjinjtë e saj.

Ridvani u drodh.

— C'pate? — e pyeti e habitur Rita, e cila akoma nuk ishte ndezur kur i shoqi u shua.

— Mbarova.

— Kaq shpejt?

— Nuk e di, po deshe ngrihu e më sill atë pjatën me qofte dhe një çikë bukë.

— Po mamaja ç'do të thotë?

— Le të thotë ç'të dojë.

— Nuk ngrihem, — tha Rita dhe i ktheu shpinën.

— Atëherë do të ha ty, — tha Ridvani dhe ia kafshoi lëkurën e butë të shpatullës dhe bënte sikur po ia këpuste.

Rita u ndez, u kthyte me vrull, i hipit të shoqit sipër po ai hiç, rrinte i ftohtë si një trung.

— Ore, burrë, c'ke? Pse erdhe, ë? Mos të vdiq në duar ai?

— Mos ma kujto atë.

— Ku e ke? Me kë e ke lënë?

— Me Çilin, Çilianën pra! — shtoi hetuesi kur pa sytë e gruas që u zgurdulluan. Në burgun e spitalit. E çuam bashkë me Sherif Merzhanin dhe drejtorin e burgut. Kishte nevojë pér t'u mjekuar. Sot e nesër. Te koka ka Çilin. Ajo do ta pér-gjojë. Mbështetje i thotë ndonjë fjalë asaj.

— Si, s'ka folur akoma?

— Jo, Dhe kam shumë frikë se s'ka pér të folur. C'nuk i kam bërë. Dhe në arkivol e kam futur, ashtu të gjallë.

— Në arkivol? — u tmerrua ajo.

— Po, dhe kapakun ia kam mbërthyer me gozhdë.

— Po ai?

— Ai më shumë tmerrrohet kur ia hap kapakun se sa kur ia mbyll.

— Dhe ti je i bindur se kur ia mbyll kapakun me gozh-dë ai është aty?

— Mos u bëj budallaçkë si ai matufi, doktor Sherifi. Specialist pér trurin, gjoja!

— Nuk jam budallaçkë. Pér kokën e mamit që unë e shikoj atë, po aty, në karrige. Rri e më shikon kur zhvishhem, kur lexoj. Pse s'më beson, ë?

— Skam se si të besoj broçkulla të tillë.

— Po atë Çilin e beson?

— Atë po. Ajo nuk flet budallallëqe. Ç'dëgjon thotë. Esh-të një infermiere e shkëlqyer. E bukur, naive, me pamjeën gjëlli, me sy që të qetëson.

— Ngadalë, ngadalë se mos na bie në dashuri me të.

— Me atë mund të bësh dashuri sa të duash pa qenë nevoja të biesh në dashuri.

— Si është puna e saj, ë? — u bë kureshtare Rita, — ajo mund të gjente një punë shumë të mirë, mund të merrte një burri për të qenë. Sa vjeçë është?

— Njézet e dy.

— Po aty sa vjet ka që punon?

— Pesë vjet.

— Domethënë pesë vjet burg.

— Aty i ka të gjitha ama. Aty fle, aty ha, aty bën dashuri me mjekët. Më vjen keq që dëfren me ato humbameno që duhet t'u përkëdhelësh bolet me dorë që t'u ngrihet.

— Si ra aty ajo, ë?

— Si zakonisht, për një gabim, për një faj të vogël. Kur ishte në kurs si infermiere, u kap duke bërë dashuri nga Shën Prokopi me një student të huaj, më duket se francez. U bë skandal atëherë, nuk e mban mend ti?

— Jo.

— Si jo? U thirr ambasadori në ministrinë e jashtme. U bënë dhe dy-tri nota qeveritare. Ai studenti kërkoi të martohej me të, bile të merrte dhe nënshtetësinë shqiptare. Shkroi disa letra, deri lart fare.

— Dhe..., — e nxiti e shoqja.

— Dhe përfundoi infermiere në burgun e spitalit.

— Po atje sikur punojnë njerëz të besuar?

— Punët e sigurimit, grua! Të gjithë i afrohen se është e ëmbël, por të gjithë ia kanë frikën. Thonë se ka bërë shërbime që nuk paguhen me flori. Unë di të them që ajo është me pruspektivë të madhe.

— Po, po, duke tundur bolet e mjekëve. Kështu ua përkëdhel Çili? — tha Rita dhe rrëshqiti dorën e saj midis shalëve të të shoqit duke i lëvizur ngadalë e lehtë majat e gishtave dhe pëllëmbën e dorës, pastaj zgjati buzët dhe ia mbylli gojën.

— Mos të ta dëgjoj më emrin e Çilit këtu në krevat, mire?

— Mirë, emrin e Çilit s'kam për ta zënë më me gojë këtu

në krevatin tonë,— tha Ridvani duke ndjerë sërisht atë ngarkesë e atë korent që kish ndjerë më parë.

Dy net e dy ditë Çiljana Sureli e ushqeu pacientin e sij me gjak, me serum, me glukozë intravenoz, dhe la njomë buzët e çara e të thara si dy brazda me një copë pambuk që e zbutë gjithnjë në një gotë me ujë të freskët dhe së fundi ndjeu atë gëzim që ndjen çdo nënë e re kur nis të japë me lugë pak çaj, pak qumëshët dhe kafe fëmisé të sëmurë. Ndërsa detyrën e parë të shenjtë e bëri me përkushtimin e një murgeshe, detyrën e dytë, të mbante mend se ç'do të belbëzonte ai, e harroi fare jo nga dhimbshuria por nga habia e tronditja. Ajo besoi se po i shërbente e po përgjonte një të gjallë vetëm kur pikat e para të gjakut që binin në pipetë rrëshqitën e humbën në damarin e krahut të pacientit. U bind se në trupin e tij të sakatuar, të thyer e të dërrmuar kishte jetë, se zemra e tij rrihte e gjaku, që ajo ia dha me aq përkushtim e kujdes, shpérndahej ngadalë në atë trup të fashuar e të allçinosur këmbë e kokë si të ishte një njeri bocet, një formë nga e cila nesër skulptori do të bënte monumentin e dhimbjes dhe torturës njerëzore. Dhe mjekët e shërbimit, që vinin e iknin sipas grafikut, ndonëse ishin mësuar të ar-gëtoheshin me Çilianën, nuk guxuan të fusnin duart nën bluzën e bardhë të infermieres së përkulur mbi atë kufomë të bardhë.

— E di ti Çili se këto dy ditë ti ngjalle një të vdekur? — i pëshpëriti doktor Petraqi afër veshit pa i shkuar fare ndër mend se mund të zgjaste buzët e tij aty nën vesh ku fillonte ajo qafa e bukur mjelme.

Çili ia ndjeu frymën doktorit po jo buzët. Ajo ngriti kokën e pa me dashuri mjekun dhe i pëshpëriti.

— Merita është tëndja, doktor!

— Jo, Çili. Unë punova mbi të si kasap ose si skulptor. Hodha allçinë dhe e fashova i bindur se ai ose ishte duke vdekur ose do të vdiste pa mbaruar unë fashimin. Nëse shpëtoi atë e shpëtove ti.

— Si ishte porosia për këtë? — pyeti Çili dhe, meqë ishte e bindur se pacienti ishte gjallë e mund të dëgjonte, lëvizë pëllëmbën e dorës me nëntekstin: Të vdiste apo të bënin çmos për ta shpëtuar.

Mjeku mblodhi supet dhe i dha të kuptojë se nuk dinte gjë, megjithëse nga mënyra se si e sollën dhe preokupimi i grupit që e shpëtoi, ai krijoi përshtypjen se ky njeri duhet të jetonte edhe disa ditë.

Sytë e Çilit mbeten të pakënaqur nga përgjigja e mje-kut:

— Mos mu zemrë Cili. Në komi për detyrë të bëjmë tonë. Të tjerë kanë detyrat e tyre, — i pëshpëriti Petraqi në vesh dhe si për ta qetësuar që ajo të mos i mbante mëri, se nuk guxoi të shfaqte hapur mendimin e tij, e puthi shumë le-hëtë në faqe dhe doli. Çilit iu skuq faqja, pshëretiu dhe pa me frikë pacientin e implikuar në atë çështje aq të ngatërruar të magjisë së hedhur në ambasadën sovjetike. Frikën ia futi heshtja dhe largimi në atë mënyrë i doktor Petraqit. Tani, pas dy netësh e dy ditësh, ajo e pa pacientin jo si njeri hallexhi, fatkeq e buzë varrit, po si një agjent ndërkombëtar shumë të rrezikshëm. Ajo sikur ridëgjoi zërin e hetuesit Ridvan Geseri që i tha atë natë para se të largohej: Është personi më i rëndësishëm që ke pasur të bësh këtu në spitalin burg. Ti e di vetë detyren tënde. Ta thashë vetëm që ta dish. Dhe kush është ky ta thashë që të mos e harrosh. Po ta përsëris, e quajnë Grigor. Mundohu të mësosh se nga ç'fshat është, ç'mbiemër ka...

— Kaq?! — iu përgjigji Çili e habitur dhe e lehtësuar.

— Hë për hë kaq, — tha hetuesi dhe u largua.

Dy ditë e dy net ajo e pat harruar porosinë apo urdhërin e hetuesit. Vetëm tani, pas ikjes në atë mënyrë të doktor Petraqit, ajo u kujtua përmisionin e saj dhe pa me dyshim pacientin i cili me siguri, duke lëvizur me mundim qepallat e syve, përpiquej të shikonte po, ngaqë vështrimi i tij ishte i pavendosur, ajo u bind se ai nuk shikonte veçse mijegull.

— Mos u sforco, mos e lodh veten, — i pëshpëriti Cili nga frika se mos pacientit i plaste ndonë kapilar gjaku, — më mirë pi një lugë kafe. Ashtu! — tha e kënaqur kur Grigori u përcoll dhe nxori majën e gjuhës.

— Paske etje, mor i shkretë, é? — pëshpëriti sërisht Çili dhe i dha rradhazi disa lugë.

Grigori i hapi dy sytë. Çili e kaloi shpejt vështrimin e saj nga syri i keq te i miri dhe u drodh. Ajo u bind se pacienti tani po e shikonte.

Grigori lëvizi buzët. Nuk ishte tjetër veçse një buzëqeshje

tepër e vështirë, e mundimshme që Grigori s'mund të irrinte pa ia dhënë. Ai u bind se ajo që po shikonte nuk ishte një ëngjëll, por njeri, një vajzë e veshur me të bardha. Mbësë një nuse. Po cila nuse? Ç'do një nuse mbi kokën e tij? Sytë iu mbylliën dhe buzët iu puqën, u rrudhën nga stërmundimi i trurit për tu përmendur. Mos ishte nusja e të vëllait? Apo ajo baresha e fshatit fqinjë, Dhoksia që duke kërkuar delen e saj të humbur, mbiu si nga dheu te gardhi i vathës së tij, kur po mizonë tufa dhe i tha me lot në sy se e kishte parë Bardhishkën e saj, atë delen budallaçkë.

— Bardhishkën? Aty e ke, hyr e merre. Aty ka që në mëngjes me delet e mia. Do të të lëshoja zë, por nuk ta dija emrin. — gënjeu Grigori.

— Dhoksi, — tha vajza e uli kokën.

Të bardha apo të kuqe i kishte faqet Dhoksia? Grigori doili nga hija e dendur e valanidhit, vu dorën si strehë mbi sy, e kapi për leshi të qafës Bardhishkën dhe e hoqi hosh deri te kapërcylli i vathës, aty ku baresha qëndronte si e pikuar nga qielli bashkë me atë renë rudë, që i qëndronte mbi kokë e gatshme për ta rrëmbyer, për ta ngritur sérish në qiell, nëse Grigori do të zgjaste duart.

— Është e treta herë që vjen tek unë, apo jo?

— Ç't'i bëj Bardhishkës!

— Po erdhi edhe një herë do ta therr e do ta sjell lëkurën në shëpi. Kam edhe dy fjalë me tét atë?

— Jam e vogël, — tha Dhoksia e uli sytë.

— Atëherë po pres vjeshtën. Mirë?

Dhoksia uli kokën dhe u bë lulëkuqe aty buzë gardhit.

— Ja ku e ke Bardhishkën. Po s'fole s'ta jap. Thuaj ç'të duash, veç fol, — ngriti zërin Grigori dhe nuk u besoi syve. Dhoksia e kuqe u zbardh, u zbeh dhe nisi të bjerë si ta kish kositur kosa. Grigori lëshoi Bardhishkën e kapi Dhoksinë që të mos rrëzohej. E ngriti në këmbë, e tundi, dhe ashtu e mbajti derisa faqeve u erdh ngjyra e purpurt. Ai ndjeu se ajo u ngjall nga shtrëngimi i duarve të tij. Zgjati buzët po sytë e Dhoksisë u nxinë. Ajo u shkëput e iku e ndjekur nga pas prej Bardhishkës. Te hija e dytë e valanidhit qëndroi, qeshi dhe i loli:

— E mira është të presësh vjeshtën, po s't'u prit eja!...

Kërciti brava e derës. Cili ktheu kokën e trembur. Në të

çarën që u formua ajo pa gjysmën e trupit e të fyttyrës së hetuesit. Ai i bëri shenjë me gisht.

Pas dy netësh e dy ditësh Çili u ngrit nga koka e Grigorit dhe doli nga dhoma.

— E? — pyeti hetuesi.

Çili tundi kokën në shenjë mohimi duke provuar një lloj kënaqësie që nuk e pat ndjerë prej pesë vjetësh që punonte aty.

— Ka buzëqeshur vetëm dy herë, — raportoi ajo dhe çuditërisht, tepër e qetë dhe e vendosur, i tha vetes: «Edhe po të dëgjoj ndonjë fjalë, ndonjë emër, këtij s'kam pér t'ia thënë. Është krim të përgjoj e të tradhtoj atë fatkeq që vdiq e u r. g. jall».

— Do të vij prapë, — tha Ridvan Geseri.

— Këtu më ke, — u përgjigj Çili më një gatishmëri të cilën ajo e ndjeu se ishte e shtirur. Kur hetuesi u largua, ajo u tregoi pér vendimin që kishte marrë pak çaste më parë. Mbylli derën me frikë dhe e trondituri iu afrua pacientit të saj.

Aj, sa pa Çilin te koka e tij, i buzëqeshi. Syri i tij i mirë tanj ishte i qartë, i pastër, i kthjellët si sy fëmije.

9

Lumturia e Grigor Kurtezit qe e shkurtër. Me t'u kthyer sërisht në burg, në dhomën e torturave, u tmerrua. Ai përmirësim i shëndetit, pastrim i trupit, mjekim i plagëve, imobilizim i frakturave, zëvendësim i gjakut të humbur, pasurimi i tij me serum e glukozë, ushqimi i kujdesshëm, qetësia dhe ciltërsia e Çiliana Surelit, ngjallën sërisht mallin dhe etjen pér jetën që ishte jashtë dritareve me hekura të asaj dere të madhe e të rëndë të verandës të cilën atë ditë e kish lënë të hapur hetuesi e mjeku. Goxha quell ishte para syve të Grigorit i ndriçuar nga drita e diellit dhe çuditërisht i mbushur me cicërima harabelash e dallëndyshesh të porsaardhura, të shqetësuara e gjithë gjallëri pér të ngritur e meremetuar sa më parë foletë e vjetra e të reja.

Qëkur e sollën nga spitali nuk e kishin ngarë, as nuk e kishin marrë në pyetje. Ngaqë s'mund të rrinte as në këmbë,

as në karrige e kishin vendosur sërish në arkivol. I fashuar kokë e këmbë, gjoks e shpatulla, arkivoli i rrinte aq puthitur sa ai e kishte zor të mbushte mushkëritë me frymë. Në hapësirën e madhe të derës hyri e doli një dallëndyshë e cila, me siguri, nga mungesa e gjatë do të kishte ngatëruar folënë, që duhej ta kishte diku aty afër, nën çatinë e tarracës së burgut. Syri i mirë i Grigorit pa majë cepit të dallëndyshës një fije bari. Dhe atë ditë që u nis nga fshati me torbën në krah dallëndyshet po kujdeseshin për foletë. Pra «s'paskan kaluar shumë ditë», tha me vete Grigori dhe u gëzua nga ky zbulim që i dhanë dallëndyshet dhe i etur s'ia ndau syrin asaj cope hapësire, asaj cope të madhe qelli gjithë frikë se pas një çasti, si të mbaronte së piri kafenë me konjak hetuesi dhe mjeku, ajo kanatë sa një katana, me ato dërrasa të trasha, të zeza e me ato xhamë të veshura nga zhuli, do të mbyllej përgjithmonë. Gëzimi dhe frika e hutuan Grigorin. Pa hequr syrin nga ajo copë qelli, që atë mëngjes i ngjante aq shumë qellit që ai njihte mbi fshatin e tij, kujtoi vëllanë e vogël, Sifin, atë ditë pas vdekjes së Stalinit, pasi dolën nga kisha, ku Sofua lexoi komunikatën.

E qara fshatçë filloj që në kishë si një sëmundje ngjitime. S'janë vetëm mikrobet ato që përhapin epidemitë, janë dhe lotët e atij që ke përballë, është dhe ngashërimi i burave që shirëngojnë nofullat e ndjellin me hundë lotët që të emocionojnë, të mallëngjejnë më shumë e të infektojnë më keq. Në qoftë se do të shikoje në atë çast fytyrat e fshatarëve do të bindeshe se po shikoje fytyrën e tërë fshatit të përlotur. Dhe Grigorit iu mbushën sytë me lot. Rrugës, duke u ndarë sipas rrugicave e shtigjeve të fshatit, Grigori u bashkua me dy vëllezërit. Të tre hynë pothuajse njëherësh në derën e madhe të shtëpisë që kishte mbetur e hapur si gjithë dyert e fshatit, sikur në të gjitha shtëpitë të kishte hyrë vdekja e sikur në çdo shtëpi do të gjeje Stalinin e vdekur, veshur me rrobat e gjeneralit, mbuluar me lulet e pranverës, me mollët e ftonjt të fshehura nga nikoqiret për një ditë të zezë ose të bardhë. E ëma i priste mbrapa derës së shtëpisë, në korridor, me dy duart në pëqi, siç i priste ajo gjithnjë kur ata, cilimi-qër, bënin zarare e zullume në fshat.

— E more, bukuroshër, paski njomur kalldrëmet e soka-kut me lot? Ju pa shoku Sofo që qatë, ju pa? Mirë. Shumë

mirë. Hajdeni t'ju bëj nëna nga një kafe ta pini pér shpirët të Stalinit.

— Dhe ti qave, nënë. Të pashë që qave kur dole nga kisha. Ç'ke që na nget? — i foli Dhosi.

— Qava burrin tim të zi, babanë tuaj, jo atë që i mori shpirtin xha Mitit, xha Lazes, xha Minait, Maqos e Lekës. Dhe juve do t'ua merrte jetën. Harruat nga sa vite i falët, ë? Nuk thoni shyqyr që vdiq e shpëtuat ju e tërë fshati i budallallepsur pas tij?

— Nënë, mbylle gojën, — thirri Sifi sytë e të cilit sa s'dualën nga vendi dhe po me atë inat mbylli derën sa gjëmoi shtëpia.

— Nuk e mbyll gojën se jam në shtëpinë time dhe ju jeni pjella ime.

— Po s'e mbylle të denoncova, — ulériu Sifi dhe iu hakërrye së émës.

— Çfarë the, more spurdhiak, ç'do të më bësh, ë?

— Do të të kallëzoj që ç'ke me të. Pak na i nxiu jetën ai xhaxha gomari që krisi e iku matanë kufirit, por na tani dhe ti, këtu brenda shtëpisë?

— Qen, — kërceu Marga plakë, që u drodh sikur e pickoi gjarpëri në gji. Zbértheu këmishën e zezë para gjoksit, nxorri gjinjtë e mëdhenj e të vyshkur, kapi thithin sikur do të hiqte helmin e gjarpërit dhe me buzët që vazhdonin t'i dri-dheshin mallkoi:

— Harram ky qumësht që të rriti. Të ishte yt atë gjallë do të ta këpuste kokën si të gjelit të zi. Unë jam nënë që mos qofsha, po pa të dënuar s'mund të rri. Na, merre këtë shuplakë e sikterisu nga shtëpia. Shko dhe lëpiku asaj kuçkës së Sofo Bregut, se ajo shtëpi të pëlqen ty.

Shuplaka kërciti e lëshoi shkëndija në sytë e Sifit, i cili sikur të mos kishte ndodhur gjë, ktheu faqen tjetër e duke pritur që e ëma ta qëllonte sërish i tha po me atë inat që e kishte kërcëuar.

— Po a e di ti moj fyckë, se po të jetë dëgjuar zëri tënd në rrugë sa jemi këtu na zenë pér bythe e na flakin an-dej nga Myzeqeja, na fusin në llucë të kënetave deri në fyt e na lenë aty derisa të na pijnë gjakun shushunjat e mushkonjat, ë? E di apo s'e di? Pse, moj, nuk e more vesh ti që bai me një këmbë në varr i fali ato ditë që i kishin mbetur pér ne dhe ne i falëm nga pesë e nga dhjetë vjet jetë pér

ty, që t'u nxi jeta e t'u tha pështyma në gojë, e për këto voci rrakët e vëllait që të mos shikohen me atë sy që po shikohemi ne, ë? Po a e di ti moj...

— Ore, Sifi! Sifi, ore! — pëshpëriti Grigori me lot në sy, por jo si ato lot që i dolën në kishë. Ishin të tjerë lot, sikur njeriu i shkretë të kishte dy apo tri lloj gjëndrrash lotësh. — Jo nëna që të ka bërë kokën, por as ne vëllezërit e tu s'po të njobhim. Ti sikur...

— Çfarë sikur, more! Lëri more sikuret. Nga frika thua j. Pse, ore, budalla jam unë?

Atë çast u hap dera. Të gjithë nuk guxuan të kthenin kokën e të shihnin se pas shpinës së tyre erdhi mortia, jo për të mbledhur vitet që i falën Stalinit, por për gjëmë më të madhe, llucën e kënetës sa të jetë jeta.

Margës iu shkrinë duart e ngrira dhe nisi të mbledhë sisët e mëdha e të vyshkura duke i ngjeshur nën bluzën e zezë dhe mezi vuri buzën në gaz.

— Ja, ky mëkatari i vogël ia dha të qarit e do sisat e mia budallai, — tha më të qeshur Marga dhe përkëdheli kokën e kolopucit te këmbët e saj.

— Leri, leri këto thiatro, Margë! Le t'i lutemi zotit që na shpëtuan çunat nga vdekja, se si kishte nisur ajo lubi, do na i hante të gjithë burrat e fshatit. Shyqyr, shyqyr zotit.

— Teto Frosa, — ngriti zërin Sifi, — në shtëpinë time nuk ka muhabete të tillë.

— Mirë, të keqen teto Frosa, mirë. Si të duash ti, o bir! Ja, ika fare. Veç uleni zërin. Dhe matanë, te Kondajt, plasi sherri. O zot ç'na ka gjetur. S'flet dot i ziu njeri as në shtëpi as në komshinj. Po ne të shkretët, denbabaden kështu e kemi pasur, të keqen e të mirën, të hidhurat e të emblat gjithnjë bashkë i kemi ndarë?!

Ikja e teto Frösës sikur solli paqe në shtëpi. Nëna lëviz dorën nga koka e kolopucit te koka e Sifit. Grigori, më i qetë e më i maturi e më i shkolluari në atë shtëpi, iu afrua të vëllait të vogël dhe e përqafroi me një mall e ndjenjë që nuk e kishte provuar kurrë.

— O zot, — tha Grigori, — pse duhet të ndodhin gjëra të tillë që të njobë vëllai vëllanë, ë? Po ne paskemi pasur një mendje, o Sifi! Dhe unë budallai të shikoja... të shikoja sikur ti, ti po kaloje matanë, te ata.

Sifi që vinte edhe më i vogël në trup se Grigori. Iu ngjesh të vëllait në gjoks, dhe aty ngashëreu në lot.

— Mjaft, — tha Dhosi, — mjaf!

— Leri, — tha Margo, — ata gjetën sërish njëri-tjetrin.

— E penduar që goditi Sifin me shuplakë u afrua dhe e puthi faqen ku akoma pëllëmba e saj skuqte si lulëkuqe.

Sifi u shkëput nga Grigori dhe ngjeshi kokën në gjinjtë e vyshkur të nënës. Ndolli hundët dhe e ndjeu erën e qumëshitit që kishte shteruar qëkur ai ishte fëmijë.

Ngrohtësinë, dashurinë, lumturinë familjare që i kishte mbledhur tok e shuk si delet gjithë pjestarët e familjes me nënët në mes e ngriu, e kallkanosi dhe e drithëroi një e trokitur në derë, një e trokitur e fortë si e një dore që s'ka ndrojtje të trokasë. Mullari i dashurisë u prish, u shpërnda. Secili zuri vend e pozicion sikur s'kishin të bënin me njëri-tjetrin, sikur s'kish dashuri e harmoni, por pikëllim. Asnjë regjizor dhe asnjë trupë teatri nga më e mira, me aktorë të zgjedhur nga gjithë bota, s'do ta kishin luajtur aq bukur, jo vetëm mizanskenën, por edhe mendimin se ata, në shpirt e në mendje kishin vetëm dhimbjen e vdekjes së Atij atje larg, në fushat pa fund e pa anë të Rusisë.

Dera u hap. Ishin gjithë njerëzit e krushkut të nuses së Dhosit, nëna e nuses, motrat me kalamaqër, kunetërit burra me mustaqe dhe dy dhëndurët.

— Moj, krushkë?! — tha nëna e nuses së Dhosit. — mos kemi hyrë gabim në një shtëpi tjetër që mban akoma zinë e Atij atje larg?

— Qoftëlargut, thuaj, — ngriti zërin Marga. — S'dimë ç'të bëjmë, moj! S'dimë ç'fytyrë t'i japim surratit, moj! Në ngriu gjaku kur trokitët në portë. O zot! Ejani, ejani si në shtëpinë tuaj.

— Epo nuk e mbanim dot për vete gjëzimin, moj krushkë, e thamë të gézohemi bashkarisht se jemi një e këta djem e dhëndurë të na rrojnë aq sa ua ka caktuar i madhi zot. Shpëtuam, moj krushkë, shpëtuam! Thonë poshtë e lart, e nëpër mbledhje e gazeta se s'ka zot. Ja ku doli zoti.

— Doli, moj, doli, po mos ratë gjë në sy rrugës kështu tufë si jeni? — tha me frikë Marga.

— S'e vramë aq shumë mendjen, — tha vëllai i madh i nuses së Dhosit.

— Ta kishin vrarë një çikë, — pëshpëriti pa guxim Sifi, si i trembur që po fliste para dy vëllezërve më të mëdhenj.

— Gjithë fshati po lëviz. Gjithë rrugët plot janë si të jetë nata e Pashkës së Madhe. Veç qirinj s'kishin në duar. Dhe ne thamë, ku të vemi e të gëzohemi sonte? Xha Miti, ndjesë pastë, qe i pari që vdiq për shkak të Atij atje larg. Dhe tre djemtë e tu, moj Margë, dhe të mijt, dhe dhëndurët. Dhe erdhëm për nder të xha Mitit dhe për t'u gëzuar bashkë.

— Hajt, mblidhni veten, — i thirri ajo çunave, nuses e fëmijëve, — gëzuar qofshi e përherë bashkë.

Hapi krahët e dy krushkat u përqafuan si çdo vit, kur ngjalje zoti Krisht, kur dy këmbanat e fshatit gjëmonin e këndonin si në garë se kush do të gëzonë më shumë.

— Nxirru raki nga qilari, Grigor! — u dëgjua zëri urdhërues i nënë Margës, — dhe atë delen tënde, atë Bardhishkën e Dhoksisë, më duket se e ke në kasolle? Sikur ia ke bërrë benë që t'ia çosh lëkurën tyt vjehrri, apo jo?

Grigori u skuq deri te veshët dhe mezi foli.

— Pse i nxjerr sekretet, moj nënë, prit një herë, po që se sonte duhet bërë kurban gjej një dele tjetër.

— Atë, atë të Dhoksisë.

— Po lëkurën?

— Çoja nesër. Ata presin.

— Çfarë flet, nënë?

— E qërova atë hesap. Ata të presin të çosh lëkurën. Dhe i ati dhe ajo.

— Dale, dale, — ngriti zërin i gëzuar Sifi, — s'paskam genë vetëm unë me dy fytyra në këtë shtëpi.

— Pusho, o budalla, — e qortoi e ëma, — po s'të liroi rrugë ky, s'të vjen radha ty. Hajt, luaji këmbët dhe ndihmo tët vëlla se mos i dridhet dora kur ta rrjepë delen dhe i prish lëkurën e na prishet krushqia e re. Cili baba i jep vajzën një burri që s'di të rrjepë një dele?

Në hajat plasi e qeshura. Qeshën dhe kalamanjtë me xhaxhi Grigorin që u hutua e u turpërua si një çupë..

— Hapi sytë, hapi, — dëgjoi Grigori zërin e njohur të hetuesit që e shkëputi nga ai kujtim aq i largët sikur t'i përkiste një tjetri.

Syri pa derën e madhe të verandës që po mbyllej për të mos u hapur kurrë më.

— E, si thua. Tani u bëre më mirë, apo jo? Erdhe dhe në vete. Pe dhe një copë qiell, pe dhe dallëndyshet. Po në fshatin tënd, kur u nise me atë torbën me magjinë që e hodhe në ambasadën sovjetike, kishin ardhur dallëndyshet, ë?

— Po, — tha Grigori duke u munduar të ishte i qetë para xhelatit të tij dhe atij mjekut që i mbeti te koka ndaj të cilit nuk dinte se ç'qëndrim të mbante.

Doktor Sherif Merzhani i buzëqeshi.

— Ja kështu ka lezet, — tha i kënaqur hetuesi dhe zgjati dorën ta përkëdhelte me atë cinizmin e mërinë e tij, të cilën nuk dinte se si ta fshihte. Dora e zgjatur u drodh. Grigori i fashuar s'kishte as faqe, as flokë, as gjëra të zbuluar nga trupi i tij për t'u përkëdhelur.

— E, si thua? Ke qejf të kthehet shëndoshë e mirë në fshatin tënd apo të fillojmë nga e para, i thyejmë edhe njëherë një e nga një kockat që të ngjitëm, ë? Ja dhe syri t'u kthjellua. S'ke si i bën më bisht muhabetit. Dhe unë s'do të të ngas fare. S'do të kërkoj asgjë, as kush ta dha magjinë, as kush të tha hidhe në ambasadën sovjetike. Dua vetëm emrin e fshatit tënd. Ta thuash atë s'është as tradhti, as poshtërsi. Askush s'ka të drejtë të të thotë një fjalë. Të kapën duke hedhur torbën te dera e ambasadës, apo jo? Të pyetëm se si të quajnë dhe ti the Grigor, kështu, ë? Hëngre kot, për fajin tënd, gjithë ato tortura sa s'vdiqe. Ja, ky të shpëtoi. E shikon? Tani mos u bëj budalla. Vdekjen e pe me sytë e tu apo jo? Ja, prapë në arkivol je, se s'kemi mbaruar punë. Zgjidh e merr. Do të rrish aty ku je apo do të vesh prapë në spital derisa të shërohesh fare. Po të flas sikur je kalama se nuk di si të sillem me ty. Ç'të kushton të thuash vetëm emrin e fshatit?

— Nuk e them, — lëvizi buzët gjithë mundim Grigori dhe priti të ndodhët gjëma, të rithyhesin sërisht të gjitha kockat, të binte një térmët e ta zinte të gjallë e të vithisej me gjithë burg, megjithë Tiranë, Durrës, Krujë dhe Elbasan. Ujë i zi të dilte.

Por nuk ndodhi asgjë. Veç ata të dy u panë sy më sy.

— Ky është kafshë, o doktor Sherif Merzhan. Dhe ti e ke kot që përpinqesh të sajosh metoda e stërmëtoda. O merre ti përsipër këtë proces, o lemë të bëj atë që më ka mbetur pér të bërë.

— S'ke ç'bën më, — tha i hutuar Sherif Merzhan. — këtë e kanë blinduar me fasha e allçi.

— Të thashë, kanë lënë koqet jashtë, — u përgjigj dhe pa pritur përgjigje futi duart në arkivol, rrëmbeu njëren këmbë, ia kapi duke ia nxjerrë nga arkivoli, pastaj dhe tjetren, gati sa nuk i çaploj dhe i zbuloi organet e burrit.

Të gjithë veprimet u shoqëruan me britma e ulërima të Grigorit sa gjëmoi burgu, sikur të kishte rënë vërtet tërmet.

— Mirë, mirë. Ke pér të ulëritur kur të të tredh. Ato janë dhimbje e jo këto të kockave e të kërceve, — ngriti zërin hetuesi, megjithëse nga eksperiencia e tij e dinte se në dhimbje të forta njeriu nuk dëgjon se ç'i thua.

Hetuesi priti duke marrë frymë me flegrat e hundës. Duart i dridheshin, ngaqë nuk i pritej sa të fillonte torturën e re.

— Ke parë se si tridhen derrat dhe cjeptë? Ashtu do të të tredh. Ti doktor do të më ndihmosh?

— Jo, — tha prerë Sherif Merzhan.

— Po ti the se nuk ke parë se si tridhen burrat?

— As kam parë e as kam pér të parë, — tha doktor Shërifi dhe u largua.

— Hamdi! — ulëriti hetuesi.

— Urdhëro, shef, — tha Hamdiu që siç dukej rrinte në gadishmëri pas derës së vogël.

— Sill ç'duhet pér të tredhur këtë cjanin dhe mbaji veshët pipëz kur të flasë.

— Si urdhëron, shef, — tha dhe doli po nga ajo derë e vogël misterioze.

Kur hyri Hamdiu Grigorit i kishte rënë të fikët nga rithyerja e kockave që nuk ishin ngjitur akoma me njëra-tjetërën.

— Shko thirr doktorin, — foli hetuesi.

— Si urdhëron, shef, — tha Hamdiu.

Doktori i ndenji gjatë te kryet Grigorit. I mati pulsin, pastaj i hapi syrin e mirë. Gjatë kohës që po e këqyrte mjeku, hetuesi i lidhi më spango njëren nga bolet. Pa u bërë merak

se ç'do tē thoshte mjeku, tē cilin e kishte thirrur pēr t'iū gjen-dur tē pandehurit te koka, tha si pa tē keq.

— Do ia tredh njérën njéherë, pastaj tjetrën. S'besoj se do tē rezistojë. Do habitesh kur tē flasë.

— Ashtu qoftë, po kam frikë se...

— Se mos vdesë? — ngriti zérin hetuesi. — Po vdiq, ti do tē bësh raportin.

— Unë nuk e kam tē vështirë tē firmos një copë letër e tē vërtetoj se nga ç'sëmundje vdiq ky.

— Po mos harro se ti ke marrë urdhër që ky tē mos vdesë pa folur.

— Ashtu është po ti... ti...

— Unë kam marrë urdhër që ta detyroj tē flasë. Pra unë do tē bëj timen, ti tënden. Hamdi, gati!

— Gati, shef. Urdhër pres.

— Atëherë fillojmë.

— Prit, prit! Prit tē vijë në vete. S'ka kuptim tē harxhosh torturën kot. Aq më tepër që ti ke aq besim te kjo torturë. — foli mjeku i trembur pēr tē parën herë në jetën e tij aty në dhomén e torturave.

— Prit, o Hamdi, — tha i qetë dhe i kënaqur hetuesi, prit urdhërin e doktorit.

Doktor Sherif Merzhani si mjek specialist, gjithnjë e kishte justifikuar veten në raste tē tilla që ai, në fund tē fundit, asistonte aty si njeri human. Dhe studimi i tij, nisi kombinimin e torturave e justifikonte si një ndihmë, si një lehtësim në këtë proces përdhunimi. Ai nuk kishte pasur asnjë konflikt me hetuesit që i kishte sjellë rasti tē punonit. Dhe ata, me sjellien e qëndrimin e tyre, nuk i kishin lënë tē nën-kuptonte se ishte bashkëpunëtor me ta. Kur dilte nga burgu, kthente te bufeja e Malos, në bërryl tē rrugë, pinte një teke konjak, një kafe me cigare, dhe kur hynte në rrugën e madhe e tē gjerë, tē mbushur me kalimtarë, e ndjente veten si gjithë kalimtarët. Në shtëpi kishte tē vështirë vetëm një qast, kur e shoqja Bukuria, i shtronnte tavolinën dhe ashtu, si pēr muhabet, e pyeste se c'béri sot, ku e kaloi ditën në spitalin psikiatrik, apo në spitalin e burgut? Atë çast, nëse gojën e kishte plot, e kalonte me një tē lëvizur tē kokës që donte tē thoshte se kishte qenë edhe atje, edhe atje; në rast se goja ishte bosh, thoshte dy-tri fjalë, ose tregonte gjatë bukës ndonjë gjë që i kishte bërë përshtypje, por gjithnjë pa ndier e pa provuar

kurrë ndjenjën e përgjegjësisë qytetare. As ai vetë, as e shoqja nuk e kuptonin se rast pas rasti, ndodhi pas ndodhije, qëndrimi i tij vetëm si mjek po rëndohej. Ai po hynte e po thellohej në rrugën e krimit, duke firmosur raporte plagësh, dhe vëçkje të cilat i justifikonte me diagnoza të sakta. Vetëm e bija. një ditë, duke ngrënë darkë, tha ashtu si kot:

— O ba, po ti pse ngatërrohesh me këto punëra. Ç'të duhet spitali i burgut?

— Po dikush do të vejë dhe atje, se edhe atje të pandehurit, të burgosurit kanë nevojë të kenë një mjek.

— Mirë, o ba, mirë. Ti e di vetë. Mua se si më vjen, — u justifikua vajza.

— Po hë, thuaje, si të vjen?

— Aman dhe ti burrë. Dhe tët bijë kërkon të zhibirosh. S'ke qenë i tillë më parë. Dhe kur vijnë kushërinj e mysafirë ti silesht me ta... si të them... sikur do të zbulosh ndonjë gjë.

— Ajo është profesionale, mama.

— Po ç'ke atëherë që e ngjet tët atë?

— Muhabet po bëjmë, moj ma!

— S'ka gjë, moj grua, s'ka gjë, — e qetësoi Sherifi, por ama atë ditë që u hap kjo bisedë oreksi i iku. Ai piu gjysmën e gojës së verës që i kishte mbetur dhe u ngrit nga tavolina e u mbylli në studion e tij. Atë që ndjeu atë ditë kur nuk e vlerësoi shqetësimin e së bijës, e ndjeu tani, para këtij njeriu allçi. me ato dy këmbë të nxjerra jashtë arkivolit, me testikulet të lidhura me spango. Pritej vetëm urdhëri i tij që të bënej sterilizimi, ashtu, me atë metodën aq barbare e mesjetare që nuk u bëhet as kafshëve. Si arriti ai deri aty? Ai, mjeku human, një nga specialistët më të mirë që prezentonte se njihte misteret e trurit? Ç'forcë e padukshme dhe e pandiqeshme e kishte shtyrë atë deri në atë shkallë?

Doktor Sherif Merzhanji ndjeu t'i dridhej qerpiku i syrit. Para disa vitesh, kur i kishte ndodhur një rast i përafërt, pasi kishte dalë nga spitali burg, kishte vajtur i dehur në shtëpi, i shogëruar nga Malua, bufetjeri i klubit. Të nesërmën, kur e thirrën që të dukej pasdite nga burgu pér një rast urgjent, ai refuzoi. Po atë pasdite e thirrën në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe e këshilluan që proqka të tilla të mos bënte më. «Ne të xemi njeri të besuar, të ndershëm dhe ti, me atë eksperiencë që ke, duhet të na ndihmosh, apo jo? Ti je mjek, je njeri human, sigurisht aty ke të bësh me lloj-lloj njerëzish që

nuk e duan pushtetin popullor, partinë, popullin. Ti shikon e dëgjon shumë gjëra, të cilat s'duhet t'i zësh me gojë poshtë e lart». «S'kam folur gjë», — kundërshtoi Sherifi. «S'e kam aty fjalën, s'po të akuzoj, po të këshilloj të jesh më i kujdes- shëm».

Muajt dhe vitet kalonin dhe ai u bë njeriu më i rëndë- sishëm në proceset speciale të hetimeve me rëndësi kombëtare, por që do të arrinte deri këtu, sa hetuesi të priste mendimin e tij pér të vazhduar torturat, nuk e imagjinonte dot.

«*Si erdhi kjo ditë, ë?*» — pyeti ai veten duke parë nje- riun e fashuar e të shtrirë në arkivol.

— Hë, mor doktor, se na mbeti me shalë hapur ky, sikur do të na pjellë një këlysh prej allcije, — u tall hetuesi, — do japësh urdhër, apo jo?

Ishte vonë, shumë vonë, që doktor Sherif Merzhani të lante duart si Pilati dhe të qetësonte ndërgjegjen e tij. Rru- ga në të cilën ai qe zhytur gradualisht, s'kishte më as edhe një kthesë. Ai, shërbëtori i diktaturës, ishte njëkohësisht dhe një diktaior.

Doktor Sherif Merzhani u tmerrua kur e pa veten diktator. A nuk ishte ai që do të diktonte atë çast vdekjen e një farë Grigori pa asnjë identitet, pa emër babe e nëne dhe pa vend- lindje?

— Bëj ç'të duash, o Ridvan Geseri. Ky s'bëhet më i gja- llë. Këtë njeri ne e vramë. Ti dhe unë, unë dhe ti.

— Po tani, tani a është gjallë? — pyeti hetuesi.

— Hë pér hë, po. Po... pak më vonë...

— Domethënë kemi akoma shpresë të mësojmë atë që duhet; atëherë Hamdi, shpejt, fillojmë, — tha i mërzitur hetu- esi. Hamdiu filloi nga puna.

Britma e Grigorit krisi xhamin e drithares.

— Fol, bir bushtre si quhet fshati. Dhe mos harro se ke dhe një bole tjetër, ë?

— Fshati... fshati... im, o i ziu fshati im! — belbëzoi Grigori.

— Mos i qaj hallin fshatit, derr! Qaj hallin tënd. Si quhet, ë? Dhe do shpëtosh. Ja, doktorin e ke te koka. Fol, fol, — ulëriu hetuesi.

Doktori u përkul mbi ballin e Grigorit, sytë e të cilit kishin kërcyer jashtë zgavrave dhe ishin bërë vëngëroshe.

— Hamdi, fillo me bolen tjetër, ky qenka vërtet derr e shkuar derrit, — tha hetuesi.

— Frit, — tha mjeku.

— Vërtet, mirë e ka doktori. Të presim, është guri i fundit.

Fashat e këmbës së djathëtë, e anuar jashtë arkivolit filian të skuqen nga gjaku, të njomen e të pikojnë pik-pik.

Mjeku ia ngriti më kujdes. Duart e tij ndjenë se sì kërcitën edhe njëherë kockat dhe ai, me ato duart që i dridheshin, e vendosi në arkivol. Të njëjtën gjë bëri instinktivisht edhe Hamdi cë ndodhej në krahun tjetër.

Eashkimi i dy këmbëve i shkaktuan përsëri dhimbje të forta Grigorit, dhimbje që s'i duron dot asnje burrë.

— Bravo, doktor. Tani më pëlqeve. I zgjuar je, për besë. I shkaktove dhimbje duke u kujdesur.

— Nuk e bëra për t'i shkaktuar dhimbje. Atij po i kullon gjaku, nuk e shikon? Dhe mund të vdesë nga hemoragjia.

— Hë për hë nuk na intereson vdekja e tij. Ti duhet të bësh pa jetëtë diçka. Se çfarë, atë e di ti.

Mjeku, që ishte skuqur deri te veshët kur hetuesi i tha: «Bravo, doktor, tani më pëlqeve», e mblođhi veten.

Cëmund të bënte për këtë Grigor që kishte lejuar ashtu si me dashje, si pa dashje, si duke kryer detyrën, si duke negliguar, herë duke ndjerë përgjegjësi e herë duke justifikuar veten? T'i ndërpriste hemoragjinë me kuagulant ose me rimobilizimin e frakturës, e cila, duke u rithyer do të kishte këputur ndonjë enë gjaku? Apo t'ia lidhë fort këmbën që të ndërpriste mekanikish hemoragjinë derisa hetuesi të kryente detyrën? S'kishte rrugë tjetër.

Apo kishte, por truri i tij i bllokuar s'donte të mendonte më?

— Një gotë ujë, Hamdi, — pëshpëriti mjeku dhe duke pirë u mundua të gjejë zgjidhjen më fatlumë për Grigorin, i cili, ashtu siç qe katandisur, s'do kishte mundësi të dilte gjallë nga ajo dhomë torturash.

— Të le të vdesë. Sa më parë aq më mirë për të. C'do të bëjë ky njeri me gjithë ato fraktura me një mëlçi, veshkë e shprethë të dërmuar, me atë tronditje aq të thellë të sistemit nervor dhe i tredhur? Do të jetë një zvarranik që do ta kërkojë cdo ditë vdekjen».

— Doktor, arkivoli po mbushet me gjak, — tha prerë e

gjithë mllif hetuesi i habitur që mjeku vazhdonte të pinte ujë gllënjkë-gllënjkë.

— Ka pér tu mpiksur vvetetiu, — u mundua të fliste i qetë doktori, — veç nuk duhet t'i shkaktojmë as edhe një dhimbje tjetër.

— Ta le të qetë? Tani? — u habit hetuesi.

— Nëse do që të mos vdesë, — iu përgjigj mjeku si me përtesë e bezdi, sepse atë çast po mendohej se c'diagnozë t'i vinte vdekjes së pacientit pas një ore. «Të paktën orën e fundit të jetës të mos vuajë», — tha me vete mjeku dhe nisi të thyejë njëra pas tjetrës dy ampula morfine duke bërë kujdes të thithë me pistonin e shiringës edhe pikén e fundit të solucionit. «Po në qoftë se shpëton? Nëse shpëton do të thotë se ka zot e ky është një çudi».

— C'po bën? — pyeti hestuei.

— Një koagulant, — u përgjigj pa të keq mjeku dhe duke parë me bisht të syrit ampulat e thyera të koagulantëve që kishte bërë para se ta çonin në burgun e spitalit vendosi që, kur të mos e kishte mendjen aty as hetuesi e as Hamdiu, të zhdukte dy ampulat bosh të morfinës.

Duke bërë morfinën iu duk sikur pa sytë e habitur të së bijës me një buzëqeshje prej çapkëneje, që zë tjetrin në faj po qe se s'do ta dënojë se i dhimbset.

«— E babi, paske filluar të bësh punën e infermierit apo ky injektion hyn në ato sekretet profesionale, ë?»

«— Si të ta them, moj bijë?!»

«— Ashtu siç është, baba. Apo njeriu s'bën të thotë kurrë atë që është, ashtu si është, ë?»

«— Kam frikë se s'do më kuptosh, moj bijë?»

«— S'ka gajle. Po s'e kuptova sot, do ta kuptoj nesër, kur të rritem, mbapse deri atëherë ti s'do të jesh më, po unë ama do të di të mbroj, ose të hesht, ose...»

«— Në shtëpi, në shtëpi do bisedojmë. Ik tani, hiqi ata sy».

Shpëtoi vërtet nga sytë e së bijës, por u mbérthye nga sytë e çakërdisur të Grigorit, nga të dy sytë dhe i miri dhe i keqi, që pér çudi, me një dëshirë të zjarrtë pér të komunikuar, pér të folur, pér të thënë diçka. Mbapse kishte vendosur të thoshte c'ikë kërkohet,

— Ky sikur kërkon të flasë, — pëshpëriti hetuesi.

— Edhe mua ashtu më duket, — tha mjeku, — ja, po lëviz dhe buzët.

— Ky po falet. Po falet dhe po qan, — tha Hamdiu, — ja kuptoj fjalët që thotë nga lëvizjet e buzëve, ja, shikoni, Nuk thotë o Zot? E kam vënë re dhe te shumë të burgosur të tjerë që kemi torturuar.

10

Grigori dëgjoi sërish këmbanën e madhe të Kishës së fshatit që ra pér vdekje. Ishte e treta vdekje atë ditë. Kur dëgjoi këmbanën e parë, ai la rrëzën e malit dhe zbriti mbi fshat; te çuka e Gegës. Kur ra këmbana e dytë la dhe çukën e Gegës dhe iu afrua dy lisave të kodra e Arapit. Aty e zu këmbana e tretë. Si i ndjellë prej vdekjes shtyu dhentë edhe më po-shtë e qëndroi në të hyrë të fshatit dhe aty, para dhenve, bëri kryq pér të përzënë frikën dhe mbajti veshët pipëz se mos dikush i lëshonte zë nga fshati dhe ai do dëgjonte gjëmën e cila mund të kishte goditur shtëpinë e tij. Këmbana e tretë e asaj dite, lajmëronte vdekjen e shtatë pas vdekjes së Stalinit. Grigorit iu drodh trupi. Ai s'do të quditet fare nëse këmbana tjetër e vdekjes do të binte pér të. Nuk mund të qëndronte dot më aty ku ishte, nuk mund ta shikonte dot me sy fshatin që e kishte në pëllëmbë të dorës. Ai vuri re së lartimi, aty ku ishte, se si njerëzit nisën t'i afrohen shtëpisë së xha Minait, krushkut dhe sikur i ngriu krraba në dorë. Sytë e tij të mëdhenj, faqet e hequra e të zbehta, mollëzat pak të dala, fytyra e pagjumë me atë mjekër të parruar qysh nga vdekja e të jatit, pikëllimi që i kishin ngjallur në shpirt tri këmbanat e vdekjes i kishin dhënë Grigorit një pamje prej shenjtori që vuan, por që s'kishte fuqi të ndalonte mortjen, e cila shëtiste si i donte qejfi nëpér çatitë e shtëpive si një maçok plak i zi, i fuqishëm e që s'ia bënte syri tërr as nga fëmijët që e godisnin me gurë, as nga plakat nëpér oborre me kopaje në duar.

— Yyy, ju preftë gojëkyçuri, — troi dhentë dhe i goditi me krrabën kur ndjeu se si iu shkrinë duart e ngrira. Kishte goditur Bardhishkën e Dhoksisë, e cila s'po bëhej e gjallë të vinte ta merrte, mbase e trembur dhe ajo nga këmbanat e vdekjes që çdo ditë dëgjoheshin deri në fshatin e saj.

Marga plakë u habit kur pa Grigorin me krrabë në dorë te dera e hapur e oborri: që rrinte si një ikonë me sy të mëdhenj gjithë dritë e dhimbje, me fytyrën aq të tretur që dukej sikur pikonte helm e dyllë të tretur. Era e detit të largët lëvizte degët e njoma të thanës me gjethë e lule, lëkundte majën e selvisë tej pragut të derës, i bënte të fëshférin e gjethet e reja e burbuqet e paçelura të dorzonjës që pështetej mbi çatinë e vogël të strehës së portës, po, për çudi, nuk u frynte fare flokëve të gjata të Grigorit, aty në prag të derës. E éma u tremb. Mos vallë ajo që po i shikonin sytë ishte vërtetë një ikonë e madhe, sa i biri më këmbë, dhe dera e madhe një kornizë e zbkuruar me lule thane, dorëzonje e degë selvish? Po pse ato lëviznin e luanin me erën kurse flokët e të birit jo?!

— Grigor bir, ti je apo më bëjnë sytë?

— Unë nënë, — tha i trembur Grigori nga zëri i së ëmës dhe që të bindej ajo se ishte vërtet ai, biri i saj, e jo ndonjë fanepsie, ngriti lart krrabën që mbante me dorën e majtë, drejt qiellit, pastaj dorën e djathtë sikur bekoi nënën dhe u sul drejt saj.

— O zot, qenke vërtet ti, — pëshpëriti Marga gati me të qarë dhe ndukte me duart shpatullat e të birit që të bindej se prekte mish e kocka njeriu e jo hije e fanepsje ashtu siç e patë dera.

Gishterinxh e nënës u futën si krehër në flokët e gjatë të Grigorit.

— Ç'ke me flokët, nënë?

— Se si m'u dukën atje te dera.

— Si, — pyeti Grigori dhe iu mbush shpirti me mall, dashuri, dhimbje, lot e brengë për nënën. Ou, s'mbahej mend prej sa e sa vitesh, që kur ishte i vogël, që s'pati ndjerë atë që po ndjente tani i përqafuar nga e éma.

Të dy, aty në oborr, midis dy dyerve, s'po shuanin dot mallin e brengën për njëri-tjetrin, sikur të kishin vite pa u parë, që atëherë kur ai ishte i vogël e ajo e re, ose sikur nesër s'do të shiheshin më kurrë.

Dy vëllezërit, Dhosi e Josifi, nuk u habitën kur panë nënë Margën e Grigorin të hynin ashtu të përqafuar. Dhe ata të dy ajo ashtu i kishte futur në dhomë. Dhe ja tani, asaj nuk i erди zor të qajë. Të tre vëllezërit u habitën. Ata nuk e kishin parë të ligështohej ashtu nëna e tyre. Për ata që shtylla e shtëpisë, e papërkulura, burrnesha e tërë fisit të Kurtezëve.

Ajo mbillte e korerte, ajo kujdesej pér bahçen, pér pemiet, pér rrushin. ajo milte dhentë e dhitë kur i kishin tē tyret, ajo zjente dhe rakinë. Ajo pinte dhe duhan. Dhe fjala e saj, ndonëse grua, peshonte si fjala e burrit, pa e vënë kurrë veten mbi burrat.

— Ikni, — mezi foli Marga, — ikni ku tē doni, veç ikni. S'dua t'ju varros me duart e mia. S'dua t'ju shikoj kur t'ju varros me duart e mia. S'dua t'ju shikoj kur t'ju kalbin nē dhe. Eshtë bérë një gabim. Zoti që eshtë atje lart, na dëgjoi keq atë ditë, atje nē kishë, ose, nē gjynah mos hyfshim, zoti nuq e ka marrë vesh akoma që Stalin ka vdekur dhe po ju merr njëri pas tjetrit, ose eshtë zemëruar me ne që futëm hundët nē punët e tij dhe tani bën sikur nuk shikon e po ju le tē vdisni me radhë e pa radhë. Hajde, lëvizni, bëni torbat gati dhe nisuni.

— S'kemi ku vemi, nënë, — foli Dhosi, si më i madhi i djemve.

— Ku tē doni, veç ikni nga ky fshat i mallkuar. Vdekjen e keni mbi kokë. Mbase atje ku do shkon, s'ju gjen dot mortja. Zbrisni nē qytet, ose dilni fshatrave. Hypni nē atë trenin e zhdukuni. As letra mos më shkruani.

Grigori qeshi hidhur si gjynahqar dhe pa me keqardhje nënë.

— C'farë ke që zgërdhijesh? — pyeti Marga duke parë me inat Grigorin.

— Që tē ikësh si thua ti nënë, duhet një vandak me letra e shkresa, jo shpërngulje nga fshati me miratim tē kryesisë së kooperativës, pa duhet aprovimi i këshillit tē lokalitetit, pastaj i komitetit ekzekutiv tē qytetit, pastaj atje ku do tē vemi duhet aprovim prapë nga rrethi apo qyteti, pa duhet bërë dhe pashportizimi, a hu, he! Punë që s'bëhet dot, moj nënë. S'jemi tē lirë tē shkojmë ku tē duam. Këtu kemi lindur e këtu po vdesim.

— Dale, dale, mos ma prish mendjen mua me shkresa e vendime.

— Po kështu janë rregullat, moj nënë.

— Jo tē keqen nëna, jo. Rregullat u shkelën, u prishën. Ju falët jetët që tē rronte ai. Ai vdiq e s'ka pse tē vdisni ju njëri pas tjetrit si pulat kur u bie flama. Si ore tē shikoj unë si vdiqni ju. Jo, o zot! Jo, o Krisht, o perëndi! Në djall tē venë rregullat? Një copë jete tē tijën ka njeriu, jetë qeni vërtet,

por ana, tē rrojmë aq sa kemi ymrin, s'po kérkoj që tē rroni si zotérinj se nuk e patém atë fat, po jo dhe kështu, me barkun bosh e me frikë në zemër. Atéherë ikni matanë, hajdeni, luanë se po erret. Tē paktën t'ju zërë nata afër pérroit.

— Pér ku po na syrgynos, nënë? — thirri i trembur Dhos-i.

— Matanë kufirit, ku? Bota është e madhe, s'u gjendka një vrimë pér ju?

— Nëna paska lajthitur, — foli Sifi duke parë me çudi dhe frikë sa nënën aq dhe vëllezërit.

— Nuk kam lajthitur, o bir, jo. Keni lajthitur ju. Burra jeni ju apo mut?

S'fit i ngriu fjala në grykë, e megjithëse u përcoll, pështirosi fytyrën e mezi foli:

— Kufiri është me tela me gjemba, me korent, dhe tē pret plumbi. E di ti se q'është kufiri?

— Po, po. Po tē ecësh si i dhjerë, me mut në shalë s'kapërcen dot as pragun e derës. Tē zuri plumbi, hallall e paç. Po këtu, s'e ke vdekjen tē sigurtë?

Nga dera e hapur hynë tingujt e këmbanës së vdekjes dhe nënë Zara, e cila i ra në krah nënë Margës.

— M'u mbyll dera, Margë. Më vdiq djali, moj! Atë kishim nishan. Ai do mbante gjallë fisin e Gjikajve. O Sotir, o bir! — thirri plaka e nisi tē qjerrë fytyrën.

Pér çudi Marga nuk ia mbajti duart Zarës. As gjakun e faqeve tē qjerra nuk e thithi me shaminë e kokës. E la tē rridhte, e la që ta shikonin tē gjithë.

— Më ndih, moj Margë, tē shpëtoj nga turpi, — e mblo-dhi veten Zara dhe ia nguli sytë Grigorit. Grigori u zbeh.

— C'ma shikon ashtu djalin? — tha gjithë frikë Marga.

— Më shpëto nga turpi, moj kushërirë, — përsëriti dhe sërisht i shkoi thonjtë faqeve e mbushi gushën me gjak.

— Mblidh mendjen, moj korbë!

— S'kam si e mbledh, po s'më dhe rrobat e Grigorit. Ato janë vërsnikë, kanë një trup. Dhe kushërinj dhe shokë janë.

Margë iu mbush mendja top se Zara kishte ikur, nuk i kishte më mendt e veta. E shtrëngoi në gji, ia hoqi duart nga fytyra, ia piu gjakun me shaminë e zezë tē kokës dhe i kérkoj Grigorit tē sillte pak raki.

— Jo raki, tē keqen. Rrobat dua dhe ika, dhe mos më shikoni kështu. E keqja s'paska tē sosur. S'ka më keq kur tē vdes

djali e të mbyll shtëpinë e fisin, po jo si i ndodhi atij. Ç'është ky mallkim, moj korbë! E kisha djalin si mollë në degë, moj korbë, — nisi të qajë e të tregojë Zara. — Erdhi ai, qoftë largu në shtëpi, moj korbë, Sofo lugati, që mos qoftë dhe i tha djalit të niset për në qytet, se paska një mbledhje në komitet të rinisë. Djalit i dhimbte barku. Kishte dy ditë, me nder jush që s'dilte jashtë. Dhe balli i digjte dhe duart i digjin e i kishte si të lagura. I them kështu e ashtu Sofos dhe e ftoj të hyjë brenda që ta shohë me sytë e vet, po ai qeshi e tha që iu thaftë gjuha. «Hajt, hajt, se i ri është ai. Po s'punoi tani për vendin, kur do të punojë? Dhe im bir, u nis, moj, si të ishte ushtar, pa bërë gëk e mëk. U nis me këmbët që s'e mbanin, moj. U nis drejt vdekjes ditëziu dhe atje vdiq. Thannë se iu ngatërruan zorrët e barkut, iu lidhën nyje si me magji, moj! Si u lidhkan vetë zorrët, një zot e di. Më mirë të kisha hapur varrin tim me duart e mia, sesa hapa arkivolin kurma sollën. Doja ta shikoja, të bindesha. Si s'mu qërruan sytë, si s'më iku mendja. Ai, ndonëse i vdekur, kishte vjellë apo ishte troshitur rrugës dhe që mbushur i téri me pisllék sikur, para se të vdiste, të kishte pas rënë në hale. I sikterisa të gjithë njerëzit, e zhvesha, e lava me këto duar po tani, tani s'kam me ç'ta vesh. Dhe arkivolin e lava, e shpëlava dhe e kam nxjerrë në diell që të thahet.

— Dhe je gjallë, moj e zezë, — psherëtiu Marga, ngriti kokën, kërkoi me sy Grigorin dhe nuk u habit që ai rrinte në këmbë si qiri pashke, po që në vend të dyllit, pikonte lot dhe në vend të flakëve digjeshin sytë e tij, — i solle, bir!

Grigori nuk pati fuqi të fliste. I ngrirë si qiri ai mund të lëvizte vetëm duart dhe ia vuri në pëqi nënë Zarës. Nusja e Dhosit i zgjati tabakanë ku avullonte një kafe, e rrinte e heshtur një gotë raki, si të që mbushur me lot.

— Pi që të mbledhësh zemrën, — foli nusja e Dhosit.

— Ment, o zot, ment! Sa ta vesh, — tha Zara dhe sikur të ishte magjepsur nga zëri i nuses, u bind. E piu, u ngrit e doli çalë-çalë e kërrusur nga pleqëria dhe vdekja e papritur e të birit.

— Prit, moj motër, të vdekurin nuk e vesh dot vetëm, — tha Marga, dhe u nis pas Zarës. Aty ktheu kokën dhe u foli djemve. — Lëvizni, të varrosim Sotirin dhe të mos ju shoh më në këtë vend të mallkuar. Ç'doni më?

Tre vëllezërit dolën si të magjepsur pas nënës. Nëna

pas Zares. Dhe në rrugët e fshatit njerëzit ishin vënë njëri pas tjetrit dhe ecnin kuturu, si të goditur në kokë. Hynin e dilnin nga një i vdekur te tjetri pa ditur se kush duhej ngushëlluar: të vdekurit që dukej sikur flinin, apo njëri-tjetrin që kishin mbetur gjallë? Më në fund râ nata dhe gjithë fshati qe mbledhur në shtëpitë, ku preheshin të vdekurit e prisnin të nesërmen për t'u varrosur. Qenë mbledhur sipas lidhjeve fisnore, krushqi e miqësi. Meqë nënë Marga e kishte të sajën Zarën tre vëllezërit, si bënë ngushëllimet në vdekjet e lagjeve të tjera, vendosën që ta gdhinin natën duke përgjuar Sotirin. E shoqja e Dhosit bëri gati tasin me përshest, dhe vu mbi sofër tre lugë. Të tre vëllezërit hëngrën vëllazërisht dhe u nisën e hynë te Sotiri sipas moshës. Grigori, që ato ditë nuk e ndjente mirë veten, shtangu te dera, kur pa Sotirin të shtrirë në mes të dhomës, veshur me rrobat e tij, xhaketën prej kadifeje, me të cilën u nis atëherë për në shkollë. Në jakën e saj të majtë ishin akoma të qepura dy «S»-të e aksionit të hekurudhës, dhe një lule e vyshkur, e tharë e harruar aty. Pantallonat e dokut që ishin peshqesh po nga aksioni i hekurudhës, Grigori i pat ruajtur si dritën e syrit. Sa herë që i vishte ato bashkë me xhaketën i dukej vetja qytetar, si ato çunat e lumtur e të gjëzuar të Tiranës, që bënин xhiron e mbrëmjes nga dyqani i Xingtonit deri te sahati e ktheheshin sérish e sérish, dhjetë apo dymbëdhjetë herë duke mos u ngopur së pari vajzat e bukura. Ato pantallona e atë xhaketë ai i vishte me të vëtmen bluzë të verdhë me kopsa të bardha fildishi, që dy nënët, Margo dhe Zara ia kishin veshur me aq kujdes të vdekurit.

Grigori puliti sytë. Nuk ishte Sotiri i shtrirë në mes të dhomës. Ishte ai vetë, me rrobat e tij të vetme dhe nuk po i besonte qudisë që e ndjente veten edhe të gjallë edhe të vdekur, dhe Sotir dhe Grigor. Keqardhja që ndjeu për rrobat, e solli në vete Grigorin. I erdhi keq që do kalbeshin, do treteshin pa nam e nishan, sikur të mos kishin ekzistuar kurë.

Në fund të vitit të tretë, dy javë para se ta përjashtonin nga shkolla, Zani, një shok i klasës, një tiranas që i binte kitarës, u habit dhe u kënaq kur e pa Griordin që i kishte veshur pantallonat e zëza të dokut, xhaketën kafe prej kadifeje dhe bluzën e verdhë.

— Ti mund të bësh namin me vajzat në kombinat, o

budalla. Pse gris kot opingat duke bërë xhiro në bulevard? Hajde më pështy në surrat, po u ktheve pa bërë gjë me tekstilistet.

— Me këto këpucë llastiku? — tha gjithë turp Grigori, të cilët i digjte shpirti të paktën të kishte një vajzë. Si do kthehej ai në fshat, ashtu trung siç kishte ardhur? C'do t'u thoshte shokëve kur ta pyesnin? Të gënjenë si Jadhi i Gorajve, i cili mburrej se në hekurudhën Peqin-Elbasan, kishte pasur pesë dashnore? Dy korçare nga kombinati i tekstileve Stalin, një zuskë nga Durrësi me leshra të verdha, një simite me bugaçe nga Elbasani, dhe një fierake që i ngjitej pas trupit si kulpër dhe ia thithët buzët si shushunjë.

Jo, Gori donte vetëm një, një të vetme dhe nga ajo, sido që të ishte, simite me bugaçe, kulpër apo shushunjë, bionde apo ezmere, të kishte një kujtim, një të puthur. Kaq.

— Vajzat e kombinatit nuk shikojnë nga këmbët, o budalla. A ke xhaketë të mirë, bluzë të bukur, a ke sy të kaltër. Ah, t'i kisha unë sytë e tu, flokët e trupin tënd! — psherëtiti Zani e i ra me të pesë gishtat telave të kitares.

Po atë pasdite do të vinte në shkollën e Kamzës një shkrimtar sovjetik. Të gjithë ishin porositur të vishnin rrobat më të mira. Grigori, që i kishte dëgjuar fjalët e Zanit dhe nga tiranas të tjerë, kur gjithë nxënësit kishin dalë te dera e jashtme për të pritur shkrimtarin, çau ferrën. I ra rrugës përmes vreshtave, arave, kapërceu lumen dhe tamam në kohën kur po perëndonte dielli u gjend në sheshin e madh të kombinatit, mbushur me njerëz, djem, vajza, gra që hyrni e dilnin nga porta e madhe e kombinatit, që bridhni poshtë e përpjetë ca me **ngut e ca të ngeshëm**. Nga altoparlanti përhapej **një muzikë sovjetike** e kënduar nga **një këngëtare** zëri i së cilës e emocionoi Grigorin e arratisur nga shkolla për të mbërritur në këtë oaz, ku do të gjente **një vajzë** dhe do ta puthte. Sa e emocionoi kënga aq ia drithëroi zemrën statuja e madhe e Stalinit mbi piedestalin e lartë. Nga kjo lartësi trupi i Stalinit bëhej edhe më i madh, më imponues. Dhe dora e tij e ngritur lart qillit sikur merrete s'andëjimi bekimin e zotit dhe u tregonte njerëzve që endeshin poshtë e lartë nën hijen e tij, drejtimin e rrugës që duhej të ndiqnin si e vetmja rrugë që të conte drejt bregut të begatisë e lumturisë. Gjithë c'kishte dëgjuar në fshat e në

shkollë, në mësimin e historisë së partisë bolshevikë se e vetmja rrugë për ndërtimin e socializmit janë mësimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, Grigorit iu duk se vërtetoheshin këtu, në këtë shesh të bukur, të mbushur me djem e vajza nën zërin e ëmbël të këngëtares që këndonte e pyeste:

«Ah, Kak sllatko sercie noemu
paçemu, dagadacia paçemu?

Nga ato pak fjalë që Grigori dinte rusisht, kuptoi vetëm refrenin.

Përse jam kaq e lumtur;
përse rreh kaq ëmbël zemra ime.

Grigorit iu duk një mrekulli që mori vesh pak a shumë kuptimin e asaj kënge të ëmbël dhe, aty, mes sheshit, e ndjeu vërtet veten të lumtur. Ngriti kokën lart, atje ku e ftonte dora e Stalinit dhe pa retë e dendura të kaldajës më të madhe të ndërtuar në Shqipëri, që ngrihej mbi korpuset e kombinatit të madh. Dielli i përskuqte shtëllungat e kaldajës dhe i jepte gjithë asaj bote aty një gëzim.

Grigorin e çuan këmbët drejt hyrjes së kino-klubit, ku dy vajzat rrinin e dukeshin sikur e prisnin atë. Këmbët, me gjithëse dridheshin, e afroan pranë vajzave. Ishin tri dhe larg njëra-tjetrës jo më shumë se katër-pesë hapa. Me sa dukej ato ose nuk e njihnin njëra-tjetrën, ose sejeila kishte hallin e saj. U mendua një copë herë se kujt t'i afrohej, cila ishte më e mira. Për dreq këmbët e çuan te e treta. Ajo kishte një bel të këputur, të hollë sa një unazë. Dhe ishte e drejtë. me një kurriz petë, ku harkoheshin dy supe delikate, pak të varura. Ajo se si u kthyesh në profil. Balli, hunda e buzët ishin të lakuara aq bukur sa zor se ndonjë piktor mund t'i vizatonte më mirë. Ajo lëvizi dhe pak, si të ishte një manekine në vitrinë. Grigori nuk do të çuditej nëse nga gjoksi i saj

do tē dilnin e do fluturonin dy dallëndyshe. Flegrat e humdës pak tē ngritura, buzët e holla e nervoze, vështrimi si dy gjilpëra e shpuan tej pér tej Grigorin.

— Ik, o çuno! Mjaft u lëpive pas meje. Ik se po erdhi Xhezua ta bëri kurrizin më tē butë se barkun.

Grigorit sikur i ra në kokë dora e Stalinit dhe e zhyti pesë pashë nën dhe. Ai u mundua tē fliste, po meazallah se i dolën fjalët nga goja.

— Qënke dhe gagaç, o i shkretë.
Grigori u bë spec i kuq.

Vajza u kënaq dhe tha gjithë qejf.

— Mos punon në filaturë me vajzat që erdhën dje nga malësia?

Grigori u lumturua që ajo e pyeti. Tani ai do tē fliste me tē, do t'i tregonte se nuk ishte gagaç e as vajzë e ardhur nga malësia, por një nxënës i teknikumit bujqësor, i zooteknikës. Dy vajzat e tjera, që në fillim atij i ishin dukur më tē bukura, kthyen kryet. Grigorit nuk i pëlqyen fare. Bile ai u çudit që pak më parë i ishin dukur aq tē hijshme. Sa u mat tē përgjigjej vajzës belhollë, erdhi Xhezua, një zdap me shpatulla e krah mundësi. Ai sikur nuk e pa as Grigori as dy vajzat e tjera. I shkoi krahun rreth e qark belit vajzës dhe gati sa nuk ia theu kockat kur e mori hosh pas vetes dhe tē dy u futën në portën e hapur tē kino-klu-bit. Erdhën dhe djem e vajza tē tjera që futeshin me ngut te dera gojë e cila i përpiu gjithë sa c'ishin aty.

Grigori e pa veten tē vëtmuar, si tē braktisur. Tek shkallët, aty poshtë, pa një bullafiqe si bukëfiku, tul e dhjam. Sido që tē ishte, ishte femër. As e bukur, as e shëmtuar.

Kishte sy tē mëdhenj, tē qetë si dele e hutuar. Buzët i kishte gjak tē kuqe dhe faqet i skuqnin nga shëndetii. Ndonëse tepër e shëndoshë, format e trupit tē saj binin në sy sapo t'i afrohej. Dhe gjinjt dhe beli, dhe vithet ishin si brumë i ardhur. Bullafiqja faqekuqe iu duk Grigorit si një molle e pjekur, mjaft që tē zgjaste dorën dhe mund ta këpusje.

— E goce, si thua? — i foli Grigori ashtu siç e kishte mësuar Xani me gjuhën e garipëve tē bulevardit që ngacmonin gocat.

Ajo s'tha as po, as jo, por ama nuk bëri ndonjë shenjë tē keqe. Bullafiqja ishte vërtet brumë dhe mund ta gatuaje

si tē doje. Grigori i zgjati dorën. Dhe ajo ia dha tē sajën. Grigori u bllokua i téri. Sikur vajza tē mos kishte marrë iniciativë do tē qe prishur çdo gjë dhe Grigori s'do tē kishte asnjë kujtim dashurie nē jetën e tij, kujtim që pas dy javësh e pagoi shumë shtrenjt. E thirrën nē këndin e kuq. Nē tavolinën e presidiumit ishte ulur Alqi, shoku i tij i klasës, sekretari i organizatës së rinisë pér shkollën. Mbi kokën e Alqit qëndronin fotografitë e mëdha të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Lenini e shikonte Grigorin me atë buzëqeshjen e tij karakteristike, Marksit dhe Engelsit i kishin sytë te Grigori, kurse Stalini dhe Alqi e shikonin si me ngulm.

— Ç'kam bërë, o Alqi, pse kështu si nē gjyq?!

— Nëse ti bisedën me sekretarin e rinisë e quan gjyq atëherë unë s'kam se si tē tē ndihmoj. Të thirra që tē më thuash tē vërtetën. Ka shumë thashetheme, por një gjë është e vërtetë, ti ike nga konviki i atë ditë, atë orë që do tē vinte delegacioni sovjetik, ike pa leje dhe u ktheve tē nesërmen nē mëngjes. Unë si sekretar i rinisë së gjithë shkollës dhe disa shokë tē organizatës së rinisë së klasës s'mund tē vazhdojmë tē mbajmë qëndrim liberal ndaj teje, tani që nga fshati na erdhi dhe një letër. Në tē na flitet se xhaxhai yt na qenika një i arratisur. Tani na thuaj ku ishe gjithë pas-diten dhe ku e kalove gjithë natën. Nga sa dimë, ti s'ke kushërinj as nē Fermë. Nesër bëhet mbledhja e organizatës së klasës. Një nga pikat e mbledhjes është pér ty. Je nē teh tē thikës. Mund tē tē shpëtojë vetëm singeriteti yt.

— S'kam c'të them, o Alqi.

— Si s'paske? Unë tē ndihmova. T'i rradhita tërë pikat e errëta: e para: pse ike kur do vinte delegacioni sovjetik, e dyta: pse ia ke fshehur organizatës xhaxhanë, dhe e treta: ku ishe gjithë natën?

Grigori i ulur pranë trupit tē vdekur tē Sotirit, veshur me rrobat e tij s'donte tē besonte se gjithçka do tē varrosej, dhe kujtimi i vetëm i tij, tē së vetmes dashuri që bëri një natë nē kombinatin e tekstileve Stalin.

Mëngjesi s'donte tē zbardhete. As qentë nuk fjetën. Dhe kotecët e pulave nuk bënë gjumë, as trokashkat e dyerive që trokisin sikur t'u binte shejtani e jo njeriu hallexhi.

— U çmend fshati sonte, — i tha Marga Zarës, duke zjerë gjymin me kafe për ato që përgjonin Sotirin, — po pulat c'kanë, po dyert pse trokasìn?

— Vjen vdekja vërdallë dhe njerëzit kërkojnë nëpër qymezë gjelat e zinj? — u përgjigj Zara

— Ç'flet moj korbë, lajthite? Ç'i duan tanë natën gjelat e zinj?

— Për kurban, kur të dalë i vdekuri me të gjallë nga shtëpia.

— Ptyh, mos qofsha! Si më doli nga mendja. -- tha Marga e la gjymin e kafesë të valojë në zjarr dhe u fut në dhomën e burrave e i bëri shenjë Grigorit.

«O zot, shpëtona, — tha me vete Grigori i mbytur nga kujtimet e asaj nate që s'donte të gdhinte dhe brofi gjithë qejf në këmbë e ndoqi të emën nga pas.

— Shko në shtëpi, merr gjelin tonë dhe dil nëpër fshat e ndërroje me gjel të zi.

— Po ne pa gjel do të rrimë, tufa e pulave...

— Më mirë pa gjel se sa pa burra. Kur të dalë Sotiri me arkivol ti do t'ia këpusësh kokën gjelit e do ta lësh aty ta shkelin ose ta kapërcejnë njerëzit.

— Nënë, çfarë thua, pse?

— Atë, që thashë, nisu.

Grigori nuk i qe dukur fshati më i zi, megjithëse po agonte. Gjelin pikali të shtëpisë e zuri sa futi dorën në qymez. Pulat ia dhanë kakaritjes si të kishte rënë skilja. Dhe gjeli, ndonëse në duart e të zot, kakariste i llahtarisor është përplaste krahët sikur botës i kishte ardhur fundi. Grigori trokiti në derën e Gorajve, megjithëse dera ishte e hapur. Nga hajati doli nënë Maja duke ngritur mbi ballë shaminë e zezë.

— E muarnë të keqen. — tha nënë Maja kur pa Grigorin me gjel në dorë. — Shko te Malajt, ato kanë dy gjela të zez, nëse s'kanë vajtur para teje. O zot, na çmendën pulat sonte.

Grigori nuk i dha muhabet nënë Majës. Malajt ishin tri dyer më poshtë. Grigori iu drodh gjeli në dorë. Ai i foli për ta qetësuar dhe u drodh vetë. Nata qe mbushur me alarm. Nëpër rrugicat e fshatit, në qymezë e kopshtije s'dëgjohej gjë tjetër veç kakaritjeve të pulave e gjelave që u

kishin prishur gjumin qenve, të cilët i lehnin njëri-tjetrit gjithë panik.

Grigori trokiti te Malajt. Në oborr doli xha Milua duke ngritur poturet.

— Afrohu se s'të dalloj cili je, — e ftoi Milua

— Grigori i Margës jam. Erdha të ndërroj gjelin tim me një nga të tutë, ata të ziun.

— E dhashë njérin. Tjetrin nuk e jap se... Mos o zot, në gjynah mos hyfsha, se si ka nisur kjo flamë kam frikë. Dy çunat janë në listë. Dhanë sejcili nga shtatë vjet. Pse më ve në provë të vështirë, o zot, — tha plaku dhe i bëri kryq yjeve të qeres së madhe, atje lart në qiellin pis të zi, sikur atë qast zoti të kishte pas hypur vërtet në qerre e do nisej për të zbritur në fshat.

— S'ka gajle, xha Milo. Po zgres deri në lagjen e poshtme, te Skamjat. S'u shua fshati për një gjel të zi, — e qetësoi Grigori plakun dhe i ktheu shpinën.

Gjeli pikali vazhdonte të rrihte krahët, sikur po e thërrisin.

— O zot, të qofshim falë, falmë aë e prisha zemrën dhe e ktheva njeriun pa ia plotësuar dëshirën, — foli xha Milua.

Grigori u tret në mugëtirën që s'donte të zbardhate atë ditë. Me sa duket koha kishte ngecur nëpër shkurret e përtejme të malit dhe kishte humbur rrugën e fshatit.

Në të gdhire Grigori trokiti në derën e Skamaive.

— Hë, mo, c'bëhet andej sipër nga iu? — ia priti gjithë inat xha Llazi sikur Grigori të ishte shkaktar i asai gjëme.

— Po vdesin njëri pas tietrit, xha Llazi e një djall e di se ku e kur do shterë ky kob i zi.

— Mblidhni ment e gjeni deiman. Nëse vdiq Stalini s'ka pse të vdesë gjithë fshati. Do gjelin e zi, ë?

— Po, — tha Grigori i trembur se mos ai nuk ia jepte.

— Merre e thyej qafën me gjithë të.

Grigori futi dorën në qymez, lëshoi gjelin e tij, zuri për krahësh gjelin e zi e iku pothuaj me vrap si të ishte hajdut pulash. Nga pas i vinte zëri i fortë dhe i çjerrë i xha Llazit, i cili në vend që të thërriste kapeni hajdutin thoshtë ritmi-kisht: Na morën në qafë! Na morën në qafë!

Kur u kthyesh në shtëpinë e nënë Zarës, Grigori pa derën

e hapur dy kanatësh dhe tej saj, sikur dera të ishte kornizë, pa tablonë e madhe të jetës kooperativiste pa flamur, pa asnje parrullë të shkruar diku, dhe pa asnje portret udhë-heqësish. Në qendër të tabllosë ishte prifti plak kockë e lëkurë, me ato flokë të gjata, të thinjura, me sytë e tij të mëdhenj sikur kishte ngrirë hutimi, dhimbja e dyshimi. Nëse te prifti kishte diçka të gjallë qe vetëm qiriri, i cili digjej vetë në dorën e tij të ngrirë. I ngrirë dukej dhe dhjaku. Në dorën e djathë i rrinte varur temjanica dhe ajo e ngrirë, e palëvizshme, veç temjani digjej e tretej në një beshtje varri. Pas priftit e dhjakut, si të ishin murosur mbanin mbi supet peshën e rëndë të arkivolit me të vdekurin, katër djem të rinj dhe pas tyre, po si të ngurosur, rrin nga jeshur sikur mbanin njëri-tjetrin gjithë fshati. Grigori nuk guxoi të kapërcejë pragun e asaj kornize i trembur se me të shkelur atje do të ngurosej si gjithë të tjerët.

Margës, së cilës i kishte ngrirë vështrimi te dera, u gjallërua me të parë Grigorin dhe dorën e tij të fshehur pas kurrit. Ajo i bëri shenjë priftit. Prifti i përgjumur preku me dorë dhjakun, të cilit i lëvizi dora e djathë. Zilkat e temjanicës tringëllinë të përgjumura. Si me magji u përmendën njëri pas tjetrit burrat e gratë. U çkontraktuan dhe katër çunat nën peshën e arkivolit. Kortezhi lëvizi i téri, sarpo u dëgjuan fjalët e priftit.

— Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshiromë!

Grigori, duke i shtrënguar qafën gjelit të zi, ra në gjunjë, anash priftit, i cili nuk e pa. As katër shokët që mbanin të vdekurin mbi supe, nuk e panë. Grigorit iu drodhën të dyja duart derisa ato u shkëputën nga njëra-tjetra dhe të dyja njëherësh lëshuan përdhe vec kckën e veç trupin e gjelit të zi që përpëlitez, përdridhej e përplasej duke përgjakur kalldrëmin e këmbët e atyre që ecnin sipër tij dhe që bënин sikur nuk e vinin re. Grigori u ngrit. **Të dyja duart i kishte të përgjakura. Vetë duart u fërkuan e u fshinë pas pantallonave të leshta.** Grigori u fut në turmën lëvizëse duke vazhduat të ndjejë se si duart e tija fërkoheshin e fshiheshin pas pantallonave.

Dhe në kishë, gjatë ceremonisë së përcjelljes e ngushëllimit, Grigori një e dy e fshinte duart pas pantalonave,

ndonëse në to s'kishte mbetur asnë pikë gjaku nga gjaku i gjellit. Dhe troparet e kënduara Grigori i dëgjonte copa-copa duke parë fytyrën prej shenjtë të priftit plak. të dhjakut të vuajtur e nuk arrinte të ndante fjalët e shenjta, në ishin të ungjillit apo të Sotirit të shkretë.

«Duke më parë të shtrirë pa zë e pa frymë përpëra jush, qani të gjithë pér mua, o vellezër dhe miq, farë e fis e të njohur, se ditën e djeshme bashkë me ju po flisja dhe menjëherë më erdhi ora, e vdekjes. Po ejani të gjithë ju që më doni dhe më jepni përshtendetjen e fundit, se nuk do të eci më bashkë me ju, as që do të flasim bashkë që tanë e tutje, se shkoj te gjykatësi ku s'ka hatër, se shërbëtor dhe zotri qëndrojnë bashkë, mbret dhe ushtar, i pasur dhe i varfër, në një radhë e secili nga punët e tija a do lavdërohet, a do turpërohet».

«Qaj e vajtoj kur shkoj ndër mend vdekjen, dhe shoh bukurinë tonë të formuar pas ikonës së Perëndisë, të shtrirë në varr, të shëmtuar, pa rëndësi, pa formë. O çudi! Ç'është ky mister që ndodh me ne? Si iu dorëzuan prishjes dhe si u bashkuar me vdekjen?»

«— Hë de, si?» — tha Grigori me zë sikur po bisedonte me Sotirin si atë ditë kur ai e pyeti pér Stalinin dhe pa duart e tij të cilat pér çudi ju dukën tërë gjak.

«O çudi! Ç'është ky mister që ndodh me ne? Si iu dorëzua prishjes dhe si u bashkua me vdekjen?»

«— Hë de si??» — gati sa nuk thirri Grigori dhe pa me habi sytë e Shën Gjergjit majë kalit me heshtë në dorë, pa sytë e Shën Kollit me mjekër të bardhë, pa sytë e Shën Mëhillit, pa gjithë shenjtorët e ikonostasit. Vetëm sy, sy që donin të flisin e s'flisin dot. Grigori ktheu kokën nga njerëzit që ishin vënë në radhë e po ndaheshin duke e prekur me dorë arkivolin. Sytë e tyre të mëdhenj, pak të habitur e të hutuar, shikonin gjithë dhimbje njëlloj si gjithë sytë e shenjtorëve. Grigori u hutua. A mund të ishin njëlloj sytë e bashkëfshatarëve të tij me sytë e gjithë shenjtorëve të kishës së madhe të fshatit? Grigori u tremb që guxoi e i bazaroi banorët e fshatit të tij me shenjtorët. Ai pa qartësi në sytë e zotit Krisht dhe dëgjoi një zë i zbritur së larti nga këlli i kishës, ku fluturonin të lumtur dy engjëj të vegjël.

Zëri i shkruar prej perëndije. I ngjante zërit të Sotirit të vdekur.

← Faleminderit, Grigor për rrrobat. E di ti se tani, që jam i vdekur, s'kam më frikën që kisha kur isha i gjallë? Unë u clirova me vdekjen time. Ç'rëndësi kà se jam i gjallë apo i vdekur? Rëndësi ka që kuptova një gjë që ju të gjallët s'keni për ta kuptuar kurrë. E di ku ka qenë gabimi juaj që nuk u fal perëndia, sado që të luteni? Ju, o byrazer, bëtë perëndë një njeri që ha, pi e dhjet njëlloj si ti e unë? Hic, mos u habit dhe mos i lëviz buzët ashtu si gagaç. Pse pak qe ajo që bëtë ju mbrëmë në kishë, në shtëpinë e Perëndisë? Të kujtohet apo s'do ta kujtosh? Dhjetë vjet jetë i fale ti Stalinit, apo jo? U vutë në garë se kush e kush e do më shumë...»

← Ore Sotir, ore maskara, po ti ç'bëre, ore? A nuk je ti që kur zbrisnim nga mali më pyete se e dua apo s'e dua Stalinin, ë? S'të kujtohet? Po ti, more mut, a nuk dhe jetë nga jeta tënde? Po ty të kemi dhe sekretar të organizatës së rinisë, apo e kam gabim?»

— Në kishe. Tani s'më ke më. Pas një javë do mblidhet organizata e do zgjedhë sekretarin e ri. Unë e hodha lumin. S'kam pse të jem më me dy fytyra.»

Grigori, te kryet e arkivolit të Sotirit, e kishte penguar radhëm e gjatë të njerëzve që do jepnin lamtumirën.

— Lëviz Grigor, lëviz, — i pëshpërti Dhosi dhe shtyu të vëllanë, — si e duron gjithë këtë erë të keqë? Lëviz po të them, ec, shtyu! Me siguri do t'i ketë plasur prapë muti nga qëja të shkretit, vdekje e ndyrë, ë?

11

Të nesërmën e varrimit të Sotirit, një tabor i madh arixbanjsh, me kuç e maç, me mushka e gomerë, me kanistra, hebe e trasta, burra e gra, e më shumë fëmijë se sa rraqe iu afrojn fshatit buzë prroit, këtej shelgjeve, pranë burimit të Kacubit, në atë lëndinë të ngushtë në formë trekëndëshi. :

Buzet e fundit të diellit u dhanë zjarr ngjyrave të shumta të taborit, fustaneve e fundeve, shamive rrëth qafave të arixbanjëve. rruzave, stolive të vajzave e nuseve, të kafshëve

dhe fëmijëve të zbatbur. Tabori u shtrua këmbëkryq në lëndinë sikur të kishte ardhur nga një dhe i huaj, i largët e i rrallë e aty mbi fshat, gjeti vendin e dëshiruar; një lëndinë e një përrua me shelgje e një burim që nuk shter as kur thahet bari e pëlcet gjinkalla.

Sa hap e mbyll sytë, u shkarkuan mushkat, gomerët e gratë, u hapën dëngjet, hebet, trastat e thasët dhe si me magji u ngritën çadrat, u ndezën zjarret, u vendosën perustitë e çengelet, u varën tenxheret, kusitë e gjymat, dhe u vendosën me kujdes samarët e mushkave dhe të gomerëve si frone princërore pranë zjarreve, po andej nga s'vete tymi.

Grigorit iu duk sikur po shikonte dhe njëherë atë filmin sovjetik me ciganë, me atë hajdutin e famshëm të kuajve të stepës dhe në vesh iu bë sikur dëgjoi nga larg, nga kombinati i tekstileve Stalin, zërin e këngëtares që çuditej për zemrën e saj:

..Oh sa ëmbël më rreh zemra mua,
përse, hë pra, gjeje përse?

Grigori, si i magjepsur, nga ç'i shikonin sytë dhe i dëgjonin veshët, doli nga shkurret dhe u nis të zbrasë duke mos ndjerë se nga pas po e ndiqte tufa e dheneve. Sa iu afroa taborit, ngriu në vend, sikur këmbana e kishës që në atë çast ra për mort, t'i kishte rënë mu në çakë të kokës.

— Ç'bën shoku hetues, prit, mos i bjer në kokë, ky s'ka ardhur akoma në vete, — ngriti zërin doktori.

— Daç të vijë, daç të mos vijë, u lodha, s'pres dot më!
— thirri Ridvani.

— Jemi të detyruar të presim, shoku Ridvan. Deri sa ky reagoi ndaj goditjes do të thotë se ndjen dhimbje, pra do zgjohet, s'jemi pa shpresë.

— Më duket se po lëviz buzët, — tha Hamdiu, — ja shikojeni, ky po flet. Po flet!

— Isha i bindur që do të fliste, — tha mijeku dhe i nxiti: Hë vazhdo. ashtu. Do pak ujë? — e zbuti zërin mijeku dhe i bindur se sa shumë thahet goja pas morfinës i zgjati gotën dhe ia lagu buzët. Pastaj filloi ta ngrejë dorën ngadalë pér ta ndihmuar që i shtrirë në arkivol ta pinte të gjithë po e ndaloj Ridvani.

— Mos ia jep. Prit, — i tha mjekut dhe ia mori gotën nga dora.

— Po deshe ujë fol. Një fjalë duam, ti e di. Fol, si quhet fshati? Ja, kaq duam, një emër, ë? Mos i zgjat ashtu buzët si kërmill, po fol. Ja, ujë është, — i tha dhe ia hodhi në surrat gjithë gotën dhe ashtu, bosh, ia vuri në buzët e etura të cilat u puthitën pas qelqit dhe e thithën siç thin fëmijët e përgjumur thumthin e sisës.

— Për ideal të partisë ky është kafshë, nuk është njëri, — tha Ridvani.

— Shëët! Po flet! — pëshpëriti mjeku dhe të gjithë u çuditën kur dëgjuan fjalën qumësht.

— Dashka qumësht, — qeshi hetuesi.

— Jo, jo, — ndërhyri Hamdiu, — nuk do, përkundrazi do të na japë neve qumësht.

— Shëët, — tha mjeku, dhe i bindur që Grigori ishte akoma nën efektin e dy ampulave të morfinës e nxiti që të fliste.

Grigori lëvizte buzët, po asnjeri prej tre personave të ndodhur mbi kokën e tij, aty në dhomën e torturave, nuk ia dëgjoi zërin. Ata u habitë kur panë se si buzët vazhdonin të lëviznin dhe të qeshnin...

...Grigori zgjati dorën, kapi për këmbësh delen e Dhoksisë dhe filloi ta mjelë mbi kusinë që i zgjati arixhofka — një grua plakë të cilën nuk ia merrje dot vesh moshën. Në pëqinë e plakës rrinte pothuajse lakuriq një fëmijë rakinik. me një lëkurë të zbehtë e të rrudhur si prej plaku. me një bark të fryrë si kaçak, me dy këmbë të holla e të shtrembëra si shkarpa e me një vështrim të këputur gati-gati në të shuar për të mos u përmendur më kurrë.

— Qumësht ju jap unë sa të doni, dy dele, tri dele pesë dele qumësht, të kooperativës janë, s'u bë qameti, veç mos e mban i shpresën vetëm te qumështi. Ky, për mua, nga aq vdekje sa kam parë gjatë këtyre ditëve, sikur është nisur për keq. — tha Grigori duke mjelur delen e Dhoksisë.

— T'u thaftë gjuha, — mallkoi plaka, — qumështin ta dua, po fjalët e liga merri mbrapsht, këtij ia kam parë vetë fallin. Një pallat me pasuri e pret, një fat e një jetë e gjatë

e pret pasi të martohet. Një tabor me fëmijë ka për të bërë. Çdo gjë që do të kërkojë do t'i dalë mbi udhë. Ja si ky qumështi i bardhë i kësaj deleje të humbur.

— Dele e humbur, — u habit Grigori dhe si për t'u sigruar pa dhe njëherë delen e Dhoksisë.

— Ku e di ti që vërtet kjo dele është e humbur? — pyeti Grigori.

— Unë flas ç'më shohin sytë e ç'më thotë perëndia. Të humbur e ke këtë dele, po në pëllëmbë të dorës e mban. Në pëllëmbë të dorës e mban, po për ta gëzuar s'ke.

Grigori u mposht nga vështrimi i syve të plakës. Jo. Nuk ishin sy. Ai trup aq i drobitur, ajo fytyrë aq e rrudhosur, me ato flokë të thinjura, me ato dy vetulla si drizë, me atë hundë ku shquheshin si kamera dy brima të thella, me ato buzë të vyshkura, të rreshkura si dy shushunja të ngordhura, s'mund të kishin sy aq të fortë, aq të bukur, të cilët shikonin me një vendosmëri e siguri prej të plotfuqishmi.

Grigorit iu drodhën duart kur pa kusinë plot me qumësht. Si qe mbushur ajo vetëm me gjinjtë e një dele? Mos vallë kjo arixheshkë është një magjistare?

— Ti, more djalë, duhet të kesh një hall të madh, — tha arixheshka si e fyter dhe e zemëruar.

— E kam dhe jo vetëm unë, po tërë fshati. Ti qenke e çuditshme. Delen e gjete që është e humbur dhe hallin magjete.

— Të flet syri, more bir. E paske zemrën flori. Na dhe qumësht pa ta kërkuar njeri, zoti ta shtoi, me një dele mbushe një kusi.

— E pra, — tha Grigori i habitur, i shushatur e, si i yshthur, pa e pyetur kush, nisi t'i tregojë arixheshkës gjithçka, pa vënë re se turma e arinxinjve e arixheshkave mbilidheshin mbi kokën e tij dhe e shikonin sikur Grigor Kurtezi të ishte njeriu më fatkeq i kësaj toke rrëzë malit, pranë detit, në këtë luginë që është parajsa për gjithë taborët e fiset e arinxinjëve, ku shelgu është çuditërisht i njomë e përkulet si kulpër gjatë gjithë vitit, ku bari është dhe i ëmbël dhe i kripur, pasi avujt e detit vetëm aty bëhen vesë.

— Po vdesin të gjithë njëri pas tjetrit. Po vazhdoi kësh-tu, fshati do mbetet pa burra e pa djem.

— Po qysh u gënje një fshat i tërë? — pyeti kryetari i fisit, Abaz Mushkollari. — Për besë jetën e fal, ja për këtë çamarrok të sëmurë, për këtë plakë të zezë, dhe për gruan, dhe për fisin tim të shkulur, po jo për Stalinin.

— Gjynahqari nuk gjykohet, o bir, — ia preu sjalën arixheshka që duhej të ishte o nëna e Abaz Mushkollarit, ose nëna plakë e tërë fisit, o një zot e di se ç'ishte ajo me atë vështrim imponues që ia nguli Grigorit sikur ta urdhëronte.

Grigori iu tremb shikimit të saj. I tmerruar ai vazhdoi:

— I pari vdiq im atë, pastaj me radhë filluan të vdesin një e nga një e dy e nga dy, gjithë nga ata që dhanë jetën për të jetuar Ai. Dje vdiqën, sot prapë. Nuk e dëgjuat këmbanën e vdekjes? Dhe nesër s'dimë se ç'do të ndodhë.

— Ma shkoqit më mirë muhabetin, o evlat?

— C'të them dhe unë i ziu!

— Të gjitha, të gjitha, do të m'i thuash një e nga një, si erdhët deri në këtë derexhe, — ngriti zërin arixheshka.

Grigori sérish u tremb. U tremb dhe i biri i arixheshkës, Abazi, i cili u qudit me frikën e tij.

Grigori tregoi gjithçka, pa fshehur asgjë, as edhe një nga shumë e shumë mëdyshje të tijat, të të jatit, të vëllezërve, të nënës që ngulte këmbë që ata, të tre vëllezërit, të marrin arratinë. I foli dhe për Sofo Bregun, për Sotirin, sekretarin e rinisë së fshatit, për vdekjen e tij që u qelb në mut, për rrobat e tij që u varrosën bashkë me Sotirin.

— E mora vesh, — tha plaka, dhe sikur ti kishte duart e lagura i shkundi sipër zjarrit. Zjarri kërciti si barut, flakët lëpinë njëra-tjetërën, kush e kush të ngjitej më lart dhe u shuan sakaq.

— Të ikim, — tha arixheshka dhe shkundi mëngët e gjera të bluzës, pastaj, si të ishte bërë pis, filloj të shkundë rrobat e trupit duke u rënë njëherësh të dyja duarve sikur hidhët përdhe morra, pleshta e tartabiqe dhe urdhëroi taborin të ngrihet, të ngarkohen hajvanët.

— Mbaje gjuhën nënë. Mos e nxirr atë llaf nga goja. Ne shqyr që erdhëm të parët në këtë vend dhe e zumë. S'ka si ky shelg as në Greqi, as në Maqedoni, as në Mal të Zi. Punohet si kulpër e njomë që nga Shën Gjergji deri në Shën Mitër. S'thahet as kur i bien gjethet.

— S'tahet shelgu, po thahet robi. Këtu ka rënë mallkimi, Abaz! Zoti ma solli këtë bari lajmëtar. M'u rrëfye delja e humbur Abaz, sa e pashë! Të tjerat i dëgjove vetë me veshët e tu. Të kam bir, të kam prijës të taborrit, po më ke nënë.

— Një lutje kam, — guxoi e foli Grigori, — ju e keni kollaj, se e mbani shtëpinë me vete dhe ikni. Derman! S'ka derman pér ne? Një fjalë dua pa të gjitha jam gati t'i bëj, unë i vdekur se i vdekur jam, të paktën të shpëtoj fshatin.

— Fshati i ka bërë varrin vvetvetes.

— Ashtu éshtë, pér ditë po varrosemi, — pohoi Grigori me një zë lutës, me lot në sy, — Nuk më vjen keq se vdes. Më vjen keq se do më qajë nëna. Ti je nënë, s'më thua dot një fjalë?

Pa folur arixheshka, ra këmbana e dytë e vdekjes e asaj mbrëmjeje, megjithëse kishte akoma dritë nga perëndimi.

Abazi i kapi kyçin e dorës nënës plakë dhe ia shtrëngoi fort.

— Duke shpëtuar fshatin na shpëton dhe ne, nënë!

— Mos më kërkoni atë që s'e bëj dot. Këta i kanë shkruar në letër emër pér emër dhe letrën ia kanë nisur pér në Rusi. Dëshira e këtyre éshtë plotësuar.

— Po ai vdiq. Ne ia falém jetén tonë sa qe gjallë, ose që të mbetej gjallë. Tani që ai vdiq, s'ka se ç'i duhen më vitet tona? — ngriti zërin Grigori.

Abazi përdrohhi buzët dhe bëri sikur pordhi me gojë. Grigorit sa nuk iu çapëlyen sytë.

— Hiç mos më shiko ashtu, — tha Abazi, — kjo punë s'ka derman. Ju, o vëlla i dhatë paratë fshatçë siç i mblodhët, me ato mendt që kishit, tani thoni na ktheni paratë se kali ngordhi.

— Po nuk éshtë kaq e thjeshtë. Vitet tona nuk janë pare, o Abaz. Ç'i duhen një të vdekuri vitet tona, ë? Ia dhamë si ia dhamë, s'ka rëndësi, me shpirt e pa shpirt, veç ama i dhamë 1092 vite, jo pak, o Abaz. E mbanim si ikomë në shtëpi, o Abaz. E kishim si perëndi. Të na e punojë kështu? Kur nuk i duhen më pér vete vitet tona, pse na kosit, pér ditë nga dy, nga tri. Ç'është kjo babëzi! Kaq i lig të ketë qenë! Kaq të verbër të kemi qenë dhe ne?

— E, — përqeshi Abazi, — po ajo dihet, mbasë i ka

marrë me vete në varr. I ligu kur vdes bëhet lugat. A lufton dot delja me ujkun?

Grigori u zbeh në fytyrë. I ra hija e verdhë e vdekjes. Lëshoi duart si të këputura dhe u pa sy më sy me Bardhishkën, e cila se si rrinte, sikur të mos ishte dele. Dhe kokën se si e mbante, pak mënjanë tamam sikur po dëgjonte bisedën e dy burrave dhe as që i bëhej vonë se ajo bisedë ishte për jetë a për vdekje.

— Lufton dhe delja, — iu përgjigj Grigori Abazit, si s'lufton?

Tani qenë sytë e Abazit që u habitën.

— Lufton po s'fiton ama, — nuk u dorëzua Abazi, sikur po bënte pazar.

Grigori ktheu sérish sytë te delja e cila, me kokën mënjanë, rrinte ashtu e qetë, e urtë deri në dhimbje dhe sikur priste vdekjen e bariut.

— Po kjo dele i paska sytë e sëmura? — tha Abazi.

— Ajo po qan, o Abaz, — foli arixhofka plakë, e cila si e përhumbur zgjati dorën, shkuli një fije nga lesqi i kurrit, ia tregoi Grigorit dhe, sikur të betohej para asaj qenie të padukshme, foli:

— Do më sjellësh nga çdo shtëpi një nishan dhe nga çdo njeri që i ka dhënë jetë atij një nishan nga rrobat. Dhe nga ata që kanë vdekur dua një nishan nga rrobat që kanë mbajtur. Dua nga çdo shtëpi dy-tri pikëla hi, por jo nga vater e shuar. Tri bishta miu, tri krahë lakuriqi nate, një palë thonj bufi, mut qeni, mut mace, kakërdhi miu dhe një vezë të kuq që pashke nga ato që mbani pranë ikonave. Dua pak hi nga temjanica e priftit dhe pak dyllë të shkrirë nga shandanet e kishës. Hirin e temjanicës dhe dyllin e qirinjve të djegur do t'i marrësh pasi të këndojë këndesi i parë dhe s'duhet të të shikojë asnjeri. Hajt, ik tani se të presin gjithë ato punë, — tha nü fund plaka tepër e lodhur që foli aq gjatë dhe aq pëdernuar sa nuk ngriti as kokën të shikonte se si u largua Grigori.

Abazi u ul galiç pas nënës plakë dhe ia ngriti kokën e këputur.

— Nënë, s'je mirë? Do gjëkafshë?

— Kjo magji do dhe një kurban, bir!

— Pse s'kërkove atë delen e humbur. Na ka marrë malli për mish.

— Do kurban njeri, bir!

Abazit iu drodhën mustaqet.

— Po... këta për ditë po vdesin nga dy, nga tre?

— Ata që vdesin, nuk quhen kurban. Ata janë haraç. Shpirtërat e këtyre fakirëve qenkan të lidhur. Të çlirosh shpirtërat pa kurban, s'ka bërë vëki.

Grigorin nuk e mbante dheu. Ishte aq i lehtë në trup e me shpirt sa po të lëvizte krahiët edhe mund të fluturonte derë më derë, pullaz më pullaz të shtëpive të pakta të fshatit e të lajmëronte se erdhi dita e shpëtimit, për të çliruar nga ato pranga të çuditshme e të padukshme të mortjes së pangopur, po tufa e deleve nuk e linte veç të çapitej pas tyre me ngadalësinë e hapave të vogla e të matura të deleve, të cilat, atë buzë mbrëmjeje, se si ishin, si të hutuara, shushka e torollake, si të yshtura nga një fuqi e pashpjegueshme. Tri delet e Miçove dhe dy delet e Gorajve, apo hynë në fshat, u shkëputën nga shoqet dhe qëndruan përballë dyerëve të tyre të dikurshme nga ku kishin dalë para dy vjetësh, kur që formuar kooperativa dhe mazallah se tundeshin nga pragu. Jo, mushka është më e bindur. Grigori u bë qesharak para syve të njerëzve që bënин sehir. I shtyu, i tërhoqi, i rrahu, u foli, iu lut, i shau, i mallkoi, po ato, dele të urta e të bindura, hiç. S'donin t'ia dinin se ishin dele që kishin hyrë në kooperativë.

— Po lëri o Grigor sonte. I ka marrë malli të flenë një natë në shtëpitë e tyre.

— Ore, i lë se nuk bëhet qameti për qumështin e pesë deleve. I hedh një çikë ujë bidonit dhe e dorëzoj tamam po s'po marr vesh se ç'kanë sonte? Për natë këtë rrugë kanë bërë e s'kanë qëndruar, as sytë s'u kanë hedhur shtëpive të tyre! — u përgjegj Grigori pa thënë atë që duhej t'u iho shite njerëzve, gjithë c'kishte biseduar me arixheshkën plakë, nënëmadhen e taborit të arixhinjve.

Grigori shtyu më tutje tufën e deleve dhe po shikonte me habi e frikë apo iu afrua portës së Gjonmadhajve. Nga ajo shtëpi, kur që bërë kooperativë, ishin futur në tufë vetëm dy dele. Cila dhe Mira, të dyja kockë e lëkurë, që mezi të qapiteshin atëherë dhc sot e kësaj dite. Dy dele të sëmura nga gëlbaza, me lëkurë e lesh të prishur nga teja. Ato ishin turpi i tufës dhe përhapëset e sëmundjeve. Ato, të drobi-

tura e tē cfilitura, sikur aq fuqi tē kishin pasur atē buzë mbrëmjeje, ranë te pragu i derës dhe aty pështetën kryet duke parë me frikë bariun. Sytë e tyre, gjithnjë tē skuqura e tërë sklepa, nuk shikonin ndryshe nga ç'shikojnë sytë e fëmijëve që kanë bërë faj e presin ndëshkimin.

Grigori s'pati zemër as tē përdorte forcën, as tē fliste. Ngriti dorën dhe trokiti. Te dera doli Mihali dhe e ëma Mavraja, me shaminë e zezë deri te sytë.

— Mos u prish kooperativa, biro! — foli plaka e hutar që po shikonte dy delet si qëmoti kur i zbriste Grigori nga kullota e i binte te pragu i derës.

— Kooperativa tē na rrojë sa malet, nënë! Mos e thuaj dy herë atë fjalë, — iu përgjigj Grigori dhe i shkeli syrin Mihalit.

Mihali e ndoqi nga pas.

— Si është puna, Grigor? Mos lojte nga mendt që po ndan delet sonte?

— U ndanë vetë. Nuk di ç'ka ndodhur me delet. Bardhishka e Dhoksisë dha një kusi tē tërë me qumëshët si tē ishte lopë race. Më placin sytë në tē gënjej. Ka ardhur tabori i ari-xhinje te lugina. Arixheshka plakë më kërkoi pak qumëshët për një fëmijë tē sëmurë. Nejse, u fola për fshatin, për gjëmën që na ka rënë, që presin tē vdesin me radhë e pa radhë. Bardhishka më dëgjoi e qau si njeri. Qau dhe arixhoska. S'di se si po puna vajti deri atje sa ajo vendosi tē bëjë një magji tē madhe.

— Lëri këto budallallëqe Grigor e mos i zër me gojë me njeri tjetër, se do marrësh veten më qafë.

— Le ta marr. Ne tē vdekur se tē vdekur jemi. Mos sot, nesër. O unë, o ti. Dëgjo këtu, dhe lëre mënjanë frikén. Bëj gati një nishan nga rrobat e trupit dhe pak hi nga vatra, por jo e shuar. Dhe nga yt vëlla e yt atë. Mirë? Dhe dëgjo këtu. Mos i zgurdullo ashtu sytë. Nesër në mëngjes, kur tē vi tē marr delet mi nxirr ti, more vesh? Do vesh te Qosajt dhe Gurrajt. Ata nuk kanë futur dele në kooperativë. Shko që më parë dhe merru ti nishanet.

— O Grigor, je në terezi?

— Nuk e di jam a s'jam. Ta ngarkoj ty këtë punë, sepse tē besoj ty. Ti ngarko atë që beson ti. Ai që beson ti me

siguri e ka një shok të besës. E kështu me radhë, me besa-besë për shpëtimin tonë.

— Nga një arihxeshkë? — pyeti me habi e qesëndi Mihali.

— E pse jo? Deri sa ajo zgjati dorën për të lypur një gotë qumësht për një fëmijë të sëmurë, dhe qau kur pa i ëqajë në dele? Hë pra, më trego një kanxhë ku të var kërrabën. ë? O zot, ne jemi të gjithë dele të humbura, — tha Grigori dhe u nis pas deleve mes rrugës së fshatit, të cilat shkëputeshin nga tufa e pështeteshin pranë pragjeve të dyerë të tyre tamam si dikur.

Në qendër të fshatit delet morën dy e nga dy, nga tre e nga pesë rrugicat e shtëpive që me sa dukej nuk i kishin harruar as pas dy vjetësh. Te këmbët Grigorit i kishin mbetur dy delet e tij. Ato e ndoqën nga pas sikur të dyja të ishin ogice. Dhe njerëzit nëpër pragjet e shtëpive të tyre shikonin çudinë e nuk u besonin syve.

— O zot, po na merr burrat e djemtë e po na kthen delet e humbura, — pshëretiu nënë Zara duke bërë kryq.

Dhe nënë Marga bëri kryq kur pa të birin me dy delet e shtëpisë dhe me Bardhishkën te pragu i derës.

— O zot, më ruaj djalin. Ky qenka çmendur. Si e shpërndau tufën ky?

Marga i doli përpara të birit. Donte t'ia shikonte syltë. Grigori ra në gjunjë, zgjati dorën dhe mori një kaçarum mut qeni, që ishte aty, pranë gardhit.

— Ç'bën, bir! — thirri Marga kur pa se Grigori, pa ndjerë neveri e pështirë, e futi kaçarumin në tovbën që i ishte varur nga krahu.

— Më duhej dhe pak mut maceje, dhe disa kakërdhi miu, nënë. Të tjerat do t'i gjej sonte për gjithë natën e natës. Ti bëj zahmet e na shkit nga një rryp leckë të këmishave, dhe pak hi nga të vatrës po pa u shuar thëngjijtë e fundit.

— Mblidh mendtë, bir i nënës. Më mirë shiko pas tyt eti se sa të bëhesh gazi i fshatit. S'e patëm fjalën kështu, o zot. Merre një orë e më parë, o zot. Të falëm jetën, po jo mendtë, o Stalin! O bir, o Grigor, pa shikoje një çikë nënën në sy? Ja, ku më kë, o bir! Jam nëna jote që mos qofsha?

Ç'të kemi bërë, o zot, që na dënon rëndë e më rëndë?

— Nënë, — ia preu fjalën Grigori, — mili delet. Qumështi i tyre sot është i yni. Ika nënë, se dua të zbuloj pa u errur një fole bufi e një fole laraske. M'i kanë parë sytë kush e di sa herë, po nuk i mbaj mend tamam. Nuk e dija se do të vinte kjo ditë që të na duheshin pa derman.

— O zot, o bir, po rri një çikë me nënën tënde, a jam nëna jote, ë? — pyeti Marga gjithë frikë se mos i biri i lajthitur nuk e njihte më për nënë.

— S'jam më i vogël që të luash me mua. O, se desh harrova. Në qilar, nën odën e madhe, është një vrimë miu. Shiko përqark mos gjen ca kakërdhi. Dhe po të zuri syri nëpër bahë mut maceje, atje ku kemi mbjellur majdanozin....

— E mora vesh, o bir, e mora që na marrtë mortja, që s'të mori kur mori dhe tët atë.

— Do shpëtojmë nënë, do shpëtojmë! Ka ardhur ajo arixheshka plakë. Ti duhet ta njohësh. Do të bëjë magji të madhe për gjithë fshatin. Shko te vatrat dhe merr dy gishta hi, merr dhe një copë leckë nga rrrobat. Dil dhe nëpër komshinj, po pa rënë në sy dhe mblidhi gjithë ç'të thashë, — tha Grigori, sytë e të cilit shkëlqenin si dy zjarre të vegjël mes errësirës së një nate të gjatë e të zezë pus.

Grigori nuk e pat ndjerë veten kurrë aq të lumtur veç asaj buzëmbrëmjeje në kombinatin e tekstileve Stalin. Kë do takonte sonte? Cila bukuroshe nga të kombinatit e priste? Apo atje tutje, në të dalë të fshatit e priste Dhoksia? Apo ajo bukuroshja bardhoshe, si top dëbore, infermierja e spitalit? Sa dashnore të ëndërruara kishte pasur ai në jetën e tij të shkurtër, të gjitha i dolën tanë parasysh, dhe të gjitha e prisin që t'i jepeshin e ai, më në fund, të zhvirgjërohej si djalë. Grigori ecte drejt tyre si sonambul. Si sonambul lypë e zbriste nëpër pemë, luante me dritën e hënës që i binte mu në sy kur hapte degët e pemëve dhe magjepsej pas yjeve që atë natë se si ishin nëpër qill e prisin vetëm një zë së larti që t'ia merrnin valleve. Një bilbil gjumash u tremb para ftyrës së tij apo ai lëvizi degën e valanidhit. Flatrat e bilbilit shtynë ajrin, ajri i përkëdheli faqet e flokët. Dhe xixëllonjat e para nisën të ndjekin njëra-tjetërën në kurorën e valanidhit të madh sa bota.

— O zot, pse e ke bërë gjithë këtë bukuri, — tha duke lëvizur buzët Grigori dhe u tremb. Në një degëz mbi kokën e tij pa dy sy të mëdhenj që shikonin me habi, e dyshim. Vetëm dy sy si dy zare fosforeshente mes botës së valanidhit. Grigori futi tinëzisht dorën nëpër bisqe dhe si me shkathësinë dhe shpejtësinë e magustës e mbërtheu në pëllëmbën e dorës së tij trupin e kokën e bufit plak, i cili nuk mori vesh nga i erdhni fundi i jetës së tij mes asaj nate aq të bukur.

Grigorit iu drodh dora, i humbi fuqia dhe i trembur se mos bufi i shpëtonte e futi dorën me gjithë buf në torbë sikur ta kishte futur në xhep. Futi dhe dorën tjetër dhe i dha fund jetës së bufit. I ndau kokën nga trupi. Kur zbriti nga valanidhi nata nuk e kishte më bukurinë e saj. Dy lakuriqtë e natës e lodhën pothuajse deri në mëngjes, kur zbardhi dita. U lodh dhe ai dhe lakuriqtë e natës, Kur zuri të parin u gëzua si fëmijë, kur zuri të dytin u lumturua dhe i këputur e i djerisitur u shtri në prag të hangarëve bosh. Aty e gjeti magazinieri i kooperativës, një burrë rrëth të gjashtëdhjetë vjetëve, i thinjur e gati i verbuar, i cili nuk përzihet kurrë në punët e fshatit, megjithëse dinte gjithë ç'ndodhëte. Rronte i vetmuar në një kthinë të magazinës. Aty hante, aty flinte. S'kishte as grua, as fëmijë, as farë e as fis.

— Grigor, o Grigor! — i foli magazinieri dhe nga që nuk mori përgjigje e preku lehtë në sup dhe duke e tundur si të ishte bebe në djep i pëshpëriti: — Grigor, o Grigor! Po zgjohu, o bir, se do ftohesh. E di që u lodhe duke luftuar gjithë natën me djajtë po ngrihu, ngrihu se të pret fshati.

Grigori dëgjonte si larg se dikush përpinqej ta zgjonte. Zëri kur i vinte si i të jatit, një zë i mbytur varri, herë si zëri i hetuesit i cili kishte ndërruar mendje, ishte bërë një njeri i urtë, i dashur, e që i hiqej si shok, si mik, e i lutej të mos ia merrte për keq që i kishte thyer kockat, që e kishte mbyllur në arkivol, që e kishte tredhur ashtu si padashje, që urdhërat e tij i kishte keqkuptuar një farë Hamdi Hamdiu; po dhe ai, Hamdiu, nga zori kishte vepruar. Ç't'i bënte detyrës? Me se t'i ushqente fëmijët po të mos i thyente atij kockat?

— Grigor, o Grigor, po zgjohu, mo bir!

Grigori u përmend po sytë nuk i hapi. Ai e dinte se ç'kishte hequr nga sytë e tij budallenj. «Më mirë e më i fituar

del po tē shtiresh si i vdekur». — tha me vete Grigori.

— Nëna është bërë merak. Ka lëshuar vëllezërit tē tē kërkojnë. Vëllezërit zgjuan shokët e tyre, shokët miqtë. E di që i tërë fshati është ngritur pér ty? Ngrehu se ka rrezik tē merret vesh magjia e arixheshkës. Na fike pastaj. I ziu ti e tē zintjtë ne që do vazhdojmë tē ngordhim si pulat. Nëna po qan. E shkreta, tē pandeh se ke lajthitur. Të gjitha sendet janë mbledhur në shtëpinë tënde. Jot émë po i lag me lot. Qan e thotë se ti je çmendur.

Grigori u ngrit sikur tē kishte mbi shpinë një mal me dhe. Dhe rrobat i shkundi sikur t'i kishte gjithë dhe e baltë, si i ngritur nga varri.

Magazinieri e pa me dyshim. Kush kishte tē drejtë? Nëna që e mbante pér tē çmendur, apo fshati i tërë. i cili shpresonte te Grigori sikur ai tē ishte shenjtëruar brenda një nate dhe do bënte çuditë.

— Po dylli i qirinjve tē shuar, hiri, hiri i temjanicës?

— foli Grigori duke parë me frikë dritën e mëngjesit.

— I morën. I mori yt vëlla, i vogli. Në shtëpi i ke tē gjitha. I mori te altari i kishës së vogël që tē mos binte në sy.

Grigori rrëmbeu torbën që e kishte vënë si jastëk dhe vrapi. Ecje dhe nuk i besonte këmbëve që po e conin drejt shtëpisë. C'të bënte që ta qetësonte nënën? Të qante, tē qesh-te, tē fliste? A nuk janë tē gjitha këto veprime njëloj si pér tē çmendurit e për ata që janë tamam?

— Nënë, nënë, — thirri Grigori sa hyri në oborr dhe po me atë vrull u fut në dhomën, e cila ishte mbushur plot e përplot me nierëz. Në mes tē dhomës ishte një mësallë e bardhë e mëndafshët dhe e qëndisur me giymysh persie. Dhe mbi tē ishin heqjur gjithë rrinat e fijet e leckave tē këmishave, fundeve, fustaneve, shamine tē kokës, shenja e xhingla-mingla tē përziera me thoni bufi, fletë tē lakuriqit tē natës, bishta miu, lukturdhë e gjithfarë ndvrysirash. Dhe pranë tvre qëndronte më këmbë si qiri pashke, e verdhë dyllë dhe e ngrirë nënë Marga.

Grigori vuri torbën te këmbët e nënës, dhe gjithë frikë e dhimbie e pa drejt në sy. Marga, si zonjë shtëpie nuk e dha veten. Ajo i bëri shenjë tē birit. Grigori ndoqi vështrimin e nënës dhe u habit kur në përkulur në vatër arixheshkën plakë, e cila po nomotiste një pirg tē vogël me hi.

Grigori u mat të fliste, ta qetësonte nënën, po Marga sërish i bëri me shenjë me gishtin tregues, të cilin ajo e vuri te buzët e saj si për t'i thënë të birit: shët.

Arixheshka plakë, si një kërcu lisi gërbonjë e gunga, ungri nga vatra, mezi drejtoi trupin dhe iu afrua pиргут të plackave e sendeve që kishte sjellë brenda natës i tërë fshatit. Zgjati dorën, mbylli sytë e tha:

— Halli-hallit nuk i ngjan, kurse ju të gjithë keni një hall të vetëm ndaj hatëri mos të mbësë c'gjë do zgjedhë dora për të mbledhur shuk hallin e madh. E zgjidh a nuk e zgjidh magjia të keqen e lidhur mbi kokat tuaja nuk e di. S'di a kam aq fuqi që të shkojë aq larg, deri në Rusi. Unë do bëj timen, zoti të vetën. Në është zemëruar me ju le t'u falë, e le t'i japë fuqi kësaj magjie.

Sa fliste, dora trazonte plackat, pastaj e ngriti lart si drejt kulmit të tavanit dhe iu nxinë sytë kur pa se nga dora e saj u shpështoll një copë çarçaf i bardhë borë, po me një njollë të vetme, një bllangë të kuqërrëmtë si në kafe.

— Po ky, gjak është? — pyeti arixheshka.

Fjala gjak drodhi ajrin e dhomës dhe zemrat e njerëzve, burrave, grave, djemve e vajzave.

— Gjak i vjetër, gjak i tharë, ehu që kur s'mbahet menj. — foli nënë Zara dhe u skuq e tëra si të ishte një çupë e turpshme që s'ka kapërcyer pragun e derës. — S'kisha gjë tjeter në shtëpi, — nisi të justifikohet plaka Zarë. — asgjë s'më ka mbetur nga paja e pasuria. Këtë copë e kam ruajtur në fund të syndykut si kujtimin tim më të shtrenjtë. E shtrova atë natë që u martova. Të nesërmen burriëziu iku në kurbet e s'u bë i gjallë. Nga gjaku i asaj nate u zu Sotiri, biri im i vetëm që vdiq pardje. Tani s'kam më në shtëpi as atin, as birin. Kujtimin e tyre e fal me gjithë shpirt. Le të mbli-dhet magjia me gjakun tim.

«E shkreta. — tha Marga me vete, — dhe Zara paska roitur. O zot, o arixheshkë, na bëj derman se veç vdekjes që e kemi bërë hak, po na pllakos dhe çmenduria».

— Fole gjë nënë, — i pëshpëriti gjithë merak Grigori s'ëmës.

— Fola me perëndinë.

Arixheshka ktheu kokën dhe bëri sikur nuk e pa Grigorin. Me duart që i dridheshin, i mblođhi shuk gjithë c'kish-

te nomatisur dhe i futi në torbë. Dhe torba, si për çudi, i nxuri të gjitha. Arixheshka u ngrit në këmbë me torbën në duar si të ishte një pelenë që mbështillte një fëmijë të porsa lindur dhe pa me radhë gjithë djemtë e burrat.

Syri i saj atë çast ishte i ligë, ndillte zi e kob. Të gjithë u trembën nga ai sy, veç Grigorit.

Arixheshka sërish bëri sikur nuk e pa Grigorin. Sytë e saj ranë mbi grupin e djemve. Të gjithë vunë re se ajo donte të fliste, po s'fliste dot. Lëkura e vyshkur e gushës, mollëza e Adamit lëviznin dhe mjekra si naforë, dhe buzët si eshkë të thara lëviznin po zë s'nxirrnin dot.

Nënë Marga ndjeu që lëvizi ajri e sikur nga oxhaku po zbriste dikush. Ajo shtrëngoi dorën e Grigorit e si me mafifet e afroi të birin pranë vetes.

— Fol, arixheshkë, mos më mundo. Ç'do më prej nesh?
— ngriti zërin Marga.

— Një djalë dua. T'i jap magjinë, torbën, — tha dhe e zgjati dorën drejt grupit të djemve e duke i kthyer kuriztin Grigorit, vazhdoi — veç ai që do ta çojë atje duhet ta dijë se do bëhet kurban, s'ka për t'u kthyer as i gjallë as i vdekur, do humbë pa nishan.

— Torba është imja, — ngriti zërin Grigori dhe u shkëput nga dora e sëmës, rrëmbeu torbën e doli nga shtëpia.

— Grigor, bir! — thirri Marga, po Grigori kishte kapërcyer pragun e derës së oborrit.

Grigorit iu bë një zë i largët që e thirri sërish...

— Grigor.

— O Grigor, bir bushtr!

«— S'qenka zëri i nënës», — tha Grigori me vete dhe sikur po zgjohet nga një gjumë i rëndë. Atë çast s'donte gjë tjetër veç të hapte sytë, të shikonte ku ishte, të merrte vesh se ç'kishte ndodhur me torbën, të cilën ai ishte i bindur që e kishte hedhur në ambasadën sovjetike.

— Po, e hodha, e hodha, unë e hodha torbën, — foli Grigori fare qartë aq sa hetuesi, mjeku dhe Hamdiu u panë sy më sy gjithë shpresë e gëzim.

— Që e hodhe e di, o bir bushtr, — ngriti zërin Ridvan Geseri

Grigori hapi syrin e mirë, po nuk pa asgjë. Hapi dhe syrin tjetër po sërish s'pa gjë.

Mjeku ndezi një fije shkrepse dhe ia kaloj parasysh. Grigori nuk reagoi.

— Nuk sheh, më! — tha mjeku dhe u tremb.

Hetuesi e shtyu me dorë mjekun dhe u përkul mbi kokën e Grigorit.

— O Grigor, — zbuti zërin hetuesi, — po fol, o burrë i dheut, fol!

— T'i thashë, të gjitha t'i thashë. S'kam fuqi t'i them prapë, — mezi belbzëzoi Grigori.

— O zot, — tha hetuesi i habitur, — ky po na luan menç.

— Dëgjuat apo s'dëgjuat. M'i paska thënë të gjitha!

Mjeku u fut midis hetuesit dhe Grigorit, i cili kishte mbetur me sy hapur. I mori dorën dhe mezi e ndjeu pulsin. Një puls filiform që ndërpritej e riniste sérish po më i dobët, si një flakëz kandili pa vaj që digjet e përpëlitet sa është ende i patharë fitili. Mollëzat e gishtérinje të mjekut, të mësuarra prej vitesh me konstatimin e vdekjes të shumë e shunië rasteve që kishte pasur në jetë, u elektrizuan. Ai u bind se Grigori i kishte minutat e fundit të jetës së tij. Pauzat e pulsit u dendësuan. Dhe kohëzgjatja e rrahjeve filloj të ndryshojë hapin. Veç një mjek me eksperiencë është në gjendje të ndjejë se si shuhet jeta e të numërojë minutat e sekondat e fundit.

Një pauzë e gjatë e pulsit të humbur e bindi mjekun për vdekjen. Zemra e Grigorit rishtas rrahu dhe dy-tri herë si një zogth i trembur që ndjen rrezikun. Pastaj s'rrahu më. Megjithatë mjeku nuk i hoqi gishtat nga vendi ku kishte mundur të kapte pulsin, po pulsi nuk u gjallërua më. Ai heshti. Kaloi një mnutë dhe mjeku largoi dorën e tij të gjallë nga dora e porsa vdekur, po që do të ruante dhe për disa çaste njëfarë ngrohtësie mishi e gjaku. Mjeku e çoi te sytë e hapur të Grigorit, të cilat kishin vdekur dy minuta para zemrës. Rëndoi dy gishtérinjtë mbi qepallat e syve dhe i mbylli.

— Ç'bën? — pyeti hetuesi i habitur.

— Hiç. Adetin. Ky mbaroi, — tha mjeku duke parë orën.

Hetuesi përdrohhi buzët me neveri dhe pa mjekun me përbuzje që u largua.

— Ama gjeti kohën për shaka, — i tha Hamdiu.

Ridvan Geseri u përkul mbi Grigorin.

— Pa hë, m'i përsërit dhe njëherë të gjitha ç'më ke thënë,
o bir kurve!

Grigorit i lëvizi një tik nervor mbi buzën e sipërme. Sig
duket nervat vdesin të fundit në trupin e njeriut. Po truri
pas sa kohësh që ka pushuar zemra, pushon së menduari?

Grigori, që kishte vdekur e ishte ngjallur disa herë, me
siguri nuk e kuptoi atë çast që vdiq. Ai cdhe tanë që kanë
kaluar kaq e kaq vite nuk e di se ka vdekur. I shkreti ai, me
siguri pret, pret që t'i kalojnë dhimbjet, të qetësohet e të
rifillojë sërish nga torturat... Pret, e aty në arkivol mbasë
thotë me veten e tij: «Më mirë të mos zgjohem. Më mirë të
shtirem si i vdekur».

10 gusht 1992